


BIBLIOTEKA
SHTETIT

92
M. 98



SELAM
MUSA
SALARIA

XHAFER MATUKA

94
1998

XHAFER MATUKA

SELAM MUSA SALARIA




SHTËPIA BOTUESE «NENTORI»

Redaktor: *Polikron Tamburi*
Kopertina nga: *Roland Karanxha*

Tirazhi 4.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1975



Selam Musa Salaria 1860-1920
Hero i Popullit

SELAM MUSA SALARIA

1. Famila

Në veri të Kurveleshit të Sipërm, midis maleve të larta Këndervicë e Trushnicë, shtrihet Qafa e Kreshës, e cila është një nga të pesë portat natyrale për të hyrë në Kurvelesh. Poshtë kësaj qafe, drejt në veri, zgjatet një grykë e thellë, të cilën e ndan në mes një përrua i thatë, që fillon në Qafë të Kreshës e mbaron në lumin e Vjosës. Në këtë grykë shtrihet fshati Salari i rrethit të Tepelenës, i cili përbëhet prej tri lagjeve: në krye Elezajt, pastaj Mesasi dhe më poshtë Deliajt. Të tri lagjet janë larg njëra-tjetërës, pothuajse në distancë të barabartë, rreth një kilometër e gjysmë. Para vitit 1913 Gryka e Salarisë ka qenë e pyllëzuar me lisa të mëdhenj e pemë të tjera frutore e jofrutore. Salarjotët janë njojur e njihen si luftëtarë, të fortë fizikisht, njerëz të besës e të zakoneve të mira, si dhe për origjinalitetin në vëshje e në të folur. Këtu, në lagjen Mesas të Salarisë, më 1860 lindi Selam Musai.

Gjyshi i Selamit, Çarçan Hasanaj, ishte një fsha-

tar i varfër, i cili kishte pak dhen e një arë. Atë, të moshuarit, e tregonin njeri të thjeshtë, të urtë dhe punëtor të palodhur. Më të shumtën e kohës ai e kalonte si bari me dhentë e tij dhe përzitës me të tjerët.

Babai i Selamit, Musa Çarçani, ishte një burrë i gjallë, i zoti i punës dhe i fjalës. Ai merrej kryesisht me bagëti dhe punonte arën që i kish lënë i ati. Musai i shtoi bagëtitë, sidomos dhentë, por ai, meqë kish familje të madhe, mbeti kurdoherë nevojtar. Verën e kalonte më të shumtën e kohës në mal, ku mbante bagëtitë, kurse dimrit shkonte në kullota nga ana e Vlorës ose e Delvinës. Musai njihej si njeri i urtë, gjakftohtë, i matur në fjalë, i shkuar me fshatarët dhe zemërmirë. Qëndronte larg vjedhjeve dhe urrente padrejtësitë që shpesh bëheshin në kurriz të të varfërve.

Mëma e Selamit quhej Beqare Mehmetia dhe ishte nga lagjja Elezaj, prej familjes së Liçeve. Atë e tregojnë grua shumë të pashme, punëtore, e të sjellshme. Ajo qe, gjithashtu, autoritare dhe respektonte zakonet e mira të vendit.

Trimërinë dhe guximin e saj Beqarja e ka shfaqur në shumë raste. Për të tregohen shumë episode. Njëherë në fshat kishin ardhur xhandarët turq dhe kërkonin që të merrnin bagëtitë e atyre që nuk kishin paguar xhelepin. Ata vunë përpara edhe ato pak dhen që kish një kushërimi i Musait. Gruaja dhe fëmijët po qanin. Beqarja i dëgjoi dhe, e revoltuar, rrëmbeu sopatën dhe u përlesh me xhandarët, njërin prej të cilëve e mbërtheu për jake të palltos. Nga britmat e saj u grumbulluan edhe fshatarë të tjerë. Për t'iu shmangur sherrit xhandarët u detyruan të largohen pa marrë gjë me vete. Beqarja shquhej edhe

për karakter të fortë e pak të rrëptë në edukimin e fëmijëve të saj. Shumë nga cilësitë e mira të kësaj «burrëreshe», siç e quanin salarjotët, i trashëguan edhe fëmijët.

Musai me Beqaren patën gjashtë fëmijë, katër djem: Selamin, Nexhipin, Dulen e Çarçanin, dhe dy vajza: Metullahen, e cila u martua në Mesas në familjen e Shehëve, dhe Zenon, e cila u martua në Deliaj.

Musai i mësoi me punë djemtë e tij që të vegjël, duke ruajtur bagëtitë e duke i bërë shërbimet e nevojshme një copë are që kishin, nga e cila siguronin vetëm tre muaj bukë. Në stinën e verës Selami me të vëllezërit delnin në malin e lartë, i cili lulëzonte nga qilimi i gjelbër prej trëndeline e tërfili, thithnin ajrin e pastër e pinin ujë bore. Që andej shikonin deri tutje larg malet e fushat e atdheut. Kurse në vjeshtë, Musai me djemtë e shpërngulte stanin dhe kalonte në zonat e ngrohta, në kullotat dimërore, në anën e Delvinës ose të Vlorës. Një kohë të gjatë familja e Musarajve ka patur bagëtitë përzier me familjen e Ibrahim Hoxhës nga Gjirokastra, me familjen e Nazif Hadërit nga Palavlia e Delvinës si dhe me një familje në Treblovë të Vlorës.

Selami, duke kaluar kështu nga njëri vend në tjetrin, u njoh, që i ri, me krahina të tjera dhe zuri shoqëri e miq, shumë prej të cilëve i mbajti deri në fund të jetës së vet.

Të vëllezërit e Selamit, që të tre, patën vdekje tragjike. Më 1891 Nexhipi ishte duke kullotur bagëtitë në barin vjeshtak nga këmbët e malit. Aty, për çështje kufiri, u grind me Jashar e Mato Kordhën dhe Deliajt. Njërin prej tyre Nexhipi e kapi dhe e vuri poshtë vetes, por tjetri e goditi atë me

thikë në bark e në zemër dhe kështu ai vdiq fare i ri, duke lënë vetëm një vajzë.

Vëllai tjetër, Dulja jetoi edhe pas Selamit. Ai u martua dhe pati katër fëmijë, tri vajza e një djalë, prej të cilëve i jetuan vetëm dy vajza. Dulja mori pjesë gjallërisht në lëvizjen patriotike, u dallua si trim në luftërat e zhvilluara më 1913 e 1914 kundër shovenistëve grekë dhe në Luftën e Vlorës më 1920 kundër imperialistëve italianë. Për kontributin e tij të dhënë në këto luftëra, Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë e ka dekorur me medaljen «Për veprimitari patriotike». Aty nga viti 1924 Dulen e vranë me të pabesë. Natën vonë, kur ai ishte duke fjetur, Mevlana Seiti, që ishte njeri i besuar i familjes, po që e shpërdoroi këtë besim, i hyri në dhomë, mori armët që qenë varur në mur dhe e vrau.

Vëllai i tretë Çarçani, ishte fare kokëkrisur. Në 1944, para shtëpisë së tij po kalonte një kolonë ushtarake gjermane. Ai doli te porta, u thirri: «Vdekje fashizmit», dhe çoi grushtin lart. Disa breshëri automatiku të ushtarëve hitlerianë e rrëzuan të vdekur përdhe.

Më 1880 Selami u martua me Dylbë Mehmeten, po nga fshati Salari, e cila vdiq duke lindur. Me këtë grua Selami pati tre djem e tri vajza, po i jetuan vetëm tri vajzat, Vezikua, e cila u martua në familjen e Shehëve në Nivicë, Mirua, e cila qe martuar në Matohasanaj dhe vdiq nga mesi i viteve tridhjetë. Dhe Sefa, e cila u martua në familjen e Seferëve në Nivicë.

Pas vdekjes së gruas së parë Selami u martua me Ziliha Horjeten nga Guzmari, e cila lindi katër djem e katër vajza, por nga këta jetuan e arritën

moshën e pjekurisë vetëm dy vjaza, Metua, e cila u martua në Luzat dhe Këzja, e cila u martua në familjen e Muçajve në Elezaj.

Fëmijët e tjerë vdiqën të vegjël, që nga disa muajsh deri në dy-tre vjeç. Vetëm tre djem vdiqën më të rritur, Magripi 16 vjeç, Tajári 10 vjeç dhe Ismaili 5 vjeç.

Siq shihet Selamit i jetuan pesë vajza, Dules dy vajza dhe Nexhipit një vajzë, kurse Çarçani nuk qe i martuar. Në këtë mënyrë dera e Musarajve në Salari, nuk la burra, vajzat u martuan.

Megjithkëtë oxhaku i Musarajve vazhdoi ende, për një kohë të gjatë të nxirrte tym, shtëpia qëndroi e hapur dhe priste e përcillte, sipas zakonit, miqtë e shtëpisë. Aty qëndruan, deri sa u pushoi zemra, dý gra, Zilihaja, e shoqja e Selamit, dhe Safa e shoqja e Dules. Ato qenë patriote të vendit të tyre, mbajtën të pashuar në gji dashurinë për atdheun dhe urrejtjen për armiqtë e jashtëm e të brendshëm. Pas vrasjes së Selamit, Safa mori pjesë aktive, përkrah burrit të saj, në Luftën e Vlorës më 1920. Këto dy plaka trimëresha jetuan edhe në Luftën tonë Nacionallçirimitare, dhe shtëpinë e Selamit e të Dules e bënë mikpritëse për partizanet e partizanët, të cilët luftonin për çlirimin e Shqipërisë ashtu si luftuan edhe ata.

2. C o p a j e t e

Që kur qe i ri, Selam Musai dëgjoi nga fshatarët më të vjetër dhe nga shokët e miqtë e babait të tij mbi përpjekjet që bënин rilindasit tanë për ta çliruar vendin nga zgjedha e Turqisë. Ai, në dasma e gostira ose në festa të ndryshme, dëgjonte këngët që u kush-

toheshin udhëheqësve të shquar të kryengritjes së kohës të Tanzimatit si Zenel Gjolekë Kuçit, Hodo Ali Nivicës, Rrapo Hekalit, Tafil Buzit e të tjerëve. Ai, këngët e këtyre trimave i këndonte edhe vetë me shokët e tij. Pleqtë salarjotë kujtojnë edhe sot se Selam Musai si kur qe i ri ashtu dhe kur u bë në moshë të thyer, këngën e Hodo Ali Nivicës, kudo që qe rasti pér të kënduar, do ta këndonte patjetër. Ai hidhte sytë nga mali i lartë mbi fshat, i jepte fytyrës së tij pamje të vrenjtur e serjoze dhe ia niste:

*Qaj, moj, qaj, moj Këndervicë,
Qaj pér trimn' e Shqipërisë!
I shkreti Hodo Nivicë,
Bam ja bëjnë e do s'e vrismë,
Pallton e shkretë ja grismë,
Plumbat më të s'kolismë,
Gjolek' e Hodo Aliu
Në dorë palla ç'u ngriu...*

Selam Musai qe tetëmbëdhjetë vjeç, më 1878, kur plasi prapë kryengritja kundër Turqisë dhe patriotët shqiptarë po punonin me popullin pér ta pre-gatitur e pér ta hedhur në luftë. Edhe në fshatin Salari erdhën shkëndija nga flaka e madhe që ndezi Lidhja e Prizrenit dhe nga propaganda e gjerë që bëhej në qendrat e afërtë Tepelenë, Gjirokastër e Vlorë, kundër Turqisë. Si rezultat i kësaj, Selami, si dhe shumë djem të tjerë, u brumcsën me urrejtje pér pushtuesin turk. Në vitin 1879 dhe 1880 atë e kërkuan pér të shkuar të kryente shërbimin ushtarak

turk, por ai nuk u paraqit, dhe që nga ajo kohë qëndroi gjysmë i fshehur, duke u ruajtur që të mos u delte në sy njerëzve që ushtronin pushtetin. Për të mos i rënë në qafë kryeplaku e ndonjë tjetër, vetë ai hapi fjalë në fshat sikur kish paguar një njeri tjetër të paplaçkë e të pashtëpi dhe e kish dërguar bedel, në vend të tij. Kjo mund të besohej, sepse në atë kohë gjëra të tilla bëheshin jo rrallë. Mirëpo Selami nuk e kish bërë këtë dhe nga shërbimi ushtarak nuk mundi të shpëtonte. Në vitin 1881 atë e kapën dhe, me detyrim e nën vërejtje e nisën për në Azi.

Shërbimin ushtarak Selam Musai e kreu në kryeqytetin e Jemenit, Sanë, ku qëndroi gjashtë vjet. Në këtë kohë, bashkë me Selamin, e kryente shërbimin ushtarak dhe fshatari tjetër nga Salaria Islam Malua, i cili jetoi gjatë dhe me tregimet e tij ka hedhur pak drithë mbi jetën e Selamit në Jemen. Ky vend malor, i banuar nga një popull trim e liridashës, që pushtuar nga ushtria turke më 1872 dhe që kthyer në Vilajet të Imperatorisë Osmane. Sana shtrihej në një luginë të ngushtë. Ushtarët banonin në gazerma të mëdha, të ndërtuara në anë të qytetit. Shpeshherë, ditën, e sidomos natën vonë, dëgjoheshin krisma armësh, që tregonin se patriotët jemenas bënin përpjekje me ushtarët pushtues.

Selami e pati shumë të vështirë të ambjentohej me vendin, me rregullat që ekzistonin në gazermë, e sidomos me disiplinën e përbuzjen që u bëhej ushtarëve të kombësive të tjera nga zabitët¹⁾ turq. Ai pati disa herë grindje me eprorët atje. Për shkak të

1) oficerët

këtyre grindjeve, që vinin kryesisht nga sjellja brutale e fyeze e eprorëve dhe nga krenaria e ruajtja e dinjitetit nga ana e Selamit, atë njëherë e arrestuan dhe e futën në burg, ku e mbajtën rrëth një muaj. Shkaku i dënit të tij qe se një oficer turk, gjatë stërvitjes e shau Selamin. Ky iu përgjigj po me fyerje. Atëherë turku, i cili nuk qe mësuar që ushtarët t'i kthenin fjalë, i tërbuar nga përgjigja e Selamit, u drejtua nga ai me hapa të shpejta dhe duke e sharë «pis arnaut» (shqiptar i ndyrë). Selami u hoq mënjanë dhe rrëmbeu armën, po e kapën të tjerët e nuk e shkrepit dot. Që atë ditë e futën në burg.

Shpeshherë Selami me fshatarin e tij hidhnin sytë nga veriu, andej nga binte Shqipëria, dhe me mallëngjim kujtonin vendin e tyre, njerëzit; i kish marrë malli pér çdo gjë, edhe pér gurët, edhe pér drurët e pyllit. «Ah, të kisha një copë borë nga ajo e Këndervicës — i thosh Selami shokut, — e ta vija në buzë, në ballë e në gjoks!»

Kur qe aty në Jemen, Selam Musai ra në kontakt me shqiptarët e mërguar, që punonin e luftonin pér zgjimin e ndjenjave kombëtare, që përhapnin shkrimet e rilindasve dhe që propagandonin kundër Turqisë. Këta patriotë banonin në Misir e vinin në Jemen pér punë të ndryshme. Përveç të tjerave, kur qe duke kryer shërbimin ushtarak, Selam Musai pa edhe trimërinë e qëndresën e malësorëve jemenas, shumë prej të cilëve, megjithëse kishte kaluar një kohë relativisht e gjatë që vendi i tyre qe pushtuar, vazhdonin të qëndronin të panënshtuar, e herë pas here edhe zinin prita ose godisnin në befasi garnizonet e ushtrisë turke. Disa episode dhe përpjekje të jemenasve, ai i mbante mend dhe i tregonte me kënaqësi më vonë.

Kur u kthyе nga Jemeni në atdhe, Selam Musai qe bërë burrë. Kish një trup mesatar shumë të zhdërvjellët, të ngjeshur, të fortë, tërë muskula, shpatulla të gjera, qafë të trashë, fytyrë zeshkane, me sy të zez të mëdhenj, me mjekër të kthyer pak para. Qimet e bardha në flokë filluan t'i delnin para kohe. Kish zë kumbues e melodioz. Bënte shumë shaka. Të folurit e kish sipas rastit; kur nxehet, fliste ash-për dhe mund të përdorte fjalë të rënda, pa pyetur se me kë kish të bënte, kurse zakonisht fliste qetë, i matur, i shtruar. Po mbi të gjitha, ai mbahet mend si njeri zemërmirë, i guximshëm, i besës dhe i mençur.

Selami, me t'u kthyer nga ushtria, iu vu punës për mëkëmbjen e ekonomisë shtëpiake, e cila kish rënë shumë. Ai s'kish as shtëpi të përshtatshme për të banuar familja e tij e madhe, prandaj, në radhë të parë, ndërtoit shtëpi të re. Duke qenë bagëtia i vetmi burim që siguronte të ardhurat për mbajtjen e familjes, bashkë me të vëllezërit, u muarën vetë me to dhe kështu i shtuan e i bënë kope, e cila u njoh më vonë si një nga kopetë më të mira të Salarisë. Tokë buke familja e tij kish fare pak, vetëm atë që kish trashëguar nga i ati, po megjithatë, Selami nuk e shtoi dhe bukën e familjes e siguronte duke shitur prodhimet blektorale e duke blerë drithë në fshatrat e Mallakastrës ose të Vlorës. Ai nuk mundi gjithashtu të blejë dot kullota dimërore për bagëtinë, kështu që i dimëronte në kullotat e të tjerëve duke paguar sipas rregullit topjakun për çdo kokë.

Shtëpia e Selamit qe e hapur e mikpritëse jo vetëm për miqtë e shokët e tij po për të gjithë. Salarjotët tregojnë se Selami kish një parim në pritjen e njerëzve: «Të gjithë ata që të vijnë në shtë-

pi, qofshin miq e të njohur ose jo, janë miq e duhen pritur si miq». Dhe në shtëpinë e Musarajve edhe njerëzit që ktheheshin atje sepse mund t'i kishte zë-në nata, priteshin e përcilleshin si miq të vjetër.

Selami kërkonte të kishte gjithmonë rregull e pastërti jo vetëm në shtëpi, por edhe në stan. Si në mal, ku kalonte verën, ashtu dhe në kullotat dimë-rore, ai ngrinte tri kasolle, të ndërtuara bukur, me kujdes dhe të mbuluara mirë. Një e përdorte vetëm pér miqtë, një pér të banuar vetë me shokët e tjerë dhe një pér të banuar stanaria, pér të mbajtur bulmetin e ushqimet dhe pér të gatuar.

Si gozhdë në zemër i qëndronte Selamit vrasja e vëllait, Nexhipit, nga Jashar Kordha. Hasmi i tij ishte aty afër, në lagjen Deliaj, dhe ai, donte s'donte, do t'i delte përpara Selamit. Kështu që Selami duhej të merrte gjakun e të vëllait, ky qe zakoni i vendit, i trashëguar nga të parët, se ndryshe ai mbetej i turpëruar. Selam Musai po mendohej pér këtë çështje. Në njérën nga faqet e murit të dhomës së tij qëndronte e varur një pushkë manzer dhe një gjerdan i mbushur me dy radhë fishekë. Sa herë ulej në qoshe, vetëm të qe ose me shokë, ai hidhte sytë dhe e shikonte, gjaku i hiptë në kokë, dhëmbët i kërcisin nga zemërimi. «Duhet marrë haka!» mërmëriste me vete. Bile edhe qe nisur e i kishte zënë pritë hasmit pér ta vrarë, po prapë qe kthyer në shtëpi, i dërmuar shpirtërisht. I vëllai, Dulja, qe më i vendosur pér marrjen e gjakut të vëllait dhe në biseda me Selamin pér këtë çështje kishin arritur deri në grinde. Po Selami qe vëllai i madh, kështu që i takonte atij të vendoste. Një luftë e brendshme ziente te ai, shpirti i qe trazuar. Një zë i brendshëm i thërriste në ndërgjegje: «Nuk është koha të marrim hak.» Po

nga ana tjetër dy zëra
 të fuqishëm e thërris-
 nin të kapte pushkën
 dhe të vriste hasmin.
 Njëri nga këta qe zëri i
 zakonit, dhe tjetri zëri
 i s'ëmës, Beqares, e ci-
 la ngulte këmbë që t'i
 merrej haka të birit të
 vrarë pa bërë faj. Ajo
 disa herë ia kish hedhur
 në sy Selamit turpin që
 kish dera e Musarajve,
 dhe një herë, para një
 mikut të shtëpisë, i tha:
 «Po të mos kisha djem,
 do ta merrja vetë dyfe-
 kun e do ta vrisja has-
 min. Po unë kam pjellë
 djem, dhe në jini djem-
 të e mi, për këtë hall u
 dua!».

Pas kësaj bisede të
 rëndë e të hidhur Sela-
 mi mori pushkën, u nis
 për në mal, ku kish ko-
 penë e dhene. Rrugës
 ai po mendohej, i godis-
 nin në tru fjalët e s'ëmës.

Për një çast i jepte hak, po në këtë kohë edhe pa-
 triotët që punonin për zgjimin e urrejtjes kundër
 Turqisë, propagandonin bashkimin e vëllazërimin e
 popullit për luftë kundër armikut të vendit. Selam
 Musai kish rënë në kontakt e mbante lidhje me këta



Ziliha Musaraj gruaja
 e Selam Musait
 Vdiq në mars 1944

patriotë dhe idetë e tyre i kish përqafuar e i kish bërë të tijat. Prandaj ai, kur shkonte lart malit, veç zërit të mëmës, i kumbonte në vesh edhe zëri i atdheut, i ardhur te ai nëpërmjet punës së patriotëve.

Dhe Selam Musai vendosi të mos e merrte gjakun e vëllait. Ai dërgoi një mikun e tij te hasmi, me anën e të cilit e lajmëroi që nuk do ta merrte hakën në qoftë se vrasësi i të vëllait nuk do t'i delte para në sy të fshatarëve. Kështu u bë, hasmi shkonte punën e tij, duke u ruajtur që me Selamin dhe Dulen të mos ndesheshin ballë për ballë. Po edhe kjo nuk vazhdoi gjatë. Më 1908, kur u ngrit me forcë nga patriotët çështja e bashkimit të popullit për qëllimin e lartë: luftë kundër të huajit për të fituar të drejtat, midis të tjerave u shtrua edhe falja e gjaqeve. Në këtë vit në shtëpinë e Selamit, në odën e miqve, me ftesën e tij, kishin ardhur hasmit dhe disa burra nga fshati. Selam Musai, para të gjithëve po thoshte se gjaqet duheshin falur dhe se ai po e falte i pari hasmin që i kish vrarë vëllanë.

Megjithë presionin e nënës plakë, Selami nuk u lëkund. Ai u dha ish-armiqve të tij dorën dhe besën e burrit se këtej e tutje nuk do të ishin më armiq dhe se gjakun e vëllait ua kish falur.

Ky veprim ia ngriti mjaf autoritetin Selam Musat dhe e bëri njeri të njobur për urtësi e mençuri edhe jashtë fshatit të Selarisë. Të gjithë e kishin të qartë që ai e fali gjakun e vëllait, jo sepse s'qe i zoti, në trimërinë e tij nuk dyshonte njeri, po se qe shtyrë nga ndjenja e qëllime të tjera më të larta. Ky veprim i dha atij dorë të lirë që të ndërhynë edhe te të tjerët për të ndjekur shembullin e tij.

Fjala e Selamit dëgjohej nga të gjithë. Ai kish zotësi dhe aftësi t'u mbushte mendjen bashkëbise-

duesve për problemet që diskutonin. Selamin, në kë-të drejtim, e ndihmonin disa cilësi të tij. Ai njihte mirë zakonet e vendit dhe kish aftësi të dallonte të mirat nga të këqiat, qe njeri i drejtë, në gjykimin e çështjeve nuk mbante anë dhe qe shumë i gojës e i argumentonte në mënyrë bindëse ato që thoshte. Fshatarët tregojnë se kishte ndodhur që njerëz nga fisi i tij të kishin pasur grindje me ndonjë tjetër dhe Selami t'i kish gjykuar ata duke bërë fajtor atë që qe me të vërtetë, pavarësisht se mund të ishin të tij.

Qazim Dervish Hitaj nga Salariä, veteran i Luf-tës së 1920 dhe që e ka njobur vetë Selam Musanë, thotë: «Selami ishte si gjykatës në fshatin e Salarisë. Ai nuk lejonte asnje fshatar të shkonte e të anko-hej në qeveri, po i zgjidhte vetë grindjet, dhe i zgjidhët aq drejt sa të dy palët bindeshin e mbeteshin të kënaqur. Për pajtimin e gjaqeve e shuarjen e grindjeve Selamin e thërrisin edhe fshatrat e tjera. Ai qe shumë i gojës, ta kishte qejfi ta dëgjoje kur fliste».

Edhe sot, të moshuarit salarjotë tregojnë disa shembuj konkretë të punës së Selamit për shuarjen e vatrave të vrasjeve e të hakmarrjeve. Po përmendim nja dy prej tyre. Pasi u grindën në mal për kufinë e kullotës, Kana Liçi, nga fisi i dajove të Selamit, i preu fare dorën me jatagan Isa Dackës nga Dukajt. Sherri u zgjat, burrat e Liçeve i muarën dhe i burgosën në kala të Gjirokastrës, bagëtia e tyre mbeti, me gra e me fëmijë. Ata që u burgosën nga qeveria kërcënoin kundërshtarët, sepse, sipas tyre, qenë dënuar pa të drejtë. Atëherë në Salari u përhap kënga që këndohej me çdo rast e në të cilën Liçajt

i drejtoheshin kërcënueshëm vendit për të cilin qe bërë sherri:

*O Bratosh, o Lugu i gjatë,
Mbahi se do vimë prapë...*

Selami vjen apostafat që nga kullota dimërore dhe shkon e bisedon me të dy familjet për t'i pajtuar. Dackajt kérkonin të merrnin gjakun e pastaj të pajtoheshin. Selami i bindi të hiqnin dorë nga ai mendim dhe më në fund burra nga të dy familjet që qenë në hasmëri dhe burra të tjerë nga fshati shkuani në vend. Caktimi i kufinjve të kullotës qe shumë i vështirë, sepse shenja dalluese nuk kish dhe që të dy palët kishin pretendimet e tyre e nuk tërhiqeshin. Pasi i shkelën me këmbë gjithë vendet për të cilat bëhej sherri dhe pasi dëgjuan këshillat e Selamit u arrit një përfundim i drejtë.

Një grindje tjetër, e cila pati pasoja tragjike, qe ajo midis familjes së Hasanmemmajve dhe familjes së Liçejve. Shkaku qe se një plak nga fshati hyri fshe-hurazi në shtëpinë e Liçejve dhe vodhi një pushkë që qe varur në mur. Një grua, e cila desh të mbulonte vjedhësin e vërtetë, deklaroi se kishte parë një burrë të Hasanmemmajve që kishte dalë nga shtëpia e Liçejve me armën e vjedhur. Për shkak të kësaj intrige filluan vrasjet, të cilat bëhezin herë nga njëra anë e herë nga tjetra. Brenda një kohe të shkurtër u vranë dy burra e një grua nga Hasan-memajt dhe tre burra nga Liçajt. Disa burra nga të dy palët vdiqën nëpër burgje.

Selam Musai duke shkuar herë te njëra e herë te tjera shtëpi bëri shumë përpjekje për ta shuar

këtë ziarr të madh. «Ata që u vranë nuk ngjallen më, të shpëtojnë të tjerët» u thosh ai. Po gjakrat qenë ndezur shumë. Më në fund mblodhi burra zakoni edhe nga fshatra të tjera dhe ia arriti që t'i pajtojë të dy familjet. Nënët e atyre që qenë vrarë dhe atyre që do të vriteshin e uruan njëmijë herë Selam Musanë për këtë akt.

Selam Musai urrente dhe luftonte veset e këqia. Ai s'bënte dy herë bisedë me ata që gënjenin e s'mbanin fjalën. «Ai që s'ka besë, s'ka as nder. Një njeriu të tillë as sytë mos ia shiko!» thoshte ai. Gjithashtu Selami i shante e i urrente vjedhësit. Ai nuk e pranonte jo si shok po as si përzitës me bagëti një njeri që vidhite mallin e të tjerëve.

Ai bënte përpjekje që asnjeri të mos vidhët gjë-në e tjeterit. Kur merrte vesh gjëra të tilla mundohej me të gjitha mënyrat që të zbulohet vjedhësi, të dënohet sipas zakonit dhe plaçka e vjedhur t'i kthehet të zotit. Në Salari dhe fshatrat e afërtë me të, mbahen mend shumë episode të tilla. Njëherë, disa fshatarë nga Çorrushi kishin ngarkuar kafshët me misër dhe po shkonin në Tepelenë për ta shitur. Te përrroi i Salarisë atyre u dolën para një grup kusarësh nga Nivica, dhe, duke i kërcënuar me armë, u muarën misrin dhe çdo gjë tjetër që kishin me vete. Selami këtë ngjarje e mori vesh ditën e nesërme. Ai ngriti menjëherë në këmbë djem nga fshati, më në fund i zbuloi vjedhësit dhe i detyroi të kthenin një për një ç'kishin grabitur. Çorrushjotët e muarën plaçkën e tyre dhe shkuant, po të prekur në sedër. Ata nuk e mësuan as kush i grabiti e as kush i detyroi kusarët që t'ua kthenin prapë ato që u kishin vjedhur. Kështu që ata kundër salarjotëve donin të hakmerreshin. Selami atë dimër që me bagëti në

Romës të Mallakastrës. Në muajin prill ai me kopenë e dhënve po kthehej për në fshatin e tij. Çorrushjotët menduan që ky qe rast i mirë për të marrë hakën. Ata vendosën të vrisnin të zotin e kopesë, domethënë Selamin, dhe të thernin e të linin në vend gjysmën e bagëtive. Kur mbërriti në Kutë, Selami mësoi që te Çezma e thatë, kufiri midis Corrushit e Kalivaçit, i kishin zënë pritë. Ai i hipi kalit dhe u nis vetëm për atje. Mbi rrugë e nën rrugë ai dalloi njëzit e armatosur, të cilët qenë shtrirë e maskuar dhe po mundoheshin të mos binin në sy të kalimtarëve. Selami i pa.

— Tungjatjetani! — u thirri ai.

— Udhë e mbarë të qoftë në punën tënde! — iu përgjigjën ata, të cilët nuk e njihnin këtë njeri që u foli dhe prandaj nuk donin ta zgjatnin me të. Ata po prisnin salarjotin, që vinte me kopenë e tij.

Selami zbriti nga kali dhe shkoi te ata.

— Unë ju njoh dhe e di kë prisni këtu — u tha ai.

— Kë presim? — e pyetën ata, edhe me inat po edhe të habitur nga sjellja e këtij burri të panjohur.

— Mua më prisni.

— Ti vazhdo rrugën. Ne s'kemi punë me ty — iu përgjigj më i madhi i tyre.

— Unë jam Selam Musai — u tha ai, — dhe ju mua më kini zënë pritë.

Pas bisedës së gjatë që u bë midis Selamit dhe çorrushjotëve, ata u bënë miq dhe miqësinë e ruajtën për shumë kohë, kurse atë mbrëmje ai i mbajti ata për darkë dhe u shtroi raki e u theri një dash.

Të moshuarit tregojnë që një herë tjetër Selam Musai me kopenë e dhënve ishte në Mogila të Vas-

jarit. Binte shi. Ai me një shok qenë futur në një shpellë e po bisedonin. Para kishin shtruuar rakinë. Kopeja e dhenve qe pak larg. Në këtë kohë atje shkuan kusarë, e, duke iu drejtuar barinjve armët, kërkuan të merrnin një pjessë të kopesë. Njëri nga barinjtë vërvshëlleu sinjalin e njojur për raste rrezi-ku. Selami e dëgjoi, u qua dhe vrapi për te barinjtë. Kur u afrua, ai i pa ata të grumbulluar në një vend dhe kusarët me armët gati për zjarr.

Selami nxori revolverin dhe e mbajti në dorën e majtë, u fut midis kusarëve, iu afrua udhëheqësit të tyre, dhe, pa i thënë asnje fjalë, ia dha fort një pëllëmbë. Të gjithë u habitën. Barinjtë e tij prisnin që kusarët ta vrisnin, kurse ata megjithëse qenë kusarë e trima, veprimi i këtij burri të fortë e të egër i paralizoi.

— Jam Selam Musai — u thirri ai, dhe pastaj shtoi: — Hiqni dorë nga këto punëra të qelbura.

Nga veprimi i Selamit edhe barinjtë e tjerë u bënë të guximshëm. Shkëmbyen shumë fjalë midis njëri-tjetrit dhe më në fund kusarët hodhën armët në sup e u nisën të iknin. Po Selami i mbajti për darkë, dhe, para ndarjes me ta, u mori fjalën që të mos vidhnin më...

Të shumta janë veprimet e Selam Musait, të cilat dëshmojnë se ai jo vetëm qe burrë zakoni e patriot i vendit të tij, po në krahasim me kohën në të cilën jetoi, qe edhe njeri me mendime përparimtare.

3. Në gjirin e lëvizjes patriotike

Selam Musai, që i ri, u dallua në fshat për guxim dhe ndjenja patriotike. Te ai kish ndikuar propagandë e rilindasve për ngjalljen e ndjenjës kombëtare

dhe të urrejtjes kundër pushtuesve turq dhe nën-punësve vendës, të cilët u shërbenin atyre. Selami kishte dëgjuar nga patriotët shqiptarë të Misirit shumë gjëra që më parë nuk i dinte dhe nuk i kuptonte. Por ai vetë hyri në gjirin e lëvizjes patriotike në fillim të, këtij shekulli, kur lëvizja kombëtare shqiptare mori hov. Patriotët shqiptarë mëndonin që Shqipëria duhej të zgjuhej nga gjumi i shumë shkuve dhe të luftonte për të fituar të drejtat e saj.

Që nga viti 1905, në Tepelenë vepronë një komitet i isnehtë, i cili punonte aktivisht për çeljen e shkollave shqipe. Ky komitet më vonë drejtonte forcat patriotike në aksionet që bëheshin kundër turqve. Të gjitha këto veprime të patriotëve brenda e jashtë vendit, vinin edhe në vesh të Selam Musait. Ai që në fillim u tregua i gatshëm për t'i përkrahur patriotët e vërtetë dhe për t'i mbështetur aktivisht veprimet e tyre. Nga fundi i vitit 1905, me nismën e burrave patriotë salarjotë, midis të cilëve dallohej edhe Selam Musai, në fshatin Salari u mbyll shkolla turke dhe hoxha që mësonte nxënësit u përzu, duke i nxjerrë këtë shkak: «Populli nuk ka të të paguajë aq shumë sa do ti».

Më 1906 e më vonë në Jugë u krijuan çetat e para patriotike, të cilat i kthyen pushkën Turqisë. Më 1907 e 1908 u krijuan edhe çeta të tjera. Në janar 1907, Çerçiz Topulli komandant çete, i drejtoi popullit shqiptar një thirrje, në të cilën, veç të tjerave, thuhej: «Qëllimi ynë është të ngrihem i të gjithë së bashku, gegë dhe toskë, me armë në dorë dhe të luftojmë për lirinë e Shqipërisë sonë të dashur gjer sa ta fitojmë atë... Rroftë kryengritja e Shqipërisë së robëruar, e cila do t'i sjellë asaj lirinë dhe mirëqe-nien!»

Në prill 1907 Çerçis Topulli me shokë zbritën afër Vlorës dhe, duke kaluar fshat më fshat, bënë një punë të madhe propagandistike, si me konferenca e biseda ashtu edhe duke shpërndarë flamurë të vegjël kombëtarë dhe fotografi të Skënderbeut, të cilat i kishin prurë më vete. Në fillim të muajit mars 1908, dy shokë të çetës së Çerçizit, ditën në drekë, në mes të qytetit të Gjirokastrës, vranë komandanatin e xhandarmërisë turke bimbashin Halil bej, i cili tregohej shumë aktiv kundër patriotëve shqiptarë.

Selam Musai mbajti lidhje të ngushta me çetat patriotike, e sidomos me atë të Çerçiz Topullit. Ai e ktheu shtëpinë e tij në një çerdhe për luftëtarët e lirisë.

Selam Musai njihte personalisht jo vetëm Çerçizin po pothuajse të gjithë luftëtarët më të shquar të çetave të para të Kurveleshit e të Tepelenës si Demo Eminin, Ismail Kason, Shaqo Buxon, Abaz Nivicën, Kanan Malon, Hito Lekdushin, Tahir Liçajn, Asllan Velikon, Sulo Beqirin, Zeman Mashkullorën e të tjera.


E bija e tij, Sefë Selamia, kujton: «Në shtëpinë tonë, në fshat, dhe në stan, në mal, vinin të arratisur që i kërkonte Turqia. Këta kishin dalë malit dhe kishin bërë çeta... Njëherë, ka qenë aty nga darka, kur kish rënë muzgu i mbrëmjes, në shtëpinë tonë erdhën tre veta. I pari qe Çerçiz Topulli. Ai qe një burrë i gjatë e i hollë me leshra gjer mbi supe, në kokë kish një festë të zezë të qëndisur e me ca pulla të verdha. Në dorë mbante një dyfek të gjatë dhe në brez kish ngjeshur një gjerdan meshini të verdhë e një revole. Bashkë me të, siç e muarëm vesh nga më të mëdhenjtë, qenë edhe një Zeman nga Mashkullora e Abaz Dashi nga Nivica. Babai i priti mirë,

u theri mish e tha që të bëhej darkë. Ai ftoi edhe tre a katër burra nga fshati dhe u llafo sën gjer në mes të natës. Babai u dha ca krëhëra fishekë manxeri nga të tijtë, dhe, pasi fjetën nja dy-tre sahat, pa zbardhur drita, ata ikën për nga malet e Nivicës. Çerçizi dhe të tjerë të arratisur kanë ardhur shumë herë te ne».

Të moshuarit tregojnë, dhe këto vërtetohen edhe nga dokumentet arkivale që ka Muzeu historik i Gjirokastrës, se në korrik 1908, kur u kthyen në Gjirokastër Çerçiz Topulli, Bajo Topulli dhe Mihal Gramenua, Selam Musai shkoi në Topullaraj për t'i takuar dhe qëndroi atje. Ai mori pjesë edhe në pelegrinazhin që u bë në varrin e Hajredin Tremishtit, nënë muret e Kalasë, ku folën plot zjarr për trimëritë e dëshmorit të Mashkullorës, Bajua e Mihali. Çerçizi tha pak fjalë dhe pastaj urdhëroi që mbi varrin e shokut të tij të zbrazeshin disa batare pushkësh.

Gjithashtu dihet mirë nga salarjotët që, gjatë viteve 1907 e 1908, para shpalljes së Hyrjetit, Selam Musai mbante lidhje të ngushta edhe me një tjetër komandant çete patriotike, Nazif Hadërin nga Palavlia. Selami çdo pesëmbëdhjetë ditë conte te Nazifi fshatarin e tij besnik, Dine Belulin, i cili binte lajmet dhe të dhënrat e tjera të nevojshme. Dine Beluli luftoi kurdoherë përkrah Selamit dhe më 1943 dha jetën kundër pushtuesve të rinj gjermanë në afërsi të Gjirokastrës.

Pas shpalljes së Hyrjetit, përpjekjet e patriotëve shqiptarë për të fituar të drejtat nuk u kurorëzuan me sukses, xhonturqit nuk i mbajtën premtimet. U kapën prapë armët. Në mes të vitit 1911 malet e Jugut u mbushën prapë me çeta. Veç atyre që kishin



Një nga revolverët e Selam Musait

dalë hapët, edhe çdo fshat formoi çetën e tij, anëtarët e të cilave, duke kryer punët e tyre, qëndronin të armatosur e prisin sinjalin e caktuar për t'u mbledhur e për t'u nisur në luftë. Selam Musai u vu nga burrat e Salarisë në krye të çetës së fshatit të tij.

Zemërimi i popullit arriti kulmin.

Në një letër, dërguar në gusht 1911, nga Gjirokastra në Sofje, gazetës «Liri e Shqipërisë», midis të tjerave thuhej: «Parësia që u mblodh në Manastir të Cepos dhe që vendosi kërkimet, të cilat ia dërguan qeverisë dhe konsujve të huaj, në qoftë se nuk i vë në veprim qeveria turke atëhere... do të bëjmë atë që s'ia pret mëndja qeverisë xhonturke... Në qoftë

se turqit e rinj venë në programin e tyre që vetëm të zotohen dhe asgjë të mos mbushin, pushka ka për të krisur dhe gjaku do të bëhet lumë...».

Dhe pushka krisi. Çetat patriotike u hodhën mbi garnizonet e ushtrisë turke. Luftimet bëheshin të përgjakshme. Në njérën prej tyre, në Alipostivan të Përmetit, ra si burrat miku e shoku i ngushtë i Selam Musait, Nazif Hadëri, patriot i shquar dhe komandant çete.

Selam Musai, bashkë me disa nga fshatarët e tij, u hodh në kryengritjen e vitit 1911 dhe ka qenë në radhët e çetave patriotike.

Në një libër thuhet lidhur me këtë se Selam Musa Salaria ka luftuar aktivisht në Kryengritjen e vitit 1911 kundër Turqisë, nën drejtimin e Namik Delvinës, dhe ka marrë pjesë në luftimet që u zhvilluan në anën e Përmetit, ku u vra Nazif Hadëri.

Por Kryengritja e vitit 1911 nuk ia arriti qëllimit të caktuar. Më 18 gusht, në Tepelenë, u bë një mbledhje e përfaqësuesve të krerëve shqiptarë dhe të komandantëve të çetave të vilajetit të Janinës, ku u diskutuan propozimet e qeverisë turke, të cilat parashikonin gjuhën shqipe në shkolla, caktimin e nënpunësve që të njihnin gjuhën e zakonet e vendit, shërbimin ushtarak për t'u kryer në vilajetet shqiptare, mbajtjen e armëve me lejë të posaçme e të tjera. Kjo mbledhje i dha fund edhe kryengritjes për autonominë e Shqipërisë në Jugë. Por Kryengritja e 1911-s pati rëndësi të madhe për të ardhmen e atdheut, sepse ndezi edhe më tepër ndjenjën kombëtare të popullit, i shtoi besimin në forcat e tij dhe tregoi dobësinë e Turqisë, e cila u detyrua të hynte në bisidime me kryengritësit dhe t'u bënte atyre lëshime. Njëkohësisht ajo bëri jehonë edhe jashtë vendit dhe

i detyroi shtetet e tjera ta merrnin në konsideratë çështjen shqiptare.

Çeta e Salarisë, e udhëhequr nga Selam Musai, ashtu si edhe çetat e fshatrave të tjera, la armët dhe u kthye në punët e zakonshme. Por jo për shumë kohë...

KREU I DYTE

SELAM MUSAI KUNDËR SHOVINISTËVE GREKE

1. Në luftën e Janinës

Në tetor të 1912 shpërtheu Lufta Ballkanike kundër Turqisë. Shqiptarët prej vitesh kishin rrëmbyer armët dhe luftonin kundër Turqisë pér të fituar pavarësinë. Kryengritjet e Shqipëtarëve i kishin sjellë shqetësimë dhe dëme të mëdha imperatorisë Turke. Po në luftën Ballkanike kundër Turqëve Shqiptarët nuk u renditën dot krahas fuqive të tjera të Ballkanit, pér arësyse se qeveritë e Shteteve Ballkanike kishin qëllime shoviniste kundrejt Shqipërisë dhe synonin që pas shëmbjes së Turqisë të coptonin tokat shqiptare.

Ato, në asnjë mënyrë, nuk pranonin të drejtat e popullit shqiptar pér të fituar pavarësinë. Në këtë periudhë në masat popullore vazhdonte të ishte e gjallë fryma e luftës kundër zgjedhës turke, po njëkohësisht nga ana tjetër po bëhej gjithnjë më i qartë rreziku që kërcënonte Shqipërinë nga ana e armiqve të Turqisë, të cilët synonin që pas mundjes

së Turqisë ta copëtonin Shqipérinë dhe ta zhduknin kombin shqiptar.

Në këto kushte të vësntira nuk qe e lehtë të përcaktohej se çfar qëndrim duhej të mbante populli shqiptar kundrejt Turqisë dhe kundrejt shteteve ballkanike që qenë në luftë me të. Nisiativën përkëtë në Shqipëri e mori organizata patriotike «Shoqëria e zezë për shpëtim», e cila më 14 tetor 1912 bëri një mbledhje në Shkup, ku muarën pjesë shumë udhëheqës të lëvizjes patriotike dhe u arrit në përfundimin se: «Populli shqiptar po i kapte armët jo për të forcuar sundimin e Turqisë në Ballkan, por për t'i dalë zot tërësisë tokësore e lirisë së Shqipërisë...»

Në Veri ushtritë sérbe e malazeze pushtuan qytetet kryesore shqiptare si Prishtinën, Prizrenin, Gjakovën, dhe po u drejtoheshin Lumës, Matit e Mirditës. Në Jug, ushtria greke e theu ushtrinë turke në Tesali e Epir, hyri në Selanik, rrethoi Janinën dhe ju drejtua viseve shqiptare. Pra ishte politika shoviniste e fqinjëve, që synonin copëtimin e Shqipërisë, ajo që i detyroi shqiptarët në këtë periudhë të mbanin këtë qëndrim. Në luftë kundër ushtrisë greke vajtën edhe vullnetarë shqiptarë, të cilët u nisën nga qëllimi për të mbrojtur vendin e tyre nga rreziku që i kërcënonë. Në muajin nëntor 1912 në Tepelenë si dhe në krahina të tjera, u dha alarmi: «Shovinistët Grekë kërkojnë të pushtojnë tokat shqiptare». Barinjtë lanë kopetë dhe me pushkë në krahë o me hanxharë në brez u nisën për atje ku i kërkonte atdheu.

Selam Musai, një nga të parët, hodhi manxerin në sup, ngjeshi për mesi gjerdanin e fishekëve dhetitën e caktuar, duke qenë në krye të burrave sala-

riotë, shkoi në Tepelenë. Atje, nga fshatrat e Tepele-nës u mblohdhën më tepër se 400 burra vullnetarë. Këto forca u nisën për të luftuar në Janinë që t'u pritej vrulli ushtrive shoviniste greke e të mos futeshin në tokat shqiptare. Selam Musai u caktua si një nga drejtuesit e këtyre forcave. Rruga ishte e gjatë, megjithatë patriotët shqiptarë, duke ecur ditë e natë, arriten në zonën e Janinës dhe u vunë në dispozicion të komandës së ngarkuar për mbrojtjen e qendrës së vilajetit. Selami me një pjesë të forcave të Tepelenës, u caktua në Bezhan, një vend malor rreth dhjetë kilometra në jugë të qytetit të Janinës. Një pjesë tjetër e forcave, me në krye Ismail Kason, u caktuan më në perëndim.

Luftimet në Bezhan qenë nga më të rrëptat. Ushtria greke qe e pajisur më së miri, si me armatim të lehtë ashtu edhe me shumë topa, siç e thotë një këngë popullore, të cilët rrithnin papushim me zjarr të dendur pozitat e forcave shqiptare. Megjithë epërsinë e armikut, shqiptarët u bënë të fortë si shkëmbinjtë dhe jo vetëm që nuk lëviznin nga vendi, por herë pas here edhe kundërsulmonin e përlesheshin trup me trup me armiqtë. Më pas, për një kohë të gjatë u treguan trimëritë e tepelenasve në mbrojtje të Janinës, këngë nga më të bukurat u kënduan për ata trima që dhanë jetën atje ose që u bënë të gurtë e qëndruan para plumbave e gjyleve që u binin si breshër nga të gjitha anët.

Në një luftim, duke u futur midis formacionit të armikut, Selam Musai mori një plagë mbi vetullën e djathtë, nga një goditje me bajonetë. Pak ditë më vonë, kur po u printe shokëve në sulm, një plumb i shpoi kofshën tejpërtej.

Një ditë, aty nga fillimi i dhjetorit, Selami i

plagosur qe shtrirë në një hajat shtëpie që kish mbe-tur pa u djegur. Shokët qenë në pozicion pak më përpara, kurse forcat e ushtrisë greke të futura në llogore të thella po qëllonin me artileri për të çarë rrugën. Në këtë kohë te Selami vjen një lajmëtar dhe e njofton që Shqipëria shpalli pavarësinë. Selami s'u besonte veshëve. Ai e pyeti gjatë lajmëtarin dhe më në fund, pasi i kuptoi të gjitha, u ngre nga shtrati, u vesh, nxori revolverin nga këllëfi dhe i zbrazi të gjithë fishekët që kishte në mulli. U nis me vrap për te shokët. Këmba i dhimbte dhe plaga filloj t'i kullojë gjak, por ai fluturonte si fëmijë nga gëzimi. Kur mbriti në mes të luftëtarëve, thirri i emocionuar dhe i bërë flakë në fytyrë.

— Vellezër, Rroftë Shqipëri! Tani ne kemi Shqipërinë tonë!

Pasi u spjegoi me pak fjalë lajmët e reja, mori pushkën në dorë dhe u nis tutje duke u thirrur shokëve:

— Përpara, o burrani!

Luftimet përreth Janinës qenë nga më të ash-prat. Aty vetëm nga fshati Salari u vranë 7 veta, midis të cilëve Aqif Llaka dhe Braho Liçi e Vehip Liçi, që të dy kushërinj të parë të Selamit.

Megjithë luftën e ashpër që bënë patriotët shqip-tarë në Janinë për ndalimin e ushtrisë greke, ushtria turke po shpartallohej. Ushtrija greke, duke e mbajtur të rrethuar Janinën me periferinë e saj, hyri në Shqipërinë e Jugut dhe po përparonte duke pushtuar një pjesë të territorit tonë.

Në situatën e jashtme e të brendsme të krijuar, qeverisë së Vlorës i interesonte që lufta për mbrojtjen e Janinës të vazhdonte sa më gjatë, sepse ajo do të gozhdonte atje trupa të konsiderueshme greke, gjë

që do të pengonte përparimin e tyre në tokat shqiptare, si dhe do t'u tregonte Fuçive të Mëdha që shqiptarët po luftonin për mbrojtjen e kufinjve të tyre të jugut. Për t'ia arritur kësaj, qeveria e Vlorës kërkonte që lufta për mbrojtjen e Janinës të bëhej nën flamurin shqiptar dhe jo midis Turqisë e Greqisë po midis Shqipërisë e Greqisë. Për këtë qëllim ajo dërgoi në Janinë një delegacion, i cili do t'ia shtronte komandantit turk kërkесën e saj.

Tregojnë se delegacioni që shkoi në Janinë u takua me shumë nga komandantët e forcave shqiptare, midis të cilëve që edhe Selam Musai.

Pamvarësish se kërkësës për ngritjen e flamurit shqiptar në mbrojtjen e Janinës nuk iu arrit, qeveria e Vlorës vendosi ta mbronte me çdo kusht Janinën. Në qarkoren e kryetarit të qeverisë, Ismail Qemalit, dërguar më 8 shkurt 1913 gjithë krahinave të Shqipërisë, midis të tjera thuhet: «Qeveria e përkohshme bashkohet me dëshirën e përgjithshme që është shfaqur për mbrojtjen e Janinës... Qeveria e përkohshme nuk ka ngurruar asnjë çast për të kryer me seriozitet detyrën e saj, që është të nxjerrë nga dora e armikut gjithë viset e Shqipërisë dhe bashkimin e tyre me Atdheun... Gjithë shqiptarët janë të detyruar të ruajnë tokën e tyre dhe ne jemi të sigurt se këtë detyrë do ta përmbushim me vend dhe si e do nevoja. Ne duhet të mos kursejmë as gjënë e as gjakun deri sa të shpëtojmë Shqipërinë nga armiku që e ka invaduar dhe që i kërcënohet gjithnjë. Prandaj duhet që, pa humbur kohë, gjithë patriotët shqiptarë të rrokin armët dhe të venë në ndihmë të Janinës...»

Si rezultat i masave të marra, nga krahinat e ndryshme të vendit u grumbulluan forca të tjera për

të shkuar në ndihmë të Janinës. I vëllai i Selamit, Dule Musai, bashkë me fshatarë të tjerë, muarën armët që kishin dhe u nisën, por ata s'mundën të hidhen në luftë. Megjithë qëndresën heroike të shqiptarëve dhe përpjekjet e gjithanshme të qeverisë së Vlorës për mbrojtjen e Janinës, më 21 shkurt 1913 ajo u muar nga ushtria greke. Rënia e Janinës qe rezultat i tradhtisë së komandës turke. Në këtë kohë Turqia kish marrë te poshtën dhe komandantët e ushtrisë, duke përfituar nga gjendja, po tradhtonin duke i dorëzuar qytetet e kështjellat pér një grusht flori. Kështu bëri komandanti turk i Selanikut, kështu bëri edhe komandanti i forcave që mbronte Janinën, Esat Pasha, i cili kapitulloi bashkë me forcat e tij, që, sipas shumë burimeve, përbëheshin prej 33.000 vetave.

Lufta pér mbrojtjen e Janinës, nga ana e shqiptarëve qe e ashpér. Luftëtarët shqiptarë që u kthyen që andej prunë me vete edhe shumë këngë, me anën e të cilave muza popullore pérjetësoi luftërat dhe trimëritë shqiptare. Midis të tjerave, në një këngë pér luftimet e Bezhanit thuhet:

*O Bezhan përmbi Janinë,
Treqind topa një të shtirë,
Treqind gjyle si zinxhirë...*

Pas marrjes së Janinës nga ana e grekëve, Selam Musai me forcat e tij u tërroq pér në Veri. Në lumin e Kallamatës dhe në afërsi të Paramitisë ai zhvilloi edhe dy luftime të ashpra me shovenistët grekë,

të cilët, gjatë kësaj kohe, veç luftës digjnin dhe fshafrat shqiptare e masakronin popullsinë.

Në fund të shkurtit, Selami, bashkë me forcat që komandonte, u kthyen në mënyrë të organizuar në krahinën e tij.

Por ai nuk e hoqi pushkën nga supi...

2. G r i b a

Ushtria greke, pas shpartallimit të ushtrisë turke, shkeli tokat shqiptare duke pushtuar njërin pas tjetrit qytete e fshatra dhe duke u sjellë me egërsi. Në mes të muajit mars 1913 ajo u gjend në portat e Tepelenës. Në një raport të nënprefektit të Tepelenës, Sulejman Luzatit, lexojmë: «Më 18 mars 1913 ora 10 e 30 minuta ushtria greke, e përbërë nga 400-500 kalorës, pushtoi Tepelenën. Në radhë të parë u muarën zyrat e administratës dhe postëtelegrafa. Të parën punë që bënë ulën flamurin shqiptar dhe ngriten atë grek. Komandanti grek quhej Mavromihali. Kish me vete edhe një kolonel rus e dy officerë».

Nënprefekti, Sulejman Luzati, vajti dhe kërkoi të bisedojë me komandantin e ushtrisë greke për këto sjellje e veprime të ushtrisë së tij kundër popullit shqiptar. Por ai iu përgjigj i nxehur e brutal: «Tepelena u pushtua dhe u shkel me fuqinë e shpatës dhe në emër të mbretit të Greqisë».

Shovinistët grekë e hoqën shpejt maskën si armiq vetëm të ushtrisë turke dhe që gjoja s'kishin të bënë me çështjet e brendshme të Shqipërisë. Ata filluan kundër popullsisë vendëse kime nga më mizoret. Shumë akte barbare kryen në atë kohë push-

tuesit grekë kundër shqiptarëve, akte që mbahen mend mirë edhe në ditët tona.

Ismail Kasua nga Dhemblani me detyrë primar ose kryetar komuneje në Shkozë i drejtohet në atë kohë qeverisë së përkohshme të Vlorës me një letër shqetësuese, në të cilën, midis të tjerave, thuhet: «Në Tepelenë, grekërit po bëjnë gjithëfarësoj gjëra të papëlqyera dhe mizorira. Flamuri ynë nuk është më... Komandanti grek ka bërë dje një shpallje ku thotë se ne duhet t'i dorëzojmë armët brenda 48 orëve...»

Selam Musai nuk qëndroi në zonën e pushtuar nga ushtria greke. Kur e pa që ajo do të pushtonte edhe fshatin Salari, ai e tërhoqi familjen dhe e vendosi në fshatin Dorëz. Kurse vitin tjetër e dërgoi edhe më poshtë dhe e vendosi në ullishtet e fshatit Shkozë të Vlorës. Në të njëjtën kohë Selami mblođhi edhe fshatarët e tjerë dhe i udhëzoi që t'i tërhiqnin familjet nga fshati e t'i kalonin në zonën e Vlorës, kurse aty të mbeteshin vetëm burrat e aftë për të luftuar. Karvanët e familjeve të Kurveleshit e të Tepelenës, ku kryesisht qenë gra, pleq, plaka e fëmijë, morën rrugën për në fshatrat e Vlorës. Pamja e tyre qe e dëshpëruar. Një këngë popullore kushtuar kësaj ngjarjeje, midis të tjerave, thotë:

*Gratë e Kurveleshit ·
Shkojnë për në Vlorë,
Me plaçka ngarkuar,
Me foshnjat në dorë.
Qaj, moj Shqipëri,
Uléri, moj e gjorë!*

Selami, bashkë me të vëllanë, Dulen, dhe gjithë burrat e tjerë salarjotë qëndruan në fshatrat e krahinës së Lopësit dhe po ndiqnin nga afër ngjarjet. Në fund të muajit mars via e kufirit midis forcave shqiptare e ushtrisë greke u stabilizua. Ushtria greke kish kapur Kuçin, Bolenën, Nivicën, Salarinë dhe pastaj kalonte lumin e Vjosës e vazhdonte tutje.

Ushtria greke në fillim bëri shtrëngime për çarmatosjen e popullit e, kur e pa që nuk ia arriti qëllimit, atëherë kaloi në tortura nga më mizoret, të panjohura deri në atë kohë. Në fshatin Bolenë zunë e pushkatuan një pjesë të barinjve që nuk kishin mundur të largoheshin dot, kurse të tjerëve u kthyen topat dhe i qëlluan me predha artilerie. Në Nivicë, ata që i kapën i rrahën, i varën me kokë poshtë dhe u vunë nga poshtë tymin e dëllinjave, kurse më guximtarët e të papërkulurit si Rizo Berdon, Kapo Begën e Dalan Kokën, pasi i torturuan si të tjerët, më në fund i mbathën me potkonj si kafshët. Tortura të kësaj natyre bënë edhe në fshatrat e tjera. Përpara këtyre veprimeve të ushtrisë greke, patriotët shqiptarë nuk ndenjën duarkryq. Ata, të organizuar në çeta të vogla, e godisnin armikun si rrufe e në befasë. Po përmendim një ngjarje në Salari, e cila tre-gohet edhe sot nga të moshuarit.

Në lagjen Deliaj në shtëpinë e Kordhejve, që qe e rrrethuar me mur të lartë, dhe në pozicion të përshtatshëm, qenë vendosur një oficer dhe tridhjetë ushtarë grekë. Një pasdite oficeri dërgoi dy ushtarë e thirri një burrë të moshuar.

— Do të na biesh katër desh dhe dy vajza — i tha ai.

Salarjoti shtangu në vend nga turpi, u bë flakë në fytyrë, po uli kokën, sepse armë me vete s'kishte.

Ushtarët e shtytën, e nxuarën jashtë oborrit dhe i dhanë afat dy orë.

— Po nuk i prure për dy orë — i tha oficeri me të çjerrë — deshtë dhe vajzat, do t'i marrim vetë atje ku i kini fshehur, kurse ty do të të varim për gjuhe.

Salarjoti u largua, dhe, pa humbur kohë, me anën e një djali të shpejtë lajmëroi Selam Musanë, i cili në këtë kohë ndodhej në malin e Dorëzës. Selami në krye të burrave të fshatit erdhi shpejt dhe rrithoi shtëpinë, pastaj organizoi edhe dy prita të tjera në atë drejtim nga mund të tërhiqeshin ushtarët grekë. Pasi e përfundoi çdo gjë, me zërin e tij kumbues i thirri oficerit grek që të delte e të merrte vajzat shqiptare, dhe, pa e mbaruar mirë fjalën, me manxerin e tij shënoi në dritaren e shtëpisë ku qenë futur pushtuesit grekë. Filloi lufta. Salarjotët, të egërsuar nga fyterja e pasembullt, donin t'i hanin të gjallë pushtuesit. Ata kaluan muret e larta dhe u përleshën trup me trup, duke përdorur më tepër hanxharët, sopatat, e, kur qe nevoja, dyfEQET. Ushtarët grekë u thyen dhe u vunë në ikje të çorganizuar. Por para tyre ata ranë në dy pritat e ngrehura nga Selami. Tetëmbëdhjetë veta prej tyre u vranë, kurse pjesa tjetër mbriti në fshatin Dukaj, ku kishte edhe forca të tjera greke.

Megjithë krimet e dredhitë, shovinistët grekë e panë që në mënyrë direkte e me forcën e armëve, nuk mundnin ta gëlltisin Shqipërinë e Jugut, të cilën e lakmonin. Prandaj për të justifikuar synimet e tyre nxuarën e fabrikuan çështjen e «Vorio Epirit». Në verën e vitit 1913, autoritetet ushtarake greke organizuan «Kompanitë e shenjta», në të cilat hynin, gjoja, vullnetarë vendës, ndërsa në të vërtetë ata detyronin

që të regjistroheshin në këto kompani të gjithë ortodokset shqiptarë nga mosha 18 deri 55 vjeç. Po, pasi edhe kjo nuk dha rezultatet e dëshiruara, komanda greke i plotësoi «Kompanitë e shenjta» me oficerë e ushtarë të ushtrisë së saj të rregullt, të veshur civila. Lidhur me këto manovra e dinakéri të grekërve, gazeta e shqiptarëve të Amerikës «Dielli», datë 9 janar 1914, shkruan: «Qeveria greke me anën e forcës mbledh tërë djelmirinë e atyre fiseve, i mvesh ushtarë dhe deklaron në botën e huaj se epirotët me një gjëzim të madh veshin petkat e ushtrisë greke... Oficerët e tërë i ka veshur me petka civile dhe i ka përzier me çetat. Ushtarët e rinj që ka mveshur në Korçë i ka dërguar në Tepelenë, edhe të Përmetit e Gjirokastrës i ka hedhur në Korçë...»

Përveç këtyre, qeveria greke pruri nga thellësia e vendit të saj, sidomos nga Gjiriti, banda të tëra të plotësuara me kriminelë e hajdutë, kryesisht të nxjerrë nga burgjet apostafat për këtë qëllim.

Më 17 dhjetor 1913 u caktua përfundimisht kufiri midis Shqipërisë e Greqisë dhe fuqitë e mëdha i kërkuan qeverisë greke që ushtritë e saj, brenda një muaji, të tërhiqeshin nga toka shqiptare. Por qeveria greke, duke shpresuar në planin e saj djallëzor të «Vorio-Epirit», bëri shumë dredhira me qëllim që ta shtynte afatin dhe të fitonte kohë.

Në shkurt të vitit 1914 forcat greke që qenë në drejtim të Salarisë, tentuan të pushtonin edhe pesë fshatrat e Lopësit: Dhemblan, Sinanaj, Matohasanaj, Labmartaloz dhe Dorëz. Përballë forcave greke, që nga mali i Këndervicës deri në lumin e Vjosës, qëndronin forcat e fshatrave të Lopësit, që drejtohen në Ismail Kasua e Selam Musai.

Ismail Kasua¹⁾, njihet si patriot. Ai kish marrë pjesë në lëvizjen e rilindasve dhe kish qenë një nga më aktivët në Kryengritjen e vitit 1911. Kish qenë pjesëmarrës i çetave patriotike dhe kishte luftuar kundër ushtrisë turke. Gjithashtu ai, bashkë me forcat e Tepelenës, kish luftuar për mbrojtjen e Janinës. Pas Shpaljes së Pavarësisë, qe emëruar nëpunës i qeverisë së Vlorës duke pasur detyrën e kryetarit të komunës, në fillim në komunën e Shkozës e pastaj në atë të Sinanajt.

Ushtria greke po preqatitej për sulm. Selamin, i cili ndodhej në Dhemblan, e lajmëruan shokët e tij se të nesërmen grekërit me shumë forca do të kalonin malin e Gribës dhe do të derdheshin nga Lindja dhe nga Jugu mbi fshatrat e Lopësit. Ai kish pak forca në gatishmëri në atë kohë dhe me to nuk mund t'i bënte ballë mësymjesh së armikut. U mendua pak, pastaj ia hipi kalit dhe me pak djem salarjotë doli në mal të Gribës për të parë ç'po ndodhë. Poshtë tij shtrihej gryka e Salarisë, e cila, që nga Qafa e Kreshës deri në Deliaj, qe mbushur me ushtarë. Selami nuk qe i qetë nga kjo gjendje. Ai tërë paraditen kaloi nga njëri drejtim në tjetrin. Qëndroi në Heremec të Dhemblanit prej nga dukeshin më mirë forcat e armikut. Qëndroi pa folur një kohë të gjatë. Në kokën e tij përpunoi planin e mashtimit të armikut, të cilin salarjotët e tregojnë edhe tani me një farë krenarie.

1) Më 1917 Ismail Kason pushtuesit italianë bashkë me të vëllanë, për aktivitet patriotik, e internuan në Itali. Që andej u kthye më 1919. Vdiq në dhjetor 1919. Ismail Kasua qe shok armësh dhe mik familjar me Selam Musanë, sepse djali i Ismailit ishte fejuar me Meton, vajzën e Selamit.

Selami nisi dy luftëtarë të tij për te komandanti i forcave greke dhe e thirri atë në takim. Ai erdhi bashkë me tre oficerë të tjerë, kurse Selami qe me dy shokë të tij. Ai nuk ia dha dorën komandantit grek, por e përshëndeti me kokë e pastaj ia filloi:

— Me ç'shohim, ju do të kaloni edhe në fshatrat e Lopësit, por populli është i armatosur e do t'ju presë me luftë. Këtë ne nuk e duam. Po ti duhet ta ndalosh ushtrinë tënde në vend deri sa unë t'i heq armët popullit.

Komandanti grek dëgjonte në heshtje. Atij i pëlqeu propozimi i komandantit të çetave shqiptare që kish përballë. Ai e kish të qartë se përparimi i ushtrisë greke dhe pushtimi i pesë fshatrave të tjera shqiptare nuk qe i lehtë. Në çdo hap që do të bëhej përpara, do të derdhej gjak. Pas çdo shkëmbi ose guri që kish përpara, do të qe mbështetur një shqiptar me armë në dorë dhe nuk do të shkulej kollaj që andej. Komandanti grek, në heshtje, po e shikonte Selamin, shikonte fytyrën e tij të vrenjtur, sytë e zes e të mëdhenj, që lëshonin xixa, shikonte mustaqet e tij të bardha borë...

— Sa kohë të duhet që ta çarmatosësh popullin?

— e pyeti ai.

— Dy ditë — iu përgjigj Selami, pa ia hequr sytë.

— Shumë — i tha oficeri grek.

— Sa t'i mbledhim, t'u flasim, t'i bindim.

— Mirë! — iu përgjigj komandanti grek dhe u largua.

Selami, pasi e mati edhe një herë oficerin grek që nga koka deri te këmbët, u kthyesh, mblodhi shokët e tij dhe që atë çast nisi nga një njeri për në çdo fshat.

— Tu thoni të armatosen sa më parë e sa më mirë dhe të bëhen gati për luftë — i porositi ai djemtë.

Tërë atë kohë që kish në dispozicion ai nuk püşhoi. Hipur mbi kalin e tij, kaloi në të gjitha fshatrat dhe u spjegoi burrave rrezikun që i kërcënonte. Gjithashtu ai, bashkë me Ismail Kason, u interesuan që luftëtarët të armatoseshin sa më mirë që të qe e mundur, duke bërë të gjitha përpjekjet, bile duke kërkuar armë edhe në fshatrat e tjera fqinje.

Pas dy ditësh, ushtria greke u nis. Po pasi bëri disa qindra metra, që nga lumi i Vjosës e deri në mal të Gribës, u gjend nën një zjarr të dendur e të rreptë. Pas pështjellimit të parë të shkaktuar në radhët e armikut, për shkak të befasisë, filluan luftimet nga afër. Vendi qe shumë i përshtatshëm për patriotët e fshatrave të Lopësit, mali ku po ngjiteshin pushtuesit grekë qe shumë i pjerrët dhe i zhveshur, kurse luftëtarët shqiptarë kishin zënë gjithë kresh-tën. Selam Musai, me një revolver nëntëshe dhe me një manxer turk, qëllonte shpesh e në mish. Të sokëlliturit e tij: «Para, o djem, shuajeni armikun!» dëgjo-hej deri larg. Kur ushtarët grekë iu ngjitën faqës së malit dhe po afroheshin në pozicionet e shqiptarëve, atëherë këta nisën sulmin e tyre duke u hedhur në luftim me ashpërsi e pa e marrë në sy vdekjen, mbi trupat e ushtarëve pushtues.

Në krah të Selamit gjendej gjithmonë trimi i rrallë e i dëgjuar Ali Rakip Llaka, vëllai i të cilit, Aqifi, kish qenë nën komandën e Selamit gjatë luftimeve të Janinës dhe atje kish dhënë jetën duke treguar trimëri të madhe. Selami, nga respekti që kish për Aqifin, tanë mbante me vete si trim të tij Alinë. Ky qe një djalë rrëth tridhjetë vjeç, me trup

të gjatë e të hollë, fytyrë të bardhë, pak të kuqë-rremtë, me sy të kaltër, flokë të verdhë, mbante mustaqe të kthyera majat përpjetë. Aliu njihej në fshat që i ri si djalë guximtar, trim, me sedër dhe serioz e fjalëpakkë. Mbante veshje të pastër, të qepur mirë e të stolisur sipas traditës. Ai kish bërë disa vjet shkollë, prandaj Selami e kishte jo vetëm si trim po edhe si sekretar të tij.

Luftimet vazhduan tërë ditën. Patriotët shqiptarë qëndruan pa bërë asnjë hap prapa dhe u shkaktuani pushtuesve dëme. Sipas tregimit të pjesëmarrësve, në këto luftime u vranë shumë grekër dhe disa u zunë rob. Pas tri ditë luftimesh të përgjakshme, forcat greke u tërroqën në pozicionet e mëparshme. Te Selam Musai dhe Ismail Kasua u parqit një oficer grek dhe kërkoi që këta t'i lejonin ushtarët e tij të tërhiqnin të vrarët dhe të plagosurat. Ismaili dhe Selami ranë dakord.

Selami e kuptoi që tërheqja e ushtrisë greke qe e detyruar dhe e përkohshme. Pushimi i luftimeve nuk do të vazhdonte gjatë. Prandaj ai bashkë me shokët e tjerë drejtues të çetave, organizuan, brenda mundësive që kishin, kompletimin e luftëtarëve me municion e armë nga ato që i qenë zënë armikut ose që kishin mundur të siguronin në fshatrat e tjera, si dhe furnizimin me ushqim. Selami i këshilloi shokët që këtej e tutje të mos i harxhonin më fishekët si në luftimin që u zhvillua, po të qëlllohej kur armiku të qe afruar dhe plumbi të godiste me siguri shenjën. Fshatarët e armatosur i mbajtën në gatishmëri këtë radhë dhe i lejuan të shkonin për t'u larë e përt'u ndërruar vetëm me radhë.

Komandanti grek, pas shuplakës që hëngri nga mashtimi i Selam Musait, vëndosi t'ia shpërbente

me të njëjtën mënyrë. Pasi kishin kaluar disa ditë nga zhvillimi i luftimeve në mal të Gribës, komandananti grek urdhëroi forcat e tij, që qenë përqëndruar në Salari e në Dukaj, që të bënин një manovër në drejtim të malit të Trushnicës dhe Qafës së Kreshës, gjoja sikur po e linin drejtimin e Lopësit e po kalonin në drejtim të Kurveleshit të Sipërm. Në të njëjtën kohë, me anë të spiunëve hapi fjalë se dy regjimente greke që qenë në Kurvelesh dhe forcat që qenë në Salari e Dukaj do të sulmonin për në Vlorë duke kaluar në drejtimin Nivicë-Vermik-Smokthinë-Vlorë.

Ky qe një mashtim, i bërë me qëllim që çetat shqiptare që qenë në drejtim të Lopësit të hiqeshin që andej dhe të kalonin në drejtim të Vermikut. Në këtë mënyrë ushtria greke do ta kishte të hapët rrugën për pushtimin e pesë fshatrave që kish përpara, pa ndeshur në qëndresën e pamposhtur të luftëtarëve shqiptarë.

Selam Musait ky lajm i erdhi në vesh nga drejtime të ndryshme. Ai menjëherë u këshillua me shokët e tjerë e veçanërisht me Ismail Kason e Dule Dalanin, komandant i çetës së Dhemblanit. Ata arritën në konkluzion se një gjë e tillë edhe mund të ndodhë dhe besohej, sepse rruga nga Vermiku në Smokthinë e pastaj Vlorë qe më e shkurtër nga ajo Salari-Sevester-Vlorë. U vendos që të peshohej mirë puna para se të veprohej.

Selami mundohej të kuptonte më shumë nga sa thuhej për lëvizjen e forcave greke. Dikush propozoi që pa humbur kohë të kalonin në drejtim të Vermikut dhe të zinin grykën ku kalonte rruga. Po Selami nuk qe dakord.

— Nuk dihet ç'pleksin në kokë komandantët e trupave pushtuese — u tha ai shokëve.

Ai nuk u nxitua dhe kështu nuk ra në kurthi e ngritur nga armiku. Selami u dha urdhër luftëtarëve të tij që të mos tundeshin nga vendi dhe të qenë gati për luftë, kurse në drejtim të Nivicës dhe Vermikut çoi disa djem të shpejtë e të zgjuar për të pyetur çetat e atyre fshatrave dhe për të parë edhe vetë nëse qenë të vërteta fjalët e hapura mbi lëvizjen e forcave të shumta greke në drejtim të grykës së Vermikut. Dinakëria e pushtuesve u zbulua. Në fshatin Salari, dhe në fshatrat e tjera të afërtë me të, edhe sot këndohet një këngë, e cila i kushtohet kësaj ngjarjeje:

*Grekërit dhëlpëri punuan,
Selamit erdh e i thanë:
Nga Vermiku ushtri shkuan,
Qëllimin e kishin bërë
Selamin për ta larguar
Bashkë me shokët e tërë
Dhe Gribën për ta sulmuar.
Po Selami i kuptoi
Me gjoks përballë u qëndroi...*

Në fund të muajit mars 1914 në mënyrë të besafishtë, ushtria greke sulmoi malin e Gribës. Sulmi u bë afër mëngjesit. Luftëtarët shqiptarë që ndodheshin roje gjatë kreshtës së malit hapën zjarr menjëherë. Selami ndodhej më poshtë, afër fshatit Dhemblan. Ai, sa dëgjoi armët, nisi për atje Ali Rakip Llakën me pak shokë për të parë se ç'po ndodhte. Aliu, duke vrapiuar e duke u hedhur nga njëri

gur në tjetrin, mbriti në kreshtën e malit, por pa hedhur asnjë hap më tej u ndodh disa metra larg ushtarëve grekë. Ai zuri vend dhe, pa e zgjatur, filloj luftën. Plumbi i parë i tij e goditi në kokë një ushtar grek dhe e la të vdekur në vend. Armiqtë qenë shumë. Aliu, duke u hedhur si sorkadhe nga njëri vend në tjetrin, u bashkua me shokët e tij, dhe i shpërndau ata lart malit, me qëllim që të mbulonin një sektor sa më të gjerë. Ushtarët grekë u hodhën në sulm. Aliu, vetë i pestë, s'i lejonte të afroheshin. Pas gjysmë ore lufte të rreptë, armiqjtë po mundohe-shin t'i rrëthonin. Aliu u çua më këmbë dhe i thirri oficerit grek që kish para të delte edhe ai në shesh të burrave e të përllesheshin të dy. Ai nuk e pranoi duelin, dhe në të njëjtën kohë u dha urdhër ushtarëve të qëllonin.

Aliu nuk qëndroi më pas pozicionit, po u çua dhe si luan iu drejtua vendit ku qe struktur oficeri grek. Edhe armiku u çua më këmbë dhe i drejtoi pushkën Aliut, i cili tanishte aq afër tij sa mund ta prekje me dorë. Dy pushkë u zbrazën në të njëjtën kohë. Plumbi i Aliut e goditi oficerin grek në lule të ballit dhe ai ra i vdekur në tokë, por edhe plumbi i armikut e goditi për vdekje Aliun dhe e rrëzoj.

Selam Musai, në krye të forcave të tij, mbriti vetëtimthi në vendin ku zhvilloheshin lurtimet. I ndau shokët sipas drejtimeve që sulmonte armiku. Vetë qëndroi në qendër. Duke ecur përpara ai takoi në trupin e Ali Rakipit, i cili kishte rënë pa jetë mbi trupin e oficerit grek. E mori ndër duar atë trim të rrallë, që e donte më tepër se vëllanë e tij dhe se këdo tjetër, e tundi një herë, e shikoi në fytyrë dhe e kuptoi që kish vdekur. Lotët iu derdhën përmes faqeve atij burri të moshuar, që nuk e kishte zakon

të qante. Krahërori i hidhej përpjetë nga emocioni. Në ato çaste mendja i vajti te Sulltana, mëma e Aqifit, i cili qe vrarë në luftën e Janinës, dhe e Aliut që u vra tanjë këtu në malin e Gribës. Që të dy kishin rënë dëshmorë për atdhe duke luftuar nënë komandën e Selamit. Ai i përsërise gjithnjë më vonë fjalët e Sulltanës që i kish thënë kur djali i parë qe nisur me Selamin për në Janinë: «Selam, të kam dorëzuar djalin, ma ki kujdes, se mezi e kam irritur» Edhe kur Aliu kish ngjeshur gjerdanin dhe kish hedhur pushkën në sup e qe rrështuar në getën e Selamit, ajo prapë i kish dalë përpara e i kish thënë: «Selam, vëlla, të kam dorëzuar djalin tjetër, kijma kujdes, se më zhuritet zemra!»

Selami e uli me kujdes trupin e Aliut në tokë, i pështeti kokën mbi një gur dhe u nis tutje mbi grekërit; si i tërbuar.

Në fshatrat e Tepelenës e të Kurveleshit këndohet edhe sot kënga e trimit Ali Rakip Llaka:

*Që në Dorëz e përpjetë,
Qajnë pleqtë e qajnë djemtë
Për Ali Rakipn e shkretë,
Që iu ngjit malit përpjetë,
Kapedanit i thérret:
— Dil në shesh, more lanet!
Dhe Selamit, kur i thanë
Që Ali Rakipn e vranë,
Liðhi duart e zu vajnë:
— Qaj, moj e zeza Sulltanë,
Paske pjellë për Junanë,
Dy djem që pate t'u vranë,
Një Bezhan e një në Majë.*

Atë ditë midis çetave që mbronin drejtimin e Lopësit dhe forcate greke u zhvilluan luftime që fshatarët pjesëmarrës në to i tregojnë si të pashem-bullta për nga ashpërsia. Selami u fut midis formacioneve të vijës së parë të grekëve dhe luftonte. Patriotët vendosën: të mbronin vendin, o të vdisnin që të gjithë aty. Çdo pëllëmbë tokë që merrej nga armiku lahej me gjak. Në një çast forcat greke u thyen dhe kreshtën e malit Gribë e zotëruan plotësisht luftëtarët e çetave.

— Me gurë, o djem! — thirri Selami.

Me këtë sinjal, patriotët merrnin gurë të mëdhënëj dhe i hidhnin poshtë në drejtim të armiqve. Vendi qe shumë i pjerrët, gurët që hidheshin nga sipër rrökulliseshin me uturimë që nga maja e malit deri poshtë në përrua, duke marrë me vete edhe gurë të tjerë e duke goditur ushtarët armiq, të cilët qenë të pambrojtur në brinjën e zhveshur.

Humbjet e ushtrisë greke në luftimin e Gribës qenë të mëdha. Pjesëmarrësit, si dhe të tjerë që kanë dëgjuar nga të afërmët e tyre, thonë që në atë luftim u vranë e u plagosën rrëth 200 ushtarë e oficerë grekë. Kurse Ismail Kasua në kujtimet e tij, të cilat ruhen dorëshkrim, shkruan se vetëm nga gurët e hedhur prej patriotëve të çetave, u vranë shumë armiq.

Me forcat greke si komandant kompanie qe edhe një kapiten plak, rrëth 70 vjeç, i cili qe kriminel dhe për krimet e tij qe dënuar në Greqi me 101 vjet burg. Tani ai qe nxjerrë nga burgu, i qenë dhënë kriminelë të tjerë, të cilët kishin veshur uniformën e ushtrisë greke, qenë armatosur dhe qenë dërguar të luftonin kundër shqiptarëve. Salarjotët e mbajnë mend atë plak me fytyrë të zezë, të gjerë, të mbushur me rru-dha e të pështirë; në gojë kish vetëm një dhëmb,

kurse sytë i zbardhnin duke bërë kontrast me fytyrën e tij dhe e paraqisnin më të neveritshëm. Atë e quanin kapiten Bollo, por ushtarët e tij e thërrisin kapiten Jero, domethënë plaku.

Ky plak qe futur në malin e Gribës midis një shpellë dhe po qëllonte me saktësi mbi patriotët shqiptarë. Vendi ku qe ai qe i mbrojtur nga të tri anët. Kapiten Bollua u bë i rrezikshëm. Plumbat e tij godisnin luftëtarët e çetave që po sulmonin. U kërkua një vullnetar për zhdukjen e tij. Dhe ai u gjend. Hajdin Xhelili, një djalë nga Dhemblani, duke vepruar me zgjuarsi e dinakëri, i doli armikut të rrezikshëm nga e majta dhe, duke e qëlluar me dy plumba, e shtriu vdekur përdhe.

Kapiten Jerua, me veprimet dhe krimet që bënte, kish mundur t'u fuste tmerrin ushtarëve të tij dhe qe krijuar te ata mendimi që ai ishte i paprekshëm nga plumbi e nga thika. Gjithashtu Bollua u kish futur bindjen ushtarëve se po të dorëzoheshin te kundërshtari, ai ish në gjendje që edhe robër t'i merrte prapë e pastaj t'i ripte të gjallë para shokëve të tjerë. Besimi që kishin ushtarët te komandanti i tyre dhe frika që u kish futur ai duket edhe nga ky episod që tregojnë salarjotët:

Një nga luftëtarët e çetës së Salarisë, Hasan Muçaj, në përlleshje e sipër trup me trup, i kish vënë grykën e pushkës në gjoks një ushtari grek dhe i kërkonte që ai të dorëzohej. Greku u llahtaris dhe, duke u dredhur, u përgjegj:

- Nuk mundem të dorëzohem. Më mirë vramë.
- Pse? — e pyeti Hasani.

— Sepse jemi betuar para kapidan Jeros që të gjallë të mos dorëzohemi. Po të dorëzohemi, ai vjen atje ku të jemi dhe na zhduk, — iu përgjegj ushtari.

— Kapedan Jerua u vra — i tha Hasani.

— Nuk është e mundur! Atës'e zë plumbi e s'e shpon thika.

Robërit që u kapën i shpunë në Dhemblan.

Në luftën e Gribës u vranë edhe 8 patriotë, midis të cilëve qenë Bajram Ademi e Kamber Skendua nga Salaria si dhe gjashtë veta nga Dhemblani dhe u plagosën 22 fshatarë të tjerë.

Dëshmorët e atdheut i muarën dhe i shpunë në Qafë të Mehmete, ku i varrosën me nderimet që u takonin. Ali Rakipin e varrosën në majën e malit Gribë, atje ku u vra. Me porosinë dhe kujdesin e Selam Musait, atij i bënë një varr të madh duke e shtruar poshtë e anash me pllaka guri të bardha e të lëmuara, kurse sipër i vunë një pllakë shumë të madhe, e cila i mbulonte krejt trupin...

Në vitin 1967, kur salarjotët e zbuluan varrin e Ali Rakipit për ta rivarrosur në varrezat e patriotëve, megjithëse kishin kaluar afër pesëdhjetë e katër vjet, skeleti i tij që krejt i paprishur. Në krah të tij gjëtën edhe një penë. Ishte pena që ai përdorte për të shkruar letrat që e urdhëronte Selam Musai.

Rapsodët popullorë i kanë kushtuar luftës së Gribës disa këngë, njëra prej të cilave është kjo:

*Viti më katërmëbëdhjetë
Shkeli Greku Shqipërinë,
Po ti, moj e shkreta Gribë,
Atje u vranë e u grinë,
U therë me bajonetë,
Dhe me gurë rrukullimë
Grekër dyqind e ca vetë
Dhe nga ne nja shtatë a tetë...*

3. Labova

Qeveria greke e Sofokli Venizellos, duke qenë përbalë qëndrimit të vendosur të popullit tonë, përtatë përzënë me hir a me pahir të huajin, dhe nën presionin e fuqive të mëdha, përti larguar ushtritë e saj nga territori shqiptar, bëri një lojë djallëzore, e cila i ngatëroi shumë punët dhe patriotëve shqiptarë u nxori telashe. Ajo, në mars 1914 organizoi në qytetin e Gjirokastrës «Kongresin epirot», i cili shpallli «autonominë e Vorio-Epirit» dhe formoi «qeverinë e përkohshme», nën kryesinë e Jorgo Zografos, ish-ministër i Jashtëm i Greqisë.

Në këto kushte për popullin shqiptar u krijua një situatë e rëndë. Duhej hedhur në luftë për jetë a vdekje, pa u lënë kohë pushtuesve të hidhnik rrënënjë. Dhe ashtu u bë. Forcat shqiptare u hodhën në sulm të përgjithshëm kundër shovinistëve grekë.

Prapë Selam Musai e Ismail Kasua u vunë në krye të çetave vullnetare të fshatrave të krahanës së Lopësit, të cilat, bashkë me çetat e fshatrave të tjera, morën detyrë të çlironin Tepelenën dhe pastaj të vazhdonin sulmin në drejtim Lekël, Kodër, Horëmovë, e Labovë. Djathtas sulmonin çetat e Kurveleshit të Sipërm, duke i goditur forcat greke në Golem, Kolonjë e Kardhiq.

Më 26 prill, forcat e fshatrave të Lopësit si dhe të Dukajt, Turanit, Memaliajt e Veliqotit hynë në Tepelenë. Në fshatin Luzat, më në jugë, rrëth një orë nga Tepelena, u bënë dy ditë luftime të ashpra e trup me trup. Në fshatin Kodër, ushtria greke kish vendosur të maskuar mirë topa e mitralozë. Kur luftëtarët shqiptarë po hynin në fshat, andartët grekë

dhe ushtria e rregullt e kthyer pas natën, fshehurazi, hapën zjarr të dendur me të gjitha armët e rënda.

Luftimet që zhvilluan luftëtarët shqiptarë me andartët dhe ushtrinë greke për çirimin e Tepele-nës dhe fshatrave përreth saj, qenë të përgjakshme e të vazhdueshme. Pjesëmarrësit edhe sot i tregojnë ato me hollësi, gjithashtu ato u vunë në dukje disa herë, si nga shtypi i vendit, ashtu edhe nga ai i kolonive shqiptare jashtë atdheut. Gazeta «Dielli» e datës 12 maj 1914, shkruan: «Beteja që u bë në të çliruarit e Tepelenës prej shqiptarëve ish mjaft e rrëptë. Beteja ish nga ato më të gjakosurat dhe shqiptarët dualën fitues.

Bandat e andartëve greke u shtërguan të lënë qytetin pasi u dhjetësuan. Epirotët në këtë luftë humbën édhe një flamur të autonomisë epirote, i cili u shpu prej shqiptarëve në Vlorë».

Kurse në një letër të dërguar nga fusha e luftës dhe të botuar po në gazeten «Dielli» datë 5 qershor, midis të tjerave thuhet: «E çliruara e Tepelenës prej shqiptarëve u bë me një trimëri të madhe, që do të mbetet e paharuar në histori të Shqipërisë».

Me luftë e përpjekje, deri në fund të muajit prill, u çliruan Nivica, Golemi, Kolonja, Damësi, Këlcyra dhe forcat shqiptare arritën deri në lumë të Kardhi-qit. Në Fushëbardhë, Kolonjë, e Humelicë u zhvilluan luftime nga më të përgjakshmet. Afër Kardhi-qit, në përleshje e sipër, u kap edhe një flamur tjetër i forcave armike dhe u dërgua në Vlorë.

Lufta për çirimin e fshatit Kodër, në jugë të Tepelenës, qe e ashpër dhe e shpejtë. Forcat greke qenë vendosur në pozicione të përshtatshme dhe kishin marrë urdhër nga komanda e tyre që të qëndronin në vend me çdo kusht.

Megjithë këto masa, forcat e Tepelenës, që drejtosheshin nga Selam Musai e Ismail Kasua, u hodhën në sulm brenda në pozicionet e armikut, dhe, pas disa orësh përleshje, e detyruan ushtrinë greke të lërë pozicionet dhe të tjeriqet duke lënë në vend shumë të vrarë e të plagosur.

Duke bërë fjalë për atë luftë gazeta «Populli» e datës 16 maj 1914, shkruante: «Më 7 të këtij muaji, vullnetarët, nën kryesi të Ismail Kasos e të Selam Musait, pasi muarën katundin Kodër, i vunë përpara andartët gjer në Lekël. Pas pak kohe muarën edhe Lekelin.»...

Edhe në Lekël forcat e ushtrisë greke u munduan të qëndrojnë e të organizojnë mbrojtjen, por forcat shqiptare, megjithëse më të pakta në numër, nuk u dhanë kohë. Çeta e Salarisë, pa marrë parasysh zjarrin e dendur që bënte armiku me të gjitha armët, u hodh në sulm dhe e detyroi atë që të viljej në ikje i shpartalluar duke lënë në vend veç të tjerëve edhe një top. Gazeta «Dielli» e datës 28 korrik, duke shkruar për luftën e Lekëlit, midis të tjerave thotë: «Shqiptarët, megjithëqë ishin të paktë, po luftonin me trimëri të madhe dhe në luftë e sipër zaptuan një top».

Masakra më e shëmtuar e shovinistëve grekë në Jugë është ajo e Hormovës. Më 28 e 29 prill 1914, andartët mblohdhën gjithë burrat e djemtë e fshatit dhe i mbyllën në kishën e Kodrës. Më 29 filluan zhdukjen barbare të tyre duke i masakruar. I merrnin dy nga dy nga kisha, gjoja si për t'i pyetur, e, pasi i çonin pak më tej, në një përrua, i thernin me thika e me bajoneta. Pasi therën gjysmën e tyre, dy burra që po i çonin për te përroi e kuptuan veprimin e andartëve dhe u thirrën shokëve që qenë

të mbyllur në kishë se grekërit po i thernin. Pas kësaj thirrjeje hormovitët e mbylliën nga brenda derën dhe s'pranuan të delnin jashtë. Atëherë anda-rët hipën mbi kishë, zbuluan çatinë dhe, duke qëlluar që nga sipër me mitralozë e pushkë, i vranë të gjithë ata që qenë brenda. Nga 203 veta, burra, pleq e të rinj që qenë arrestuar, mundi të shpëtojë, duke u ikur xhelatëve nga duart, vetëm një. Shumica dërmuese e të vrarëve qenë nga Hormova, por kish edhe disa nga fshatra të tjera, të cilët ushtarët pushtues grekë i kishin arrestuar ato dy-tri ditë.

Kjo masakër e tmerrshme i tërboi forcat shqiptare dhe i bëri të hidhen në sulm kundër shovinistëve e kriminelëve të pasembullt.

Të nesërmen e kësaj ngjarjeje tragjike Selam Musai, me çetat që komandonte, duke zhvilluar luf-time, mbriti në vijën Tërbuq, Labovë e Madhe. Forcat greke kishin kapur pozicione në vijën Hundëkuq-Labovë e Vogël. Vetëm në Labovë të Vogël andartët dhe ushtria greke përbëheshin nga qindra veta, nënë komandën e një majori.

Kur mbërriti Selami para pozicioneve të armikut, u bë natë. Sipas tregimit të Nazif Muçajt nga Salaria, pjesëmarrës në ato luftime, atë natë frynte një erë e madhe dhe bënte ftohtë shumë. Të gjithë qenë pështjellë në gunat e sharqet dhe qenë mbështetur pas ndonjë ledhi apo trungu pemë për t'u çlodhur. Selami nuk ia zbriti kalit po, bashkë me pak shokë, kaloi nga njëri drejtim në tjetrin për të parë vendin. Ai vendosi ta shfrytëzonte kohën e keqe dhe natën për ta zënë armikun në befasi. Aty nga mesi i natës Selami i mblodhi luftëtarët, u dha detyrat dhe u caktoi drejtimet e sulmit. Ata që kishin përvojë më të madhe luftërash dhe ata që qenë armatosur

më mirë, sidomos me manxerë turq, pushkë këto që në atë kohë konsideroheshin më të mirat, i caktoi për të sulmuar Labovën e Vogël, ku qenë forcat kryesore greke.

Kishte ende edhe dy orë natë kur filluan sulmin vullnetarët e pas tyre u hodhën edhe pak xhandarë që qenë në atë drejtim. Befasia e veprimeve të çetave shqiptare si dhe trimëria e vendosmëria e treguar në luftë për asgjësimin e armikut e dhanë rezultatin e tyre. Forcat e andartëve dhe të ushtrisë greke i lanë pozicionet dhe u vunë në ikje. Por pas tyre qenë forca të tjera dhe artileria, të cilat shpejt u vunë në veprim. Armiku kundërsulmoi. Luftimet më të ashpra u zhvilluan në kodrat dhe përrrenjtë midis Labovës së Vogël, Tërbiqit dhe Hormovës. Përleshja e egër zgjati katër orë. Më në fund forcat greke u tërroqjnë dhe zunë pozicione të reja më në thellësi të atyre që kishin më parë.

Një dëshmitar i ngjarjeve ka shkruar për atë luftë në një gazetë të asaj kohe, ku midis të tjerave lexohet: «Më parë filluan vetëdashësit e nga pas u ndihte xhandarmaria, lufta e rreptë u bë në një vend të zhveshur e të thatë, në disa përrenj midis Hormovës e Labovës. Pushkët zbrazeshin posa mitralozët, edhe, sado që fishekët e vetëdashësve u mbaruan, prapë fitimi i luftës mbeti nga ana jonë. Katër veta prej Salarie kishin zënë një vend të fortë e, si vranë prej armikut sa deshën, u ndihën shokëve të tjerë gjersa muarën fishekë...».

Ditën e dytë prapë u bënë luftime të përgjakshme. Kurse ditën e tretë me kërkesën e komandës së forcave greke u vendos nga të dy palët që të bëhej një pushim i përkohshëm i žjarrit.

U caktuan postërojet, kurse forcat e tjera u tē-

hoqën pak më në thellësi për të pushuar e për t'u kompletuar me materialet e nevojshme. Mirëpo komandanti i trupave greke nuk e respektoi armëpushtimin. Në mbasdite rojet e tyre qëlluan në mënyrë të befasishme rojet shqiptare. Dëshmimtari i asaj ngjarjeje, Nazif Muçaj, tregon:

«Qe bërë marrëveshje pér pushimin e zjarrit. Mirëpo afër darkës pushtuesit grekë, me të pabesë, qëlluan me armë karakollin tonë. Selam Musai doli para në një breg dhe thirri komendantin grek e i kërkoi arsyen pse s'e mbajtën fjalën. Komandanti grek iu përgjegj si me tallje: «Mos u trembni. Ju shqiptarët jini trima, si u trembët nga armët e rojeve?» Selami u nxe dhe iu përgjigj grekut: «Ne, aq sa jemi trembur deri tani aq do të trembemi edhe këtej e tutje. Po ju qenkeni të pabesë!» Selami e kuptoi që ushtria pushtuese do na sulmonte, prandaj na mblo-dhi të gjithëve e na porositi që të kishim kujdes e të ishim gati.

«Duhet të flini me sy hapët!» na tha ai.

Dhe me të vërtetë, më të nesërmen që në mëngjes andartët dhe ushtarët grekë u hodhën në sulm kundër çetave të luftëtarëve shqiptarë. Luftimet qenë të ashpra dhe të përgjakshme.» Nazif Muçaj, i cili mori pjesë vetë në ato luftime, kujton me një farë ndjenje krenarie po dhe i mallëngjyer pér trimërinë shqiptare. Ja se ç'thotë ai pér komendantin e tij, Selam Musanë: «Selami tërë ditën luftoi më këmbë. Herë pas here sokëlliti me zërin e tij, që na vinte në vesh si ulurimë, sa që neve na ngjethej mishtë kur e dëgjonim. U hodhëm në llogoret e ushtarëve pushtues. Në krye qe Selami. Ai në ecje e sipër vrau me dyfek një oficer grek dhe iu hodh sipër një ushtari e mbërtheu pér gryke pér ta mbytur. Nuk me-

rrej vesh se q'bëhej. Qemë pleksur keq dhe luftonim me dyfek e me thika. Vetëm nga veshja e njihnim njëri-tjetrin, kush qe yni e kush qe i huaj. Po edhe tymi i barutit na pengonte t'i dallonim shokët tanë. Aty u vranë shumë ushtarë grekër, dhe ne i muarëm llogoret e tyre. Po kur Selami doli në një majë kodre, ku qe edhe një pemë e vogël, dhe po qëllonte me dyfek ushtarët armiq që kish afër, një oficer grek, u ngreh papandehur në këmbë dhe iu drejtua si bishë atij. Selami e qëlloi, po edhe ai ia dha flakë më flakë. Oficeri grek ra pa frymë në tokë, kurse Selami hapi pak këmbët, për t'u mbështetur më mirë, dhe po shikonte armikun të shtrirë. Ne e pamë atë dhe po habiteshim pse rrinte ashtu pa folur e pa qëlluar. I shkuam pranë. Ai vuri dorën në gjoks dhe pas pak xhamadani i bardhë u bë i kuq flakë. Nga dora i rridhte gjaku në tokë».

Selam Musai, në atë luftë, duke u ndeshur ballë për ballë me shumë armiq, u plagos rëndë, atë e mori plumbi drejt në sisë të djathtë dhe i doli pas në shpatull. Megjithatë, ai u mundua që ta mbante vehten dhe qëndroi ca me shikim të hedhur nga ana e armikut, atje ku vazhdonte përlleshja e shokëve të tij me andartët dhe ushtarët grekë.

Ata që u ndodhën afër tij i vajtën në ndihmë dhe u munduan ta tërhiqnin, por s'pranoi. «Lermëni të shoh si luftojnë djemtë», u tha ai dhe sytë nuk i ndante nga kodra para tij, ku zhvillohej luftimi.

Islam 'Malua, shoku i tij më i ngushtë, i pruri kalin, me qëllim që Selami të hipte në të dhe të largohej nga vija e parë për në spital. Po nuk donte të largohej, megjithëse gjaku i rridhte dhe rrobat e bardha iu ngjyen në gjak. «Shkonit në luftë, se unë nuk kam gjë», u tha ai shokëve. Këto çaste të jetës

së Selam Musait, rapsodi popullor i ka përjetësuar në një këngë, në të cilën midis të tjerave thuhet:

*Mu atje nënë Labovë,
U plagos Selami gjorë,
U plagos në krahër...
Edhe kalin ja shpunë:
«Mos trëmbi se s'kam gjë unë»...*

Selamin e hipën në kalin e tij dhe e shpunë në Tepelenë, ku e shtruan në spitalin e qytetit. Aty ishin dy mjekë holandezë, të cilët i filluan mjekimet. Por, për çudinë e tyre, Selami nuk pranonte të shtrohej në spital. Me anë të përkthyesit, ai u tha atyre që dëshironte t'ia lidhnin plagën dhe ta lejonin të kthehej te shokët në luftë. Këze Selamia tregon:

«Babanë e prunë të plagosur rëndë në spitalin e Tepelenës. Ai nuk desh të shtrohej, po e detyruan doktorët holandezë dhe shokët e tij. Më në fund pranoi të shtrohet po me konditë që të mos e mbanin shumë. Njëri nga doktorët holandezë i tha: «Për tetë ditë do të të shëroj, kapiten». Babai qëndroi në spital dy javë. Kur doli, i thanë që të vinte në shtëpi e të pushonte një muaj. Ai erdhi po ndenji vetëm dy net. Edhe ato dy net që ndenji ai s'ndjente rehat, dy herë në ditë dërgonte djemtë e fshatit në Tepelenë për të mësuar se ç'bëhej andej nga qe lufta. Ditën e tretë ia hipit kalit dhe iku. Plagën e kish akoma të pambyllur, përpara, në gjoks, ajo i dukej si një pullë e kuqe, po pas, në shpatull, qe e madhe».

Sipas Këze Selames, atij, gjatë kohës që qëndroi i shtruar në spitalin e Tepelenës, i caktuan posaçërisht n'ë grua rreth pesëdhjetë vjeç, që quhej Bukuri, e cila kish detyrë t'i ndërronte e t'i lante plagën.

Herë pas here ajo, sipas këshillës së mjekëve, i vinte atij në ballë peceta të ftohta. Selami nuk e harroi kujdesin dhe ndihmën që i dha Bukuria. Ai e quante atë motër dhe ajo Selamin vëlla. Kur familja e Burisë u shpërngul si muhaxhire për në fshatrat e Vlorës, ajo e kérkoi dhe e gjeti Selamin në ullishtet e Shkozës.

Pas daljes nga spitali, Selami u kthyte prapë te shokët e tij, të cilët qëndronin ende përballë armikut, atje në Labovë. Gjatë kësaj kohe forcat e të dy anëve nuk kishin bërë asnijë hap para ose prapa. Faktikisht që vendosur, në heshtje, një vijë kufiri. Po forcat greke nuk pushonin së provokuari në mënyrë të pasbesë. Dëshmimtarët e ngjarjeve tregojnë shumë episode, ku duken veprimet dinake të andartëve, të cilët nga njëra anë shtireshin sikur do ta mbanin qetësinë e vendosur, kurse nga ana tjetër s'linin rast pa krijuar trazira e provokacione kundër shqiptarëve.

Në një rast, komanda greke u mundua t'i mashtronte forcat shqiptare dhe t'i rrëthonte e t'i asgjësonte. Ajo, në bazë të një plani të studjuar mirë, pruri fshehurazi ushtarë nga thellësia dhe i hodhi në sulm në mënyrë të befasishme. Gjithashtu, nga ana e Humelicës, vuri në lëvizje repartet që qenë atje dhe i futi në luftë për t'u marrë krahët e për t'i rrëthuar çetat e fshatrave të Lopësit, që qëndronin e s'tundeshin nga vendi.

Por Selam Musai me qetëni e Salarisë qëndruan heroikisht dhe ua prishën planin komendantëve grekë. Selami i dikttoi forcat që vinin nga Humelica dhe pa humbur kohë u doli përpara. Njëkohësisht ai lajmëroi çetat e tjera për rrezikun që u kërcënohej dhe se ç'duhej të bënин.

Në një gazetë të asaj kohe, midis të tjerave lexo-

het për këto veprime: «Më 28 të muajit që kaloi, të shtunën afër darke, shqiptarët e grekët në kufinjtë e hëpërhëshëm, qëlluan njëri-tjetrin. Atëkohë majori grek që qëndronte në Labovë të Vogël lajmëroi komandantin shqiptar në Hundëkuq, duke i thënë se u bë një gabim... jepni urdhër mbrojtësve të kufisë, si edhe unë, të mos goditim njëri-tjetrin... Ushtria shqiptare gjendej në Labovë të Madhe, në Tërbuq e në Hormovë, ushtria e armikut kishte kapur vendet strategjike e majat e malit. Të dielën në mëngjes një fuqi e re e grekëve ishte bashkuar me ushtarët e kufisë dhe ishte shtritur nga ana e malit edhe një pjesë tjetër kishte shkuar për të marrë krahët e shqiptarëve. Nga Labova e Vogël grekët mësynë me top e me pushkë e ushtarët shqiptarë filluan të kundërshtojnë, po kur panë që ushtria greke doli nga ana e Hume-licës edhe ishte frika se do t'i rrëthonë, me trimërinë e djemve të Salarisë, me në krye Selam Mu-sain, mundën të kthehen pa ndonjë dëm... Më një anë majori grek jep besën e fjalën e nderit, më anë tjetër e kthen edhe e dredh».

Pas thyerjes së sulmit të befasishëm të forcave greke, çetat shqiptare u hodhën vetë në sulm. Selami dhe komandantët e çetave u përgatitën mirë. Ata kishin diktuar që para tyre, domethënë në drejtimin Labovë e Vogël — Hundëkuq, komanda e ushtrisë greke kishte grumbulluar shumë forca. Pjesëmarrësit e asaj lufte tregojnë që ato arrinin në dy batalione. Megjithatë luftëtarët shqiptarë u bënë ballë atyre me sukses gjatë gjithë ditës.

Veprimet luftarake pushuan në mbrëmje. Po grekërit edhe natën vazhduan të rrihnin me topa e me mitralozë pozicionet e çetave të Salarisë dhe Dukajt. Afër mëngjesit lufta filloi prapë. Selami kërkoi

që të merrej patjetër Labova e Vogël. Komandanti grek u kish vënë detyrë forcave të tij që të ndiqnin shqiptarët nga Tërbuqi e Labova e Madhe.

Çetat u hodhën në sulm.

«O djem, i zini me dorë!» thirri Selami dhe u hodh para.

Në këtë kohë, atë vetë, kalin e tij dhe një nga luftëtarët e çetës së Salarisë i mbuloi tymi e flaka e predhave të artilerisë armike. Shokët që e panë këtë skenë po prisnin me ankth të përhapej tymi. Po, papritur, Selami hipi mbi kalë, u kaloi para dhe, si i tërbuar, arriti luftëtarët që po luftonin me armiqjtë. Ai zbriti nga kali dhe u fut midis shokëve të tij. Grekërit qëndronin me këmbëngulje, dhe herë pas here në ballë ose në krahë hidheshin në kundërsulm. Por luftëtarët e çetave qenë sa trima aq edhe të kujdesshëm. Ata i thyen kundërsulmet e armikut dhe po e lëkundnin qëndresën e tij. Në radhët e forcave greke u vunë re lëkundje. Atëhere shqiptarët u hodhën para më me vrull, sulmuani më me guxim.

Të dy batalionet që qenë përballë çetave shqiptare, jo vetëm që nuk qenë më në gjendje të sulmonin ose të mbronin pozitat që mbanin, po, nën goditjen e furishme të patriotëve, po linin pozicionet dhe filluan të tërhoqeshin në panik. Duke e parë vreten në gjendje kritike, komanda greke e ndaloi zjarrin e artilerisë, që bënte kundër luftëtarëve shqiptarë dhe e drejtoi kundër forcave të saj, që po tërhoqeshin të shpartalluar.

Nazif Muçaj, pjesëmarrës i asaj lufte, tregon: «Grekërit u tërhoqën të turpëruar duke lënë edhe dyfegët në vend. Topat e tyre, që qenë vendosur pas një kodre në Labovë të Vogël, u kthyen e qëllonin ushtarët grekër, që iknin si lopët kur i zë zangali.

Për ne s'kish gjësim më të madh se sa kur shikonim që oficerët grekë, me topa e me dyfeqe vrisnin ushtarët e tyre....»

Pasi pësoi humbje në qendrën ku qenë çetat e Selam Musait, komanda greke e drejtoi sulmin në krahun e majtë të forcave të saj, me qëllim që t'u delte nga pas forcave shqiptare, t'i vinte në mes të dy zjarreve dhe t'i asgjësonë ose t'i detyronte ato që të linin pozitat e të tërhiqeshin.

Forcat greke mundën të kapnин një pjesë të pozitave të krahut të djathtë dhe po zhvillonin luftime të ashpra me çetën e fshatit Dukaj. Selami e vuri re këtë manovër të ushtrisë greke, dhe me të gjitha forcat e tij u hodh kundër armikut dhe në ndihmë të shokëve të tij. «Kapini me dorë, derrat!» thirri ai dhe, si shpatë, u lëshua mbi armiqjtë. Pas rrëth dy orë luftimesh në atë drejtim, sulmi armik u thye. «O burrani, përpara!», briti ai kur pa ushtrinë greke të thyhej.

Në një poemë të gjatë, të shkruar në atë kohë për luftën kundër shovinistëve grekë dhe të botuar në librin «Shpata e Labërisë», lexojmë edhe këto vargje:

*Vij' e luftës u ngjat shumë,
Vij' e luftës shumë u ngjat,
Kërceu përposht në lumë,
Në Labovë e në Zhulat.
Hollandezët u çudinë,
Se komanda nuk u shkoj,
Shqiptarët u vërvinë
Me shpata posa dragoj.
Labovë binte boria,
Të mbahet Kurveleshi,
Se vjen Selam Salaria,*

*Vjen për grekër si rrëbeshi.
Vjen Selam Musai vetë,
Djemt nën urdhër i vuri.
Salarinj njëqind e tetë,
Fshatin Hundëkuq e zuri,
Zuri fshatin Hundëkuq,
Dhe Labovës ju lëshua,
Tjetra pjesë mbi Tërbuq...*

Në këtë kohë edhe në krah të majtë të lumit Drino po zhvilloheshin luftime të ashpra midis forcave të Kurveleshit e të Kardhigit nga njëra anë dhe forcave greke nga ana tjetër. Sipas dëshmitarëve që i kanë parë vetë ngjarjet, kodrat nën Kolonjë e deri në Humelicë u mbuluan nga tymi i barutit. Fshatin Mashkullorë ushtria greke e dogji plotësisht.

Këto çaste lufte edhe rapsodët populorë i kanë përfjetësuar në këngët që vazhdojnë të këndohen edhe sot. Ja njëra prej tyre, në të cilën i bëhet jehonë trimërisë dhe zotësisë së Selam Musait:

*Kush u hodh proto në lumë?
Selam Musai furtunë,
Hundëkuq vuri hudunë,
Hundëkuq vuri graminë:
«O djem do vemi Janinë!...»
Kur sokolliti Selami,
Humelicës i ra zjarri.*

Në luftën e Labovës u vranë shumë armiq. Po aty u vranë edhe shumë patriotë. Nga Salaria vetëm

në një ditë pati shtatë të vrarë dhe shumë të plagosur. Midis të vrarëve qenë Hekuran Liçaj e Zano Musaraj, kushérinj të parë të Selamit, Shaban Muhamremi, kushériri i dytë i tij si dhe Shyto Jaupi, Hasan Borshi e të tjera.

Në Salari, në dasma e gostira, këndohen edhe sot këngë, të cilat flasin për trimëritë e bijve të atij fshati në luftën e Labovës kundër shovinistëve grekë si dhe për të kujtuar e pér të mos harruar kurrë ata që dhanë jetën për shpëtimin e atdheut. Ja një nga ato këngë:

*Moj Salaria në grykë,
Shtatë mandata një ditë,
Shtatë mandata u dhanë,
Atë ditë të Xhumanë,
U vra Zanua me Shabanë
Edhe Çunia me Serjanë...*

Trimëri e zgjuarsi tregoi në luftën e Labovës edhe Hysni Korra, luftëtar i çetës së Salarisë, i cili u plagos dy herë nga armiqjtë.

Selam Musait, në mbrëmje, pas një luftimi, midis humbjeve të tjera i thanë edhe për Hysninë, i cili kish mbetur i plagosur në sektorin ku qe ushtria greke dhe mund ta kishin zënë të gjallë rob. Ai u egërsua shumë dhe e shau ashpër atë luftëtar që kish qenë me të dhe e kish lënë vetëm shokun në rrezik. Megjithëse ia spjeguan urtë e qetë që atë s'e kish lënë njeri në vend po kish ndodhur në mënyrë të papritur, prapë atij s'i ra zemërimi. Selami dërgoi disa çifte njerëzish në vendet ku u zhvilluan luftimet, po ata u kthyen pa e gjetur.

C'kish ndodhur me Hysninë? Ai, në luftim trup me trup me një ushtar armik, kishte marrë një plagë. Kur e pa që po i dobësoheshin fuqitë dhe mund ta kapnin të gjallë, ai vendosi të tërhiqej më pas. Me të

qe edhe një luftëtar tjetër. Që të dy qëllonin me armë, duke ecur. Pasi bënë rrith dyqind metra, Hysniu u godit edhe nga një plumb tjetër në këmbë. Ra në tokë. «Vramë!» I tha ai shokut. «Pusho!» iu përgjigj shoku dhe vazhdonte të qëllonte. «Vramë, mos më lërë të më zënë grekërit të gjallë!» i përsëriti ai. Shoku i foli pér t'i dhënë kurajë dhe pastaj i tha që të zvarrisej edhe pak deri sa të kalonte një bokërimë ku do të takonte shokët. Hysniu po zvarrisej prapa, kurse shoku



Nazif Muçaj luftëtar i çetës
së Selam Musait

i tij zuri vend e qëndroi aty duke luftuar me andartët, të cilët qenë shumë afër. Pastaj edhe ai u tërroq e kaloi te shokët dhe kur s'e gjeti atje Hysnium, u tregoi atyre ngjarjen.

Hysniu, pasi iu ftoh plaga e s'ecte dot më, u fut midis një lofate pér t'u fshehur. Ditën tjetër

një ushtar grek e diktoi dhe po i afrohej duke e sharë. Hysniu e kuptoi që ai po i shante nënën e Shqipérinë. Pranë këmbës kish pushkën e mbushur. Greku i zgërdheshur në fytyrë si egërsirë, iu afrua. Në këtë çast, vetëtimthi, Hysniu e drejtoi grykën e pushkës në gjoks të armikut dhe tërhoqi gishtin. Ushtari ra i vdekur. Hysniu, duke u zvarrisur e duke u rrakullisur bokërrimave e brinjave, pas dy ditësh mundi të mbrrijë në Luzat dhe të bashkohet me shokët.


Hysni Korra luftoi edhe kundër italianëve në Vlorë dhe vdiq më vonë në burgjet e Zogut.

Pas këtyre ngjarjeve u ndërprenë veprimet luftarake dhe qeveria e princ Vudit mundohej ta zgjidhte çështjen e largimit të ushtrisë greke jashtë kufinjve të caktuar më 1913 me bisedime me qeverinë greke.

Por në gusht 1914 shpërtheu Lufta e Parë Botërore, si rezultat i së cilës Shqipëria u gjend në kaos të plotë. Ushtri të tjera të huaja, njëra pas tjetrës, hynë në Shqipëri.

Vullnetarët, me urdhër nga lart, u shpérndanë dhe shkuan në familjet e tyre. Selam Musai, bashkë me të vellanë, Dulen, shkuan në ullishtet e fshatit Shkozë të Vlorës, aty ku kishin familjen si muhaxhirë.

Në fund të vitit 1916, Selami me gjithë familjen u kthye në fshatin e tij Salari. Shtëpitë i qenë djugur krejt, edhe muret qenë rrrafshuar me tokën. Familjen, provizorisht ai e vendosi në shatorre, rrëth gjysmë ore poshtë fshatit, në një arë të vogël mbi vendin ku degëzohet rruga automobilistike e Kurvelleshit me atë Gjirokastër-Vlorë. Pastaj ndërtoi në fshat dy kasolle dhe u vendos aty.



Shtëpia e Selam Musait

Tani muzeu historik i Salarisë

Bija e tij, Këze Selamia, thotë që më 15 maj 1917
Selami filloi ndërtimin e shtëpive dhe më 15 gusht i
mbaroi e hyri brenda. Ato shtëpi janë edhe sot.

KREU I TRETË

SELAM MUSAI KUNDËR IMPERIALISTËVE ITALIANË

1. Atdheu në rrezik!

Imperialistët italianë vendosën që të zbarkonin në Shqipëri. Por ata nuk donin që pushtimi i vendit tonë prej tyre të shkaktonte ngritjen e shqiptarëve në luftë, prandaj ata, për t'ia arritur qëllimit, përdorën dredhinë.

Më 29 tetor 1914, Italia, nën pretekstin për t'i ardhur në ndihmë popullsisë së zonave të Jugut, të pushtuara nga ushtria greke, të vendosur në Vlorë dhe në fshatrat e saj, zbarkoi në qytet një «mision sanitar» ushtarak. Më 30 tetor të atij viti ushtria italiane pushtoi ishullin e Sazanit. Gjatë muajit nëntor e dhjetor, gjoja për të siguruar rendin, «doktorët» dhe «infermierët» e «misionit sanitar» arrestuan, burgosën e internuan shumë patriotë shqiptarë dhe më 25 dhjetor në Vlorë zbarkuan forca të shumta detare e tokësore italiane.

Populli shqiptar brenda vendit, si dhe ai i kolonive shqiptare të vendeve të ndryshme, e priti me indinjatë të thellë pushtimin italian.

Më 26 prill 1915, midis qeverisë italiane dhe qeverive të Antantës, u nënshkrua Traktati i fshehtë i Londrës, sipas të cilit Shqipëria ndahej midis shteteve fqinje. Italisë i njihej sovraniteti mbi Vlorën me periferinë e saj dhe mbi ishullin e Sazanit. Gjithashtu Italisë i njihej edhe protektorati mbi principatën e vogël shqiptare që do të krijohej midis lumenjve Vjosë e Drini. Krahinat e tjera në Jugë e në Veritë Shqipërisë do t'u aneksoheshin Greqisë, Sërbisë e Malit të Zi.

Në gusht të vitit 1916 Italia filloi dëbimin e ushtrisë greke nga krahinat e Jugut, për t'i pushtuar vetë. Në shtator e tetor trupat italiane hynë në Gjirokastër, Sarandë e Përmet.

Pas botimit, nga ana e qeverisë sovjetike, të Traktatit të fshehtë të Londrës, u zbuluan sheshit planet djallëzore të qeverive të Antantës për të kënaqur lakmitë e njëra-tjetrës në kurriz të Shqipërisë.

Edhe pas Luftës së Parë Botërore ushtria italiane vazhdonte të qëndronte në Shqipëri. Qeveria italiane po binte dakord me qeverinë greke për ndarjen e Shqipërisë së Jugut midis tyre.

Në këto kushte patriotët shqiptarë, duke parë rrezikun e madh, i dualën për zot vendit. Ata demaskuan komplotet italo-greke, kulmi i të cilave që marrëveshja famëkeqe Titoni — Venizello, e nënshkruar më 29 korrik 1919, Në një këngë të asaj kohë, kushtuar intrigave italo-greke në dëm të Shqipërisë, midis të tjerave thuhet:

*Italia me Greqinë
Merren vesh e venë e vinë
Që ta ndajnë Shqipërinë...*

Në Shqipëri u dha kushtrimi: «Atdheu në rrezik!» dhe u kërkua nga çdo shqiptar që të merrte armën dhe të bënte sakrificën supreme për të mos lejuar copëtimin e vendit.

Më 28 nëntor 1918, në përvjetorin e gjashtë të ngritjes së flamurit, vlonjatët trima u përleshën me ushtarët pushtues nëpër rrugët e qytetit. Komanda italiane i hodhi trupat e saj për të penguar manifestimin e shqiptarëve me rastin e Ditës Kombëtare. Patrioti revolucionar Avni Rustemi, që atë ditë, i revoltuar, deklaroi: «Toka e bukur e Vlorës dhe e tërë Shqipërisë është e jona. Në të duhet të rrojmë të lirë dhe asnjë fuqi nuk mund të na ndalojë dot nga ky qëllim».

Nga veprimet e ushtrisë italiane, populli i Vlorës dhe i gjithë Shqipërisë e pa qartë që Italia imperialiste nuk do të largohej nga Vlora me dëshirën e saj. Prandaj patriotët u hodhën në masa konkrete, duke bërë një punë të madhe agitative e propagandistike me popullin kundër imperializmit italianni dhe duke formuar komitete.

Në mars 1919, një grup mësonjësish e intelektualësh, midis të cilëve qenë edhe Halim Xhelua, Jani Minga, Murat Tërbaci, Abdurrahman Çiraku, Rexhep Sulejmani, Hasan Pulua e të tjerë, rreth tridhjetë veta, u mblohdën në fshatin Brataj dhe formuan organizatën revolucionare «Shtizat e qytetërimit». Më vonë kjo organizatë u quajt «Mbrojtja Shkollore» e pastaj «Mbrojtja Kombëtare». Organizata «Mbrojtja

Kombëtare», u zgjerua shpejt në të gjithë rrethin e Vlorës dhe vendosi lidhje edhe me patriotët e Tepelenës, Kurveleshit e Gjirokastrës.

Po në mars 1919 në Përmet ndodhi një ngjarje që bëri jehonë edhe në rrethet e tjera e veçanërisht në Tepelenë, Gjirokastër e Vlorë. Në atë kohë në Përmet shkoi një emisar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Autoritetet ushtarake italiane kishin marrë të gjitha masat që patriotët shqiptarë të mos binin në kontakt me të dhe të mos goditej politika italiane në Shqipëri. Megjithë masat e marra, dy ushtarakë shqiptarë, mundën t'i paraqitnin delegatit amerikan një notë, në të cilën dënohej pushtimi italian i Shqipërisë. Pas largimit të të huajit, ata u arrestuan nga komanda italiane dhe u futën në burg. Por Sihat Bega nga Nivica revoltohet dhe merr anën e dy patriotëve. Ai, bashkë me ushtarë të tjerë, ngre krye kundër pushtuesve italianë, vret disa prej tyre, hap burgun italian e liron të burgosurit dhe arratiset në male.

Më 28 Nëntor 1919 prapë në Vlorë u bë një demonstratë e fortë kundër pushtuesve italianë. Gjatë kësaj demonstratë ndodhi një gjë e pasembullt, e cila erdhi si rezultat i një provokacioni nga ana e karabinierëve italianë. Aty nga pasdita, karabinerët rrëmbyen një nga flamurët shqiptarë që printe në krye të demonstratës dhe ia veshën një qeni të tyre që quhej «Kaporale». Pastaj këtë qen e lëshuan nëpër rrugët e qytetit. Kjo u bë me qëllim për të fyer shqiptarët dhe simbolin e kombit të tyre. Pas këtij provokacioni, demonstruesit, të revoltuar më tepër, me lot ndër sy shprehën urrejtjen e tyre kundër pushtuesve dhe u hodhën në përleshje më me guxim. Italianët bënë arrestime të reja.

Edhe në rrëthim e Tepelenës patriotët po punonin kundër pushtuesve imperialistë. Po bëheshin mble-dhje të ndryshme, me qëllim që të propagandohej në popull urrejtja për të huajin dhe nevoja për t'u ngri-tur në luftë me armë në dorë. Një punë të mirë në këtë drejtim, veç patriotëve tepelenas, bëri edhe Avni Rustemi, i cili në vitin 1917 ishte arsimtar në Tepelenë. Avniu vendosi kontakte me patriotët e qytetit dhe të fshatrave, dhe, si nga më të preqatiturit që ish, u shpjegonte atyre detyrat e popullit në momen-tin e atëhershëm.

Nga disa fragmente të ditarit të Avni Rustemit, i cili ruhet në Muzeun e Gjirokastrës, del se Avniu është njojur me Selam Musain që më 1914, kur ai ishte duke luftuar në Labovë kundër shovenistëve grekë dhe më pas është takuar disa herë me të.

Salarjotë tregojnë që Selam Musai ka patur mi-qësi me Avni Rustemin dhe takoheshin shpesh. Ata tregojnë se në një kafe të ulët në Tepelenë, sipër në shkëmbinjtë e Vjosës, mblidheshin rrëth Avniut një-rëz, si Selam Musai, të mërkurave mbrëma, kur vinin për pazar në Tepelenë. Këtu, mësonjësi i shkollës, u bë mësonjës edhe për këta, duke lidhur miqësi e sho-qëri me luftëtarë trima si Selam Musai me shokë. Këto lidhje me patriotët tepelenas Avniu i mbajti edhe pasi u largua që andej.

Nga fillimi i vitit 1920, në rrëthim e Tepelenës u kalua në vepime konkrete duke bërë përpjekje të armatosura me ushtarët italianë si dhe duke bërë atentate kundër njerëzve që u shërbën pushtuesve dhe pengonin përgatitjen dhe ngritjen e popullit në luftë.

Një jehonë të madhe bëri në atë kohë, në Tepelenë dhe rrëthet e tjera, vrasja e nënprefektit Sulej-

man Shehut, në mars 1920 në rrugën Luzat Tepelenë. Ai njihej si proitalian dhe patriotët e thirrën atë dhe e paralajmëruan që të hijte dorë nga tradhtia e tij e të bashkohej me popullin kundër pushtuesit të vendit. Ai jo vetëm që nuk i përfilli paralajmërimet, po edhe u hodh aktivisht për të penguar lëvizjen kombëtare. Atëhere u vendos vrasja e tij. Vendimin e zbatoi një luftëtar i çetave patriotike. Mbi trupin e tradhtarit u la një copë letër me këtë përbajtje: «Kështu vdesin tradhtarët e atdheut!».

Kongresi i Lushnjës, që u mbajt në fund të janarit 1920, i drejtoi kryetarit të Konferencës së Pagues në Paris një telegram, në të cilin, midis të tjera ve, thuhej se shqiptarët ishin gati të bënin «të gjitha sakrificat, të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut të tyre, kundër çdo vendimi që do të vinte në rrezik tërësinë tokësore dhe pavarësinë e tyre të plotë. «Kongresi u dërgoi edhe një protestë parlamentit dhe senatit të Italisë, në të cilën janë edhe këto radhë: «Shqiptarët dinë të vdesin për të mos shkuar nga njëra dorë te tjetra si tufë delesh e të bëhen plaqë e atyre që dërgojnë sot diplomacinë e Evropës».

Si rrjedhim i masave që mori Kongresi i Lushnjës dhe i **veprimtarisë intensive** të qeverisë që doli prej tij, planet e fuqive imperialiste për copëtimin e Shqipërisë muarën një goditje të rëndë.

Qeveria italiane, në situatën konkrete që ndodhej, u përpoq të bënte disa manovrime për t'i mashtruar shqiptarët, prandaj ajo, përpara kërkesave këmbëngulëse të qeverisë së Tiranës, tërhoqi nga disa vende forcat e saj, me përjashtim të Vlorës, Tepelenës dhe Sarandës. Gjatë muajit prill 1920, ushtria italiane u tërhoq nga Përmeti, Këlcyra, e Gjirokastra, të cilat kaluan nën vartësi të qeverisë së Tiranës.

Po vazhdimi i qëndrimit të ushtrisë italiane në tokat shqiptare i revoltonte patriotët.

Në muajin prill brenda në Vlorë u krijuau Komiteti i «Mbrojtjes Kombëtare», i cili zhvilloi një vepрimtari të gjërë për preqitjen e kryengritjes. Anëtarët e komitetit dhe njerëz të caktuar prej tij shkuan në krahinat e tjera për të biseduar me patriotët dhe për të kërkuar mobilizimin e popullit për luftë.

Këta shokë u takuan edhe me Selam Musanë, luftëtarin dhe patriotin tashmë të njohur. Dhe Selami, pas atyre bisedimeve, i shqetësuar u tha fshatarëve të tij: «Duhet të ngrihem prapë. Atdheu është në rrezik!»

2. Prapë me armë në dorë

Selam Musai, ashtu si për shovenistët grekë, edhe për imperialistët italianë kishte një urrejtje të madhe. Gjatë kohës që ai qëndroi me familje në anën e Vlorës, nuk i shikonte dot me sy ushtarët e huaj, të cilët kalonin lirisht lart e poshtë, sikur të ishin zotërit e vendit. Këtë urrejtje ai ua shprehte shokëve dhe miqve të tij vlonjatë, po ata e ngushëllonin duke i thënë se duhej të mbaronte njëherë lufta e madhe, pastaj të shikonin se ç'duhej bërë.

Këze Selamia mban mend: «Kur familja jonë kthehej nga ullinjtë e Shkozës për në Salari, babai ecte më këmbë pranë mushkave. Në dorë mbante një bastun. Rrugës takuam shumë ushtarë italiane. Ai i shikonte ata me inat dhe shfrynte dufin duke thënë «Ah, breshkamëdhenj, edhe juve do t'ju vijë radha! Edhe juve s'do t'ju lëmë rehat!» Kështu thosh gjithë rrugës sa herë takonim në italiane dhe qe shumë i mërzitur, sa as bukë nuk hante».

Pas kontakteve me patriotët e tjerë vlonjatë e **tepelenas** dhe sipas udhëzimeve të tyre, Selam Musai mori masa për ngritjen e çetës patriotike të fshatit të tij. Për këtë qëllim, në muajin prill, bëri mbledhje e bisedoi me shokët e tij salarjotë, dhe duke folur me zjarr, u spjegoi atyre detyrat e reja që shtrohen, pér luftë kundër të huajt që kish zaptuar vendin. Si rezultat, patriotët salarjotë krijuan çetën e fshatit, në të cilën, herëن e parë, u regjistruan 80 burra e djem nga më trimat. Kurse në Luftën e Vlorës deri në mbarimin e saj, muarën pjesë më tepër se njëqind salarjotë, të cilët u treguan luftëtarë dhe trimë të rrallë, si tërë luftëtarët e çetave të tjera.

Pas organizimit të çetës së fshatit të tij, Selam Musai, si patriot e luftëtar i njojur, me porosi të shokëve të Tepelenës shkoi e bëri takime me patriotët e fshatrave të tjera të Tepelenës e të Kurveleshit. Në disa nga fshatrat e Kurveleshit ai qe bashkë me patriotin revolucionar Halim Xhelo dhe po punonin pér formimin e çetave në çdo fshat.

Veterani i Luftës së Vlorës të 1920-tës dhe i Luftës Nacionalçlirimtare, Jaho Gjoliku, në kujtimet e tij, mids të tjerave shkruan: «...në prill të vitit 1920, nën udhëheqjen e Halim Xhelos dhe të Selam Musait, u përgatitëm të hidheshim mbi pushtuesit, të mirrte vesh breshkamadhi së shqiptarët janë gjallë dhe Shqipëria është varr pér të huajt». Dhe më poshtë: «Të dymbëdhjetë gjeneralët italianë me ushtrinë e tyre u thyen në panik. Kështu Vlora e Halimit, Avniut, dhe e Selamit ishte dhe mbeti e jona».

Një nga mbledhjet më të rëndësishme, ku u dha besa e popullit të Tepelenës pér luftë kundër pushtuesve italianë dhe, në bazë të masave organizative që u muarën, siguroi ngritjen e popullit të krahinës

në luftë, qe ajo që u bë në Turan nga fillimi i muajit maj 1920.

Nga kjo mbledhje doli dega e Komitetit «Mbrojtja Kombëtare», ose «Komiteti i Tepelenës», siç e quajtën atë në atë kohë. Në komitet u zgjodhën Ahmet Turani, Ali Bença, Riza Runa, Arshi Shehu, Selam Musai, e të tjera.

Komiteti mori në dorë preqatitjen dhe drejtimin e kryengritjes, organizoi mbledhjen nëpër fshatrat e Tepelenës e të Kurveleshit dhe formoi çetat e luftëtarëve. Si rezultat i kësaj pune, nga fundi i muajit maj çdo fshat tashmë kish gati çetën e tij që do të hidhej në luftë.

Një rëndesi të madhe, dhe që u bë shkëndijë për t'i dhënë zjarr urejtjes popullore për pushtuesin italianni qe ngjarja e Tepelenës. Si u tha më lart, ushtritë italiane në muajin prill u larguan nga Përmeti, Gjirokastra e disa vendë të tjera, kurse Tepelenën e mbajtën, sepse ajo, sipas tyre, bënte pjesë në hinderlandin e Vlorës. Patriotët shqiptarë nuk u pajtuan me këtë veprim, prandaj më 17 maj, ditën e enjte, që bëhej pazar, ata tentuan të ngrënë në qytetin e Tepelenës flamurin kombëtar dhe të marrin në dorëzim qytetin për ta bashkuar me qeverinë e Tiranës. Mirëpo imperialistët italianë, të cilët kishin qëllimet e tyre të errëta, ulën flamurët shqiptarë, që qenë ngriitur në çdo dyqan e shtëpi, dhe u kthyen topat përfaqësuesve që do të vinin e të bisedonin me komandanë italiane për të marrë në dorëzim qytetin dhe hapën zjarr kundër tyre. Për të marrë pjesë në çlirimin e Tepelenës qenë lajmëruar e kishin ardhur shumë burra nga të gjitha fshatrat. Selam Musai, bashkë me të vëllanë dhe salarjotë të tjerë, kishin shkuar atë ditë në Tepelenë që në orët e para të mëngjesit. Pjet-

sëmarrësi drejtpërdrejt në atë ngjarje, Qazim Dervish Hitaj, në kujtimet e tij shkruan: «Më kujtohet se në një ditë maji u mblohdhën në Tepelenë shumë fshatarë, pothuajse nga gjithë katundet e Tepelenës. Atë ditë ishte e enjte... Në qytet tregtarët muarën urdhër që dyqanet e tyre t'i stolisnin me flamuj të Shqipërisë dhe ata ashtu bënë, në çdo derë dyqani u ngritën flamurët.

Karabinierët, kur panë këtë gjest, hipën nëpër kuaj, dolën nëpër qytet dhe flamujt i rrëzuan në tokë. Por populli u egërsua dhe donte të vepronte kundër tyre. Ai nuk kishte asnë lloj armatimi, ndërsa italjanët ishin të armatosur mirë. Aty, në atë kohë, ishte një burrë, emri i të cilit nuk më kujtohet, që u tha fshatarëve të grumbulluar të mos bënинasnë prim, italianët do ta paguanin së shpejti me lëkurën e tyre atë që kishin bërë atë ditë, dhe të ishin gati që kur të bëhej thirrja të mbushnin radhët e çetave të fshatrave të tyre».

Pas kësaj ngjarjeje u pa qartë që komanda italiane nuk do ta lëshonte Tepelenën pa luftë. Në këtë kohë Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» i Vlorës vendosi t'i bëjë thirrje popullit pér të rrëmbyer armët e pér t'u hedhur në luftë kundër pushtuesit. U vendos të bëhej një mbledhje me përfaqësuesit e fshatrave të Vlorës në Barçalla, një shpat mali në jug të Vlorës, afër fshatit Dukat. Mbi mbledhjen dhe qëllimin e saj u lajmëruan edhe Kurveleshi, Tepelena e Mallakasta. Pér këtë u lajmërua edhe Selam Musai.

Një luftëtar nga fshati Golimbash, i cili mori pjesë në preqatitjen e mbledhjes, në kujtimet e tij shkruan: «Pasi vendosëm datën e takimit pér në mbledhjen e Barçallasë i dërguam haber edhe anës së Salarisë me anën e Selam Musait».

Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» kërkonte nga rrrethet e tjera ndihmë konkrete duke dërguar në dispozicion të tij luftëtarë, sa të qe e mundur më shumë.

Komiteti drejtues i Tepelenës, anëtar i të cilit qe edhe Selam Musai, pasi llogariti forcat që do të hidheshin në kryengritje, cakttoi ato që do të merreshin me asgjësimin e garnizoneve armike që qenë në rrrethin e Tepelenës dhe ato që do të shkonin për në Vlorë.

Sipas vendimit të komitetit, disa nga çetat e Kurveleshit, ato të fshatrave të Lopësit dhe të Salarisë, Dukajt e Turanit do të shkonin në dispozicion të Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» për t'u përdorur në drejtim të Vlorës. Kurse çetat tjera do të përdoreshin për luftë me garnizonet e ushtrisë italiane në Tepelenë e në Matohasanaj.

Fshatrat e Lopësit, që përbëhen nga Dhemblani, Matohasanajt, Sinanajt, Dorëza dhe Martallozi, kishin çetat e tyre, të cilat qenë disa të mëdha e disa të vogla. Për shembull, çeta e Dhemblanit përbëhej nga dyzet e tetë luftëtarë dhe komandohej prej Dule Dalanit, ajo e Matohasanajt nga tridhjetë luftëtarë. Të pesë fshatrat formuan çetën e përbashkët, ose n'ë tabor, që përbëhej nga njëqind e pesëdhjetë luftëtarë. Komandant i çetës së Lopësit u caktua patrioti e triimi i njohur Dule Dalani nga Dhemblani, i cili njihej si luftëtar edhe më parë kundër pushtuesve turq e shovinistëve grekë. Ai qe plagosur në luftimet e vitit 1914 kundër andartëve. Dulja qe rrreth dyzet e pesë vjeç, me trup mesatar e të ngjeshur, mbante ca mustaqe të plota e të kuqërremta, fytyra e tij qe gjithmonë e çiltër dhe buzëgaz.

Çetat e fshatrave Salari, Dukaj e Turan, formuan

çetën e përbashkët, e cila përbëhej po ashtu nga një-qind e pesëdhjetë luftëtarë. Komandant i kësaj çete në fillim u caktua Selam Musai. Po, meqenëse Selami u emërua nga komiteti komandant i të dy çetave, ose taboreve të Tepelenës dhe do t'i përfaqësonte forcat e Tepelenës në Komitetin «Mbrojtja Kombëtare» kur të shkonte në Vlorë, në vend të tij komandant çete u caktua shoku i tij i ngushtë dhe luftëtar i vjetër Islam Malua, kurse nënkomandant Memë Sherifi.

Ngritjes së luftëtarëve tepelenas për t'u hedhur në luftë kundër pushtuesve italianë në Vlorë, muza popullore u kushtoi këngë të shumta e të bukura. Njëra prej tyre, e cila këndohet edhe sot me krenari, është kjo:

*Kur vate viti njëzet,
Selami mblodhi djemtë,
Ç'i mblodhi diemtë Selami,
O djem se iku vatani,
Vlorën me gjak do ta lani,
Të na njoħe italiani...*

Ditët e fundit të majit, Selami organizoi dhe mori pjesë në kryerjen e disa aksioneve ndihmuese, si prishja e urës në përrua të Salarisë, e cila lidhte garnizonin e Tepelenës me atë të Matohasanajt, preraja e linjave telefonike e të tjera.

Më 24 maj nga fshatrat Progonat dhe Golem u përzunë postat e karabinierëve italianë. Po atë ditë në fshatin Nivicë shkoi i deleguari i Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» Halim Xhelua. Ai, bashkë me Riza Runën dhe të tjerë niviciotë, ngritën flamurin kombëtar në mes të fshatit me solemnitet.

Më 25 maj në Nivicë shkuan edhe Ahmet Turani, Selam Musai, Ali Bënça, Dule Dalani dhe Adem Muhameti nga Sinanaj. Kurse më datën 27 maj u bashkuan me ta Gani Alikua e Kanan Mazia nga Shkoza dhe Azbi Canua nga Mavrova. Këta të tre të fundit, si dhe Halim Xhelua, qenë dërguar në Kurvelesh si përfaqësues të Vlorës.

Pasi qëndruan dy ditë në Nivicë, të gjithë këta dhe përfaqësuesit e fshatrave të Kurveleshit, më datën 27 maj, bënë një mbledhje në Gusmar, në oborrin e shtëpisë së Tahir Belulit. Në këtë mbledhje, me sa mbahet mend, muarën pjesë: Halim Xhelua, Ahmet Turani, Azbi Canua, Kanan Mazia, Gani Alikua, Selam Musai, Ali Bënça, Dule Dalani, Riza Runa, Adem Muhameti, Rakip Duka, Kanan Malua, Xhafer Metaj, Sulo Beqiri, Musto Buxua e shumë të tjerë.

Në mbledhje folën shumë veta dhe që të gjithë theksonin nevojën e ngritjes në luftë kundër push-tuesve italianë. Në fund të fjalimeve e të bisedave pjesëmarrësit ranë dakord dhe lidhën besën për të rrëmbyer armët. Aty për aty u bënë listat e çetave të fshatrave të Kurveleshit dhe iu dorëzuan Ahmet Turanit, i cili qe zgjedhur kryetar i komitetit të Tepelenës.

Njëkohësisht, aty në mbledhje, me përfaqësuesit e fshatrave u vendos që Kurveleshi të kontribuonte edhe për ushqimin e luftëtarëve të çetave të tij dhe të Tepelenës. Të gjithë ranë dakord që çdo familje të dorëzonte në dispozicion të shokëve që u ngarkuan në çdo fshat për t'u marrë me këtë punë, tre për qind të bagëtive të imta që kishte dhe një sasi djathi, kurse bukë do të jepnin sipas mundësisë.

Por kur të huajt shkuan në shtëpirë e Rakip Du-

kës për të ngrënë drekën, midis atyre që mbetën aty e po bisedonin ende, ndodhi diçka jo e zakonshme. Një nga përfaqësuesit e një fshati, ngrihet papritur e u drejtoshet të tjerëve: «Nuk ë bëmë mirë punën. Vlonjatët do të thonë: «Kurveleshasit erdhën me qëllim që të digjemi edhe ne nga Italia, ashtu si u dogjën ata nga greku». Prandaj ne s'duhet të vemi në Vlorë».

Atë e kundërshtuan të gjithë, e disa edhe rreptë, duke e kërcënuar se pengonte luftën e popullit dhe se për këtë mund ta vrishnin si qen. Po ai, i bindur në mendimet e tij, u ngrit e shkoi në shtëpinë ku ndodheshin organizatorët e mbledhjes. Ato fjalë ai ua përsëriti edhe atyre dhe, duke iu drejtuar Ahmet Turanit, i kërkoi që ta kthente prapë listën e çetës së fshatit.

Ahmet Turani e Selam Musai u inatosën shumë nga fjalët e tij dhe iu përgjigjën ashpër. E mori fjalën një nga shokët e Vlorës, e pikërisht Gani Ali-kua. Ai, duke u drejtuar nga të gjithë, me zë të qetë, tha: «Dëgjoni, o kurveleshas! Ne këtu kemi ardhur si përfaqësues të Vlorës e të dërguar nga Vlora. Qëllimi i ardhjes sonë në këtë kohë të vështirë është që t'ju kërkojmë ndihmë për të shpëtuar nderin tonë dhe për të ndjekur italianët nga vatani ynë».

Pas Gani Alikos, sabotuesit iu hodh Selam Musai: «Ti rri këtu e ruaj dhentë. Të kam dëgjuar përburrë të mirë — i tha ai i nxehur, — po paskam qenë i gënjer. Ti paske frikë nga lufta».

Folën edhe të tjerë dhe, të indinjuar e të inatosur, i thanë se ai s'përfaqësonte fshatin e tij, sepse ata donin të luftonin kundër të huajit. Më në fund e mori prapë fjalën Ahmet Turani, i cili i tha: «Unë listat e çetës së fshatit tënd nuk t'i jap, sepse ata na

kanë dhënë fjalën si burra që të venë në luftë. Dhe ata bashkë me të tjerët do të venë në Vlorë, po dy-fekun tënd ne nuk e duam. Lipsur qoftë!».

Më 29 maj në Barçalla u mblohd kuvendi i përfaqësuesve të fshatrave të krahinës së Vlorës, në të cilin muarën pjesë dyqind vetë. Këtu u zgjodh një këshill prej tridhjetë vetash dhe nga ky këshill doli Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» i përbërë nga dy-mbëdhjetë veta, i cili do të drejtonte kryengritjen kundër pushtuesve italianë. Nganjëherë në kujtimet e veteranëve të asaj lufte ose në këngët popullore komiteti quhet komision, dhe bile edhe çdo anëtar komiteti quhet komision. Nga kjo rrjedh që shpesh në lexime të ndryshme ose këngë, ndeshemi në fjalët: «dymbëdhjetë komisione», «pesë a gjashtë komisione», e të tjera.

Pranë Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» u zgjodh edhe një komision ushtarak, i përbërë prej oficerësh, i cili do të kryente funksionet e shtabit për planizimin dhe drejtimin praktik të veprimeve luftarake të çetave.

Më 30 maj Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» i Vlorës i dërgoi një letër komitetit të Tepelenës, në të cilën, pasi e vinte në dijeni mbi mbledhjen e Barçallasë dhe qëllimine saj, e njoftonte se më dy qershori në malin e Beunit, te Rapi i Gurrave, do të bëhej mbledhja e forcave kryengritëse që do të merrnin pjesë në luftën kundër ushtrisë italiane në krajinë e Vlorës. Me anën e kësaj letre ftoheshin që të vinin atje edhe forcat e Tepelenës dhe të Kurveleshit që qenë caktuar për drejtimin e Vlorës.

Selam Musai në këtë kohë ndodhej ende në Nivicë. Ai kish me vëte edhe shtatë luftëtarë të çetës së Salarisë. Ata qenë që të gjithë djem të pashëm,

me trup të hedhur e mbi të gjitha trima. Një plakë nivicjote i mban mend mirë edhe sot Selamin dhe shokët e tij. Ajo tregon një çast nga koha e ndënjosies së tyre në Nivicë. Salarjotë që shoqëronin Selamin qenë ulur shtruar mbi disa gurë, kishin nxjerrë nga trastat e xhepat ata pak fishekë që kishin me vete dhe me lima po çanin majat e plumbave, me qëllim që kur të godisnin në trupin e armikut ata të bënim më tepër efekt. Një plakë shumë e moshuar, kur i pa ata, i pyeti pse i çanin plumbat. Memë Sherifi iu përgjigj: «Duam që me një plumb të vrasim katër armiq!» Atëherë plaka i shkoi afër Selamit, e kapi përdore dhe i tha:

— Ezhdërha i paske këta djem, morë Selam! Me një plumb katër italianë duan të vrasin!

— Ç'të bëjmë? Nga nevoja, s'kemi fishekë — iu përgjegj ai.

— Ta mbytni Italinë në det e të na ktheheni shëndoshë — e uroi plaka.

— O italianët në det, o ne në varr! — i tha Selami.

Selam Musai, me anën e njërit nga luftëtarët që kish me vete, lajmëroi çetën e Lopësit dhe çetën e Salarisë, e cila, siç u tha më lart, kish në përbërje të saj edhe çetat e Dukajt e të Turanit, që të niseshin menjëherë për në Beun, duke kaluar nga Qafa e Kreshës, Nivicë, Vermik, Beun. Rruga Lopës-Sevaster-Beun nuk mund të përdorej, sepse në Matohasanaj qe një garnizon i ushtrisë italiane.

Selami me shokët që kish me vete, pa u kthyer më në Salari, u nis për në Beun, bashkë me çetat e Kurveleshit të Sipërm. Atë ditë në Nivicë u mblodh i gjithë populli dhe u mbajtën fjalime. Një flamur i madh kombëtar që shpalosur dhe mbahej nga një luf-

tëtar. Aty foli edhe Selami. Nivicjotët e moshuar i mbajnë mend edhe sot fjalët që ai u tha në fund: «Kini besim te ne, se pa e hedhur në det breshkamadhin nuk kthehemë të gjallë!».

Fëmijët e shkollës brohorisnin të gëzuar nga ai qast solemn, pleq e plaka të përlotura, nga gëzimi e emocionet, po përqafoheshin me ata që shkonin pér në luftë...»

Selam Musai u nis pér në Luftën e Vlorës.

Ai kish hipur në kalin e tij, dhe po ecte në krye të shokëve. Kalin e Selamit e njihnin të gjithë. Kish një ngjyrë të kuqe flakë, vetëm lelet dhe bishtin i kish të zes. Trupin e kish të lartë e të hollë. Qe shumë i zgjuar. Veç Selamit nuk pranonte t'ia hipte njeri tjetër. Emrin e kish «Binok», të cilin ia kish vënë vetë Selami që kur qe lindur në kopenë e pelave të tij. Selami me «Binokun» pér herë të parë kish lufuar më 1914 kundër shovenistëve grekë, kështu që kali qe mësuar në luftime.

Në shtëpi Selami kish shumë armë të llojeve e tipave të ndryshëm. Fshatarët e tij, dhe veçanërisht Këze Selamia, mbajnë mend që ai kish: një malipher grek, të cilin e kish blerë në Janinë, një manxer turk të ri, një pushkë italiane të shkurtër një revolver nëntshe me mulli, revolver turk me dhjetë, dhe dy kama.

Veshja e jashtme që mbante ai tregohet me sak-tësi nga të moshuarit salarjotë. Gjatë verës Selami mbante rroba të bardha, të bëra prej shajaku të hollë, të punuar nga vëllakat dhe të qepura në Gjirokastër. Gjithashtu mbante xhamadan e peshlli të qindisur dhe këmishë me mëngë të ngushta. Këpucët i mbante shyta dhe me gozhdë poshtë. Në kokë mbante gjithmonë qylaf të bardhë, kurse pér mesi pësh-

tillte brez të bardhë të bërë nga e shoqja. Pantalonat i mbante vëraka. Gjatë dimrit mbante po këtë veshje po palltua e pantallonat të bëra prej shajaku të zi. Veç këtyre, në shtëpi mbante edhe një kostum të qepur prej cope ngjyrë blu të errët, të cilin e visinte në dasma e gostira, ose kur shkonte te miqtë e tij. Sharkun e përdorte rrallë. Ai zakonisht mbante gunë të bërë me lesh dhie.

Kur u nis për në Luftën e Vlorës Selami kish me vete malipherin, dy gjerdanë me fishekë, revolverin nëntëshe dhe një kamë me dorezë argjendi. Qe veshur krejt me rroba të bardha, krahëve kish hedhur gunën e tij bojë hiri me qafë të cohtë blu. Kali i tij kish shalë meshini ngjyrë kafe. Në shalë kish mbërthyer një palë hejbe, po prej meshini ngjyrë kafe, në të cilat mbante fishekët rezervë për pushkën e revolverin, veglat e rrojes, peshqir e sapun, ndërrresat, dylbitë si dhe një pagur bakri treokar, të cilin e mbushte me raki, dhallë ose ujë, sipas rastit. Atë pagur, i cili ruhet deri në ditët tona, Selami e kishte blerë në Stamboll. Ai ka një ndërtim interesant: zërthehet e ndahet në dy pjesë, lahet ose kallaiset dhe mbërthehet prapë.

3. Ushtria italiane në krahinën e Vlorës dhe në atë të Tepelenës

Në Shqipëri vepronte Korparmata XI e ushtrisë italiane. Në përbërje të saj hynin Divizioni i 13-të, nën komandën e gjeneralit Raimondo, dhe Divizioni i 36-të, nën komandën e gjeneralit Pulieze, si dhe një brigadë speciale, një njësi artillerie, reparte të ndërlidhjes, xhenjos, tankeve e autoblindave, prapavijës, karabinierisë dhe vullnetarë arditë. Gjithsej

me një efektiv të përgjithshëm prej rrëth njëzetmijë veta.

Komanda dhe shtabi i Divisionit të 13-të me një pjesë të forcave qe dislokuar në Durrës, kurse e gjithë ushtria tjetër që në zonën Vlorë-Tepelenë-Sarandë.

Në gjirin e Vlorës flota luftarake detare italiane mbante në gatishmëri një skuadër detare të përbërë nga anije luftarake të pajisura me artileri të fuqishme, si «Forina», «Brondeti», «San-Marko», «Kuadro», «Kalvi», «Beraniçë», «Orione», «Alçione», Bornida», «Maria-Madre» e të tjera. Gjithashtu në gjirin e Vlorës dhe në aerodromin afër qytetit italianët kishin bazuar një sasi hidroplanësh e aeroplanësh.

Forcat ushtarake italiane komandohezin nga shumë gjeneralë. Si komandant i përgjithshëm qe gjeneralnënkolonel Setimio Piacentini, një nga gjeneralët më në zë të ushtrisë italiane. Në Shqipëri, për herë të parë, ai kish ardhur në shkurt 1916, po pas ca kohe u largua prapë. Për herë të dytë vjen në shtator 1918 me detyrën e Komandantit suprem të forcave italiane në Ballkan.

Forcat ushtarake italiane kishin kapur pozita të forta e të rëndësishme nga pikëpamja e mbrojtjes, veçanërisht gjatë rrugëve automobilistike që lidhin Vlorën me Tepelenën dhe Vlorën me Himarën.

Të gjitha garnizonet, si ato të mëdhatë ashtu edhe ato të voglat, qenë pajisur me materiale luftarake e municione në sasi të mjaftueshme për të kryer veprime luftarake për një kohë të gjatë, duke qenë edhe të rrëthuar e pa marrë ndihma të tjera. Gjithashtu qenë furnizuar me ushqim e veshëmbathje të bollshme.

Mbrojtja rrethore e garnizoneve qe organizuar

në mënyrë të përsosur. Në shumë prej tyre qenë shfrytëzuar fortifikatat prej betonarmeje, të ndërtuara që gjatë Luftës së Parë Botërore nga ushtria italiane për t'u mbrojtur nga sulmi i ushtrisë austro-hungareze. Por qenë bërë edhe shumë punime të reja fortifikuese. Qenë hapur llogore të thella rrëth objekteve, qenë ndërtuar qendra zjarri për mitralozat dhe pozicione për topat si dhe pengesa me tela, të cilat përbëheshin prej disa radhësh, ishin dy metra të larta e tre deri katër metra të gjera.

4. Beuni

Më dy qershor forcat pjesëmarrëse në kryengritjen e armatosur kundër pushtuesve italianë, të përbëra nga katërmijë luftëtarë, me parullën luftarake «O Vlorë, o vdekje!» u mblohdhën në malin e Beunit.

Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» më tre qershor i dërgoi komandantit të trupave italiane, gjeneral-nënkolonel Piaçentinit, një ultimatum, në të cilin theksohej politika armiqësore e qeverisë italiane ndaj Shqipërisë që nga tetori i vitit 1914, kur ajo zbarkoi trupat e saj në vendin tonë. Ultimatumi përfundonte: «Sot populli shqiptar, i bashkuar më shumë se çdo herë, duke mos mundur të durojë të shitet si bagëti nëpër pazaret e Evropës, si shpërblim italo-greko-serbëve, vendosi të marrë armët në dorë dhe të kërkojë nga Italia administratën e Vlorës, Tepele-nës dhe Himarës, të cilat t'i dorëzohen me të shpejtë qeverisë kombëtare të Tiranës.

Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» i Vlorës, i shtërpënguar nga populli i Vlorës dhe i gjithë Shqipërisë, i mbledhur këtu, dëshiron që zotëria juaj t'i

përgjigjeni kërkesës sonë gjer nesër, katër qershor ora 19. Ndryshe, për çdo gjë që mund të ngjasë, Komiteti «Mbrojtja «Kombëtare» nuk ka asnje përgjegjësi».

Për t'i dorëzuar ultimatumin gjeneralit italian, u zgjodh fshatari patriot Mehmet Selimi nga Mallkeqi. Ai qe një burrë i thjeshtë, me trup mesatar pak të shëndoshë, fytyrë serjoze, pothuajse gjithmonë të vrenjtur, dhe me mustaqe të prera shkurt. Kish veshur rroba të zeza shajaku dhe në këmbë kish mbathur një palë sholle llastiku. Mehmeti ia dorëzoi ultimatumin gjeneralit dhe po priste përgjigje. Piacentini e priti ftohtë dhe, pasi e levoi përbajtjen e ultimatumit, iu përgjigj i vrenjtur dhe nervoz: «U thoni brigandëve shqiptarë se përgjigjen do t'juja japid topat që kam në Kotë, Gjormë, Llogora e Drashovicë...».

Ky detaj nga Lufta e Vlorës është përjetësuar në këngën e mëposhtme, në të cilën thuhet që kryetari i Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» kërkon një trim për t'i çuar ultimatumin Piaçentinit:

*O djem, kush do të vejë në Vlorë,
Piaçenitit të m'i thotë
Plaçkatë shpejt t'i ngarkojë?..
Mehmet Selimi Dragoi
I pari aty qëlloi,
Mori kartën edhe shkoi...*

Duke pritur përgjigjen e komandës italiane, Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» dhe komisioni ushtarak bënë planin konkret të veprimeve luftarake dhe morën masa të rëndësishme organizative.

Plani i Luftës së Vlorës, në variantin e parë, parashikonte dy fazë, qdonjëra e të cilët kish qëllim dhe detyra të qarta e të përcaktuara mirë. Ky plan, nga ana e ndërtimit të tij, është interesant. Faza e parë e planit parashikonte luftimet për eliminimin e të gjitha garnizonëve të ushtrisë italiane jashtë qytetit të Vlorës. Përbajtja kryesore e veprimeve të fazës së parë ishte kjo:

1. Sulmi të bëhej në mënyrë të rrufeshme dhe në një kohë kundër të gjitha garnizoneve, presideve, e postkomandave të ushtrisë italiane që qenë jashtë qytetit të Vlorës.

Kjo kish për qëllim: të çlironte një pjesë të territorit të pushtuar; të siguronte hapjen e rruget për në Vlorë; me materialet luftarakë që do t'i kapeshin armikut të kompletoheshin një pjesë e luftëtarëve shqiptarë, të cilët qenë të paarmatosur; t'i hiqte mundësinë komandës italiane që të manovronte forcat rezervë të saj dhe të garnizoneve të ndryshme për t'u ardhur në ndihmë atyre garnizoneve që rrezi-koheshin më shumë.

2. Të bllokoheshin të gjitha rruget e mundshme për tërheqje të trupave italiane që do të sulmohen. Të kapeshin sa më shumë robër, me qëllim që pastaj, Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» të mund të bënnte presion mbi komandën italiane që të ndalonte masakrat kundër popullsisë civile të qytetit të Vlorës.

3. Me asgjësimin e forcave italiane jashtë Vlorës, për sulmin vendimtar mbi garnizonin e fuqishëm të qytetit, do të kishte mundësi që të përqëndrohen të gjitha forcat kryengritëse.

Pas plotësimit të fazës së parë të planit, do të fillonte zbatimi i fazës së dytë, e cila qe edhe vendimtare: sulmi mbi Vlorë, çlirim i qytetit të flamur-

rit dhe hedhja në det e ushtrisë pushtuese italiane.

Në Beun, komisioni ushtarak, gjatë kohës që pritej përgjigjja e gjeneral Piacentinit, bëri organizimin e forcave kryengritëse si më poshtë:

Çdo fshat formoi çetën e tij. Ndonjë fshat që kish më pak se 20 luftëtarë, nuk krijonte çetë më vete po luftëtarët e tij shkriheshin në çetën e fshatit më të afërt. Nga radhët e tyre çetat zgjodhën komandantët, të cilët qenë luftëtarë trima dhe me përvojë luftarake e aftësi organizimi e drejtimi të luftimeve.

Për lehtësi drejtimi, çdo tre-pesë çeta, e nganjëherë edhe më shumë, të fshatrave formuan një batalion ose tabor, si i thoshnin atëherë batalionit, duke përdorur fjalën turqishte. Në kujtimet e disa veteranëve të Luftës së Vlorës, shpeshherë fjalë çetë përdoret jo vetëm për çetat përkatëse të fshatrave po edhe për çetat e bashkuara të disa fshatrave, të cilat, po të gjykojnë nga numri i luftëtarëve të inkadruar në to, përbëjnë batalione. Kështu, për shembull, në kujtimet e Riza Runës, kur flitet për sulmin mbi Vlorë, më 11 qershor, thuhet se forcat kryengritëse përbëheshin nga shtatë çeta. Këtu duket që ai ka parasysh batalionet dhe drejtimet e sulmeve, sepse në të vërtetë në atë luftim morën pjesë dhjetëra çeta. Gjithashtu, kur flitet për forcat e një krahine të tërë, këto quhen si një çetë, si për shembull «Çeta e Kurveleshit», «Çeta e Kudhësit», «Çeta e Rrzës» e të tjera, mirëpo dihet që Kurveleshi, Kudhësi, Rrëza e të tjera krahina kishin disa çeta e jo një çetë. Pra është fjalë për disa çeta e jo një.

Meqenëse në historiografinë tonë dhe në kujtimet e ndryshme të veteranëve fjalë çetë është përdorur gjerësisht për të emërtuar edhe batalionet, ajo me atë kuptim u përdor edhe në këtë shkrim, sepse

në Luftën e Vlorës populli nuk e ka përdorur fjalën batalion për të emërtuar forcat e tij, por, për t'i dalluar nga çetat e fshatrave, çetat e bashkuara i ka quajtur çeta krahine. Pra edhe ne këto fjalë do të përdorim këtu.

Në krye të çetave të krahinave, komisioni ushtarak caktoi komandantë, të cilët zgjidheshin nga radhët e komandantëve më trima e më të aftë të çetave, që gjëzonin respektin dhe besimin e gjithë luftëtarëve, dhe që gjatë luftërave të mëparshme kishin dhënë prova të mjaftueshme në zotësinë për të udhëhequr të tjerët dhe në njojjen e takikës së luftimit.

Selam Musai mbriti në Beun dhe mori kontakt me Komitetin «Mbrojtja Kombëtare» dhe komisionin ushtarak. Pas tij në Beun erdhën edhe luftëtarët e Lopësit dhe ata të Salarisë. Duhet theksuar se, për të marrë pjesë në fazën e parë të Luftës së Vlorës, deri më pesë qershori nuk mundën të vinin të gjithë luftëtarët e çetave të krahinës së Tepelenës, sepse, më pas, nga komiteti i Tepelenës u pë e nivojshme që një pjesë e tyre të qëndronin për të marrë pjesë në asgjësimin e garnizoneve italiane në Tepelenë e Matohasanaj. Kështu, çeta e Salarisë, që duhej të kishte njëqind e pesëdhjetë luftëtarë, kur shkoi në Beun kish më pak. Këtë e thonë luftëtarët pjesë-marrës, si dhe e lexojmë në një artikull të Halim Xhelos, njërit nga udhëheqësit e Luftës së Vlorës, botuar në gazeten «Politika» datë 3 shtator 1924 me titullin «Vlora më 1920». Ai, midis të tjerave, shkruan:

«Nga Beuni iu dërgua një ultimatum komandës në Vlorë... Në këto të tri ditë e sipër erdhi edhe heroji i Salarisë, Selam Musai, me njëqind e ca sala-

riias, trima me fletë, të cilët malet e Salarisë i kanë vadir me gjak më 1914-16 kundër grekut, si dhe fatosat kurveleshas».

Komisioni ushtarak e aprovoi strukturën organizative të çetave të Tepelenës, duke i pasur forcat e pesë fshatrave të Lopësit në një çetë, e cila u quajt Çeta e krahinës së Lopësit, dhe forcat e Salarisë, Dukajt e Turanit në një çetë, e cila u quajt Çeta e Salarisë, meqenëse luftëtarët e atij fshati përbënин shumicën. Komendant i çetës së Lopësit u aprovua Dule Dalani, kurse komendant i Çetës së Salarisë u aprovua Islam Malua.

Selam Musai u prit mirë nga anëtarët e Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» dhe komisioni ushtarak. Ata kishin dëgjuar që Selami ishte luftëtar i vjetër, trim, njeri me autoritet, që gjonte besimin e masës së gjerë të luftëtarëve, dhe që në rrezik hidhej vetë i pari në flakë. Shumë nga anëtarët e komitetit dhe anëtarët e komisionit e njihnin atë personalisht. Njëri nga drejtuesit e komisionit ushtarak e njihte mirë dhe e kishte mik personal Selamin, që kur ai kish qenë në Tepelenë më 1919 dhe qenë takuar për problemet e ngritjes në luftë kundër pushtuesve italiannë.

Selamin e caktuan komendant të të dy çetave, ose taboreve, të Tepelenës. Pastaj me të biseduan shtruar dhe i ngarkuan detyrën. Muza popullore e ka përjetësuar bukur në një këngë thirrjen e Selamit në Beun dhe caktimin e detyrës. Në të, midis të tjerave, thuhet:

*Në Beun, kur u mbëlodhë,
Dymbëdhjetë komisionë,*

Selam Musanë e kërkojnë:

*— Ti Selam do veç në Vlorë,
Komandant mbi dy taborë.*

*— Do vete, në paça forrë,
Do ta bëj si në Labovë,
Q'i zura grekrit me dorë...*

Komisioni ushtarak e ngarkoi Selam Musain që të merrte pjesë me forcat e tij në asgjësimin e garnizonit italian të Kotës.

Luftëtarët përgjithësisht qenë armatosur shumë keq. Nuk kishin të gjithë pushkë dhe kishin ardhur në luftë për t'ia marrë ato armikut e pastaj të luftotin kundër tij. Midis çetave mund të shihje të armatosur vetëm me jataganë, hanxharë, thika, sopata, ose ndonjë copë hekur të gjatë e me majë të mprehtë. Edhe pushkët që kishin, qenë nga tipat e llojet më të ndryshme, duke filluar nga ato më të vjetrat, që mbusheshin me nga një fishek, e deri te manxeri turk, malheri grek ose pushka italiane, të cilat në atë kohë konsideroheshin nga më të mirat.

Për municion, gjithashtu, qe shumë keq. Sipas kujtimeve të veteranit të Luftës së Vlorës Kanan Malos, nga ata që kishin pushkë, rrallë ndonjëri mund të kish katër-pesë krehër fishekë. Këtë e thonë edhe luftëtarë të tjera pjesëmarrës të çetave. Edhe sot mbahet mend nga shumë veta që Memë Sherifi, një nga trimat më të dëgjuar të Selarisë, zëvendëskomandant i çetës së fshatit të tij, u nis për në Luftën e Vlorës duke i marrë hua një shoku të tij një mamer turk me vetëm tetë fishekë.

Një tjetër pjesëmarrës i Luftës së Vlorës në kujtimet e tij shkruan: «Kur filloi lufta nuk kishin që të gjithë pushkë; për çdo dy vetë ishte ndarë një

pushkë dhe një sopatë. Po të vritej ai që kishte pushkën, atëhere ai që kish sopatën ia merrte pushkën dhe hidhej në luftë».

Poeti pajisjen materiale të të dy forcave kundër-shtare e ka nxjerrë në pah në vjershën e mëposhtme:

*Andeja bomba e ballona,
Mitraloza e vamporë,
Këtej një flamur valon,
Udhëtonte për në Vlorë.
Andej dinamit e topa,
Njëmijë gjyle në një orë,
Këtej palla copa-copa
Dhe një gobure në dorë.
Ai rrerherrotull hekur
Ha e pi e vish e ngjesh,
Këtej edhe kur po vdesin
Fshijnë gjakun me këmishë.*

5. Kota

Kota, e cila në epopenë e Luftës së Vlorës, për ashpërsinë e luftimeve dhe heroizmin e fshatarëve shqiptarë, u bë e famshme dhe u dëgjua jo vetëm në të gjitha viset e atdheut po edhe jashtë kufinjve të tij, atëhere ka qenë një vend i shtrirë në jugë të Mavrovës dhe quhej Fusha e Ahmete. Në krye të asaj fushe kishte pak shtëpi. Nga të tri anët ngrihen një varg kodrash, midis të cilave edhe ajo me lartësi absolute mbi nivel të detit 115 metra, e cila është më afër. Nga perëndimi fusha pritet nga lumi Shushicë. Pushtuesit italianë, duke u bazuar në lartësinë 115, e quajtën të gjithë atë vend Kuota, e ky emër mori trajtë shqiptare dhe u quajt Kotë.

Për pozicionin e rëndësishëm që kish nga ana ushtarake, Kota përbënte garnizonin më të fuqishëm të ushtrisë italiane, pas atij të Vlorës. Në kodrat përreth qenë ndërtuar fortifikata betonarmeje, në të cilat qenë vendosur topa të të gjithë kalibrave dhe mitralozë të rëndë. Gazermat si dhe fortifikatat, qenë rrrethuar me tela me gjemba dhe pengesa të tjera. Të gjitha punimet fortifikuese për mbrojtjen e Kotës qenë bërë sipas shkencës ushtarake të fortifikimit.

Në një këngë popullore për' Kotën e asaj kohe, midis të tjerave, thuhet:

*O bobo se c'qenka Kota,
Më e bukur nga Evropa,
Mbushur mitralozë e topa...
Kush u hodh në Kotë i pari?
Selam Musa kordhëtari.*

Mbrojtjen e Kotës e kish organizuar dhe e udhëhiqte personalisht gjenerali Enriko Goti, i cili qe dërguar në Kotë me detyrën e komandantit të zonës dhe prej tij varej jo vetëm koloneli Mikel Kavallo, që qe komandanti i garnizonit të Kotës, po edhe komendantët e garnizoneve të presideve të tjera të afërta.

Në shumë materiale dokumentare e kujtime, Enriko Goti herë përmendet si gjeneral e herë gabimisht përmendet si kolonel. E vërteta është se ai kish qenë kolonel dhe kohët e fundit qe graduar gjeneral. Goti kish mbaruar shkollën ushtarake në Modena e njihej si ushtarak i shquar i ushtrisë italiane, veçanërisht u dallua në Luftën e Parë Botërore. Në librin e Amedeo Tostit: «Shembulli i kre-

rëve», në pjesën: «Gjeneralët italianë të rënë në luftën e madhe», për Enriko Gotin flitet në mënyrë të veçantë në një kapitull me titull: «Gjenerali i fundit i rënë».

Gjeneral Goti qe vendosur në kuotën 124, atje ku qe vendosur edhe shtabi i Regjimentit 72. Koloneli Kavalo qe ngarkuar të drejtonte personalisht veprimet e artilerisë, të cilën italianët e quanin si mjetin e sigurt vdekjeprurës për të gjithë kryengritësit shqiptarë që do të sulmonin Kotën.

Sipas planit të komisionit ushtarak, në luftimet për çlirimin e Kotës muarën pjesë çetat e krahinave të Shullërit, Kudhësit, pjesërisht e Rrëzës, sepse një pjesë e forcave të saj u caktuan për asgjësimin e garnizoneve të Gjormit dhe të Drashovicës, dhe çetat e Kurveleshit e të Tepelenës. Forcat e Vlorës komandoheshin nga Ahmet Lepenica, forcat e Kurveleshit nga Riza Runa, kurse ato të Tepelenës nga Selam Musai.

Forcat e fshatrave të Vlorës do ta sulmonin Kotën nga drejtimi i jugut, ato të Kurveleshit nga veriu dhe ato të Tepelenës nga lindja.

Selam Musait iu caktua drejtimi më i vështirë. Përballë tij ai kish grupin e artilerisë, disa reparte këmbësorie të vendosura në llogore, fortifikata të ndërtuara rrëth kodrës ku qe vendosur artilleria dhe shtabi i kolonel Kavalos si dhe pengesa të tjera.

Sipas planit të komisionit ushtarak, sulmi kundër të gjithë garnizonëve, presideve dhe posteve të karabinierisë italiane, do të fillonte fiks në orën 22 e 30 minuta të datës pesë qershori.

Atë ditë, herët në mëngjes, Selam Musai, me Dule Dalanin dhe me disa luftëtarë të tjerë, dualën në një kodër midis Vajzës dhe Kotës, nga dukej mirë

vendi ku do të zhvilloheshin veprimet luftarake, si dhe pjesërisht pozicionet e topave e llogoret e italiannëve. Selami me shokët përcaktuan rrugët e lëvizjes së çetave për të mos u diktuar para kohe. Në mënyrë të veçantë ai u foli për veprimet luftarake, taktikën që duhej përdorur si dhe për mënyrën e kalimit të pengesave me tela. Sipas dëshmive të pjesëmarrësve, Selami u spjegoi më hollësi si të përdoreshin gunat, sherqet, trarët, dërrasat e mjete të tjera, të cilat do të hidheshin mbi tela për të kaluar pastaj mbi to.

Sipas udhëzimeve të komisionit ushtarak, Selami, me kalimin e afatit të përgjigjes së ultimatumit, caktoi disa luftëtarë, të cilët prenë linjën telefonike që lidhte Kotën me Vajzën, Sevesterin e Tepelenën.

Para fillimit të veprimeve luftarake të gjitha çetave që do të merrnin pjesë në luftimet për çlirimin e Kotës iu dha parulla dhe kundër parulla: «Pushka-Plumbi».

Në errësirën e mbrëmjes forcat e Selamit u afruan para llogoreve të armikut, zunë vende dhe në heshtjen më të madhe po prisin sinjalin për t'u hedhur në sulm. Bashkëluftëtarët e tij tregojnë që Selam Musai i jepte shumë rëndësi befasisë. Ai shpesh u thoshte shokëve: «Kur i hidhe sipër armikut hapasez,¹⁾ ai ngrin në vend e as dorën s'hedh dot në revole. Po, po të pa para kohe, ai të vret më kollaj se sa ti atë». Selami i porositi qartë shokët e tij dhe nuk lejonte të bëhej zhurmë e të hapej zjarr para kohe. «Edhe në qoftë se do piqi më ndonjë italian, pa u ndezur lufta — u tha ai, — duhet

1) Nga turqishtja: befas.

ta zini me dorë dhe po kundërshtoi e briti, atëhere mbarojeni me thika a bixhaqe». Në një rast, një luf-tëtar i mbështetur pas një drize, në pritje të sinjalit për sulm, po shkreppte me uror për të ndezur çibukun. Shkëndijat e strallit dukeшин deri atje ku që Selami. Ai u inatos dhe i tha Memë Shefirit: — Shko e foli atij zagari!

Luftëtarët ishin gati. Ata qenë shtrirë barkas njëqind metra e në disa vende njëqind e pesëdhjetë metra larg telave me gjemba që rrëthonin kodrat.

Komandanti i zonës, gjeneral Goti, megjithë massat që kish marrë, prapëseprapë, kur u bind se kry-engritësit shqiptarë do të hidheshin në sulm dhe qenë të vendosur që ta çlironin vendin e tyre ose të vdisnin me anë të telefonit kërkoi përforcime të tjera në njerëz e teknikë nga komandanti i përgjithshëm gjeneral Piaçentini. Këtë bisedim të të dy gjeneralëve italianë populli e ka përjetësuar në këngën e mëposhtme:

*Telat po venë e vinë,
Punon Kota me Kaninë,
Kërkon Goti Piaçetinë:
— Shpejt na dërgoni ushtrinë,
Se shqiptarët arrinë...*

Në kohën e caktuar Selam Musai u çua në këmbë dhe thirri me zërin e tij kumbues, i cili në atë qetësi nate u dëgjuar deri larg: «Përpara, o djem!».

Pas kësaj thirrjeje, të gjithë luftëtarët u çuan dhe me britma luftarake u vërsulën në drejtimet që u qenë caktuar ose që i kishin zgjedhur vetë qysh

më parë. Italianët, të cilët qenë vendosur nëpër llogore, u përgjigjën me zjarr të dendur të mitralozëve, pushkëve e topave. Predhat e artilerisë pëlcisnin midis radhëve të luftëtarëve.

Selam Musai po sulmonte duke qenë në ballë të shokëve. Lufta u pleks e rreptë. Tymi e flaka i pështollën patriotët shqiptarë, kurse plumbat po derdheshin si breshëri. Megjithatë, ata po ecnin përpara: «O djem, kapini me dorë breshkamëdhenjtë!» thirri Selami, dhe, bashkë me luftëtarët, u hodhën mbi tela.

Ata i kishin parë pengesat e telave që kur qenë shtrirë para tyre, po nuk e kishin menduar se do të qe kaq vëshitirë pér t'i kapërcyer. Selami hoqi gunën nga supet dhe e hodhi mbi radhën e parë të telave, pastaj u ngjit sipër e me kujdes, që të mos binte midis radhëve, prej nga nuk do të delte dot kollaj, u hodh matanë. Pas tij kaluan Dule Dalani, Memë Sherifi dhe pastaj edhe luftëtarët e tjerë, të cilët, duke përdorur trarë, sopata e mjete të tjera, hapën disa shtigje.

Zjarri i armikut u bë edhe më i tmerrshëm. Topat hapnin zjarr me qitje drejtpërdrejt mbi luftëtarët, duke qëlluar nga njëqind-dyqind metra larg. Po kështu qëllonin papushim edhe pushkët e mitralozët. Luftëtarët e çetave u hodhën mbi llogore.

Selam Musai u drejtua nga një top që qe në një pozicion pas llogores së ushtarëve italianë, i cili vazhdimisht qëllonte. Sipas kujtimeve të Riza Runës, dhe tregimeve të luftëtarëve të tjerë, pjesëmarrës në atë luftë, Selami u fut në pozicionin e topit, dhe, duke përdorur herë pushkën e herë revolverin, asgjësoi disa prej ushtarëve, kurse të tjerët e lanë topin në

vend dhe ikën me vrap për të shpëtuar lëkurën. Mbi topin e kapur ai vendosi një flamur.

Edhe Dule Dalani në atë luftim tregoi trimëri të rrallë, dhe u bë shembull frysëzimi për gjithë luftëtarët e çetës së krahinës së Lopësit që ai komandonte. Dulja u hodh në llogoret e armikut kù ishte një mitraloz i rëndë, i cili qëllonte kundër luftëtarëve pa ndërprerje, vrau mitralierin e municationerin dhe kapi mitralozin.

Përleshje e ashpër e trup me trup vazhdoi gjithë natën. Luftëtarët e çetave po hidheshin me guxim përpara për të thyer qëndresën e reparteve pushkatare dhe të baterive të artilerisë që drejtoheshin nga kolonel Kavalua. Selam Musai, duke qenë gjithmonë në ballë të sulmit e duke hedhur herë pas here thirrje luftarake, i bënte luftëtarët të mos merrnin parasysh asgjë dhe të tregonin trimëri të rrallë duke e asgjësuar armikun që kishin para me plumb, ose duke u përleshur me trup.

Selami po drejtohej për në majë të kodrës, po majtas tij qe një mitraloz i rëndë, i cili hapte zjarr dhe pengonte seriozisht lëvizjen përpara. Ai me shokë nuk po i afroheshin dot mitralozit për ta asgjësuar ose për ta detyruar të pushonte zjarrin, po edhe përpara nuk ecnin dot. Kështu që ata mbeten ngushtë. Sipas kujtimeve të pjesëmarrësve në luftë, këtë gjendje të vështirë të Selamit dhe të luftëtarëve të tij e vuri re njëri nga komandanjtët e çetave të Nivicës, luftëtar i vjetër e me përvojë Shaqo Llapi dhe luftëtar trim e i guximshëm i çetës së tij Shaban Doraci. Që të dy këta u hodhën në sulm, i dualën pozicionit të mitralozit nga prapa dhe e kapën. Kështu Selamit iu hap rruga për sulmin vendimtar.

Luftime të ashpra e të përgjakshme u bënë edhe në anët e tjera. Luftëtarët e çetave, duke përdorur mjete e mënyra të ndryshme, i kaluan telat dhe u hodhën mbi llogoret e italianëve. Por edhe armët e fuqishme të armikut qëllonin papushim kundër luftëtarëve që sulmonin në tokën e zhveshur. Heroikisht ra në luftë komandanti i çetës së Smokthinës Zigur Lelua, ndërsa Kanan Mazia nga Shkoza, me gjithëse kish marrë plagë të rëndë, nuk pranoi të tërhiqet nga fusha e betejës pa e marrë Kotën, po, me nofull të dërmuar, vazhdonte t'u jepte kurajo shokëve për ta vazhduar sulmin më me ashpërsi. Heroikisht ranë para topave e mitralozëve të armikut edhe shumë luftëtarë të tjerë.

Afér mëngjesit, çetat e panë veten ngushtë. Luftëtarët u gjendën në pozicione shumë të papërshtatshme, të zbuluar para armikut, prandaj ata u hodhën në një sulm të furishëm për fitore a vdekje. Pozitat më të forta të italianëve qenë pozicionet e grupit të artilerisë, të cilat qenë shumë të fortifikuara dhe mbaheshin mirë.

Selam Musai me shokë shkëmbjen mendime për veprimet e ardhshme në përshtatje me situatën e krijuar dhe vendosën që sulmin e forcave të Teppelinës e të Kurveleshit ta drejtonin mbi pozicionet e artilerisë, sepse kapja e tyre nga ana e luftëtarëve do ta dobësonte shumë qëndresën e armikut dhe pastaj çetat do ta kishin më lehtë për ta asgjësuar.

Heroizmi i luftëtarëve gjatë luftimit për të zënë pozicionet e artilerisë nuk mund të përshkruhet. Ata, të vendosur për t'ia arritur qëllimit me çdo kusht, u hodhën mbi topa. Pati raste që luftëtarët u vranë jo nga plumbat ose copat e predhave e të bombave, po nga goditja drejtpërdrejt e një predhe të tërë

në trup. Rrobat e trupit ndizeshin nga flaka e grykave të zjarrit. Megjithatë, ata, pëllëmbë pas pëllëmbe, ecnin përpara, duke sulmuar e duke thyer kundërsulmet e armikut. Gjatë një kundërsulmi të fuqishëm që bënë italianët, luftëtarët e çetave s'bënë asnje hap prapa, po u shtrinë në tokë e qëllonin, me ato pushkë që kishin, për zbrapsjen e armikut. Pre-dhat dhe plumbat binin mbi ta e rreth tyre, por ata s'tundeshin nga vendi. Këto veprime muza popullore i ka përjetësuar në shumë këngë të bukura, të cilat këndohen edhe sot me krenari.

Më në fund luftëtarët e çetave u hodhën në pozicionet e topave dhe i zunë ata, disa në gjendje të mirë e disa të dëmtuar. Shumë ushtarë italianë u vrannë, të tjerët u kapën rob. Komandanti i tyre, koloneli Mikel Kavallo, bëri të gjitha përpjekjet për të thyer sulmin e shqiptarëve, po pa sukses. Gjatë një përleshjeje trup me trup, ai mori një plumb, që i shkaktoi plagë të rëndë, dhe u kap rob.

Gjeneral Goti, tërë atë natë qe në aktivitet të plotë, duke marrë masat e duhura, sipas situatës, për të mos lejuar shpërthimin e çetave shqiptare brenda sistemit të mbrojtjes. Kur ai mori vesh se pozicionet e artilerisë po rrezikoheshin të binin në duart e shqiptarëve, menjëherë u nis për atje, megjithë oficerët e shtabit, me qëllim që të ngrinte lart moralin e ushtarëve të tij, të cilët, nën goditjen e luftëtarëve shqiptarë, po i linin pozicionet një nga një. Por ndërhyrja e gjeneralit nuk pati sukses. Ai u kthyte në qendër.

Pas marrjes së kodrave, çetat rrethuan gazermat.

Gjeneral Enriko Goti, i dëshpëruar në kulm nga kjo disfatë e shpejtë, dhe e pakuptueshme për të,

që pësoi ushtria e tij, bashkë me trembëdhjetë oficerë të shtabit të forcave të Kotës qe mbyllur në një ndërtesë dhe që aty vazhdonte të jepte urdhra për vazhdimin e qëndresës. Luftëtarët e çetave e rrethuan atë plotësisht. Ata e dëgjonin mirë kur ai thërriste e cirrej me zë të lartë duke iu drejtuar vartësve të tij.

Në dritaret dhe derën e dhomës ku qe Goti vërhshëllen plumbat e patriotëve, dhe pas këtyre u dëgjuan thirrjet që i bëheshin atij për t'u dorëzuar. Por ata nuk jepnin asnje përgjigje, veç herë pas here qëllonin me pushkë e mitralozë.

Rreth njëqind metra larg ndërtësës ku qe rrethuar gjeneral Goti, qëndronte Selam Musai me disa nga shokët e tij, Kërkuan një njeri që të dinte italisht. Dhe ai u gjet, ishte një luftëtar i çetës së Ver mikut, i cili e dinte disi gjuhën italiane. Selami e mori atë me vete, iu afroan edhe më ndërtesës dhe i tha atij që t'i thërriste gjeneralit e t'i kërkonte që të dorëzohej.

Vermiqoti i thirri gjeneralit dhe i transmetoi fjalët që i tha Selami, po që nga brenda nuk u dëgjua asnje përgjigje.

— Thuaji dorëzohi, mos u prishni kot, se shpëtim s'kini — i tha edhe një herë Selami luftëtarit nga Vermiku.

Ai u thirri italianëve dhe u tha ato që e urdhëroi Selami. Por prapë nga ana e armikut asnje përgjigje.

Atëherë thirrën një nga robërit që qenë zënë aty dhe i thanë që t'i transmetonte gjeneral Gotit se çdo qëndresë e mëtejshme qe e kotë, këtej e tutje gjakderdhja s'kish asnje kuptim. Ai qe i rrethuar dhe tani kish vetëm një rrugë shpëtimi: t'u dorëzo-

hej si rob forcave kryengritëse, ndryshe ai, bashkë me shokët e tij, do të zhdukeshin pa mëshirë.

Ushtaraku italian shkoi dhe u fut në shtabin e Gotit. Në këtë kohë luftëtarët e çetave iu afroan më tepër ndërtuesës dhe e ngushtuan rrethimin.

Te porta e jashtme, rreth njëzet metra larg nga dera e dhomës së gjeneralit, u vendosën tre luftëtarë: Dushan Kaçaj, Barxhui Kaçaj, të çetës së fshatit Gérnec, dhe kushërinj të parë me njëri-tjetrin, si dhe një luftëtar i çetës së Nivicës.

Gjenerali Enriko Goti, pasi e pa të pashpresë gjendjen e tij dhe të vartësve të tij, e ktheu ushtarakun italian te shqiptarët duke i thënë atij që qe dakord të dorëzohej. Pasi e përçolli italianin, ai vëtë nxori në dritaren e dhomës një flamur të bardhë, shenjë e dorëzimit. Nuk kaluan as pesë minuta dhe gjenerali Goti doli te shkallët. Pas tij qenë oficerët e tjera.

Selam Musai, duke mbajtur pushkën në dorë, po shikonte robërit që u dukën te dera e shtëpisë. Në krye ai pa një burrë pothuajse aq të moshuar sa ai, po me trup të madh e të shëndoshë, me fytyrë zeshkane e të gjerë, në të cilën dallohenca mustaqe të prera shkurt, anëve të holla e në mes të gjera. Në gjoks kish, në disa radhë, shiritat e dekoratave. Kokën e mbante ulur e qe i vrenjitur e i mërzitur.

Luftëtarët shqiptarë u çuan më këmbë dhe kluan portën e jashtme të oborrit për të shkuar drejt tij. Në këtë çast, e krejt në mënyrë të papritur, disa nga ushtarakët italianë që qenë me gjeneralin, hapën zjarr të dendur e hodhën bomba kundër luftëtarëve shqiptarë.

Nga ky provokacion u vra Dushan Kaçua e u plagos rëndë Barxhuli. Dushani, para se sa të vdis-

te, i thirri Selam Musait dhe i tha: «O Selam! Na vranë me tē pabesë. Merrna hakën!».

Ky episod është pérjetësuar në një këngë popullore, në tē cilën midis tē tjerave janë edhe këto vargje:

*Të dielën në sabā,
U vra Dushan Kaçua,
Briti: «O Selam Musa,
Merrëm hakën, o vëlla! ..»*

Luftëtari i çetës së Nivicës, i cili qe afër Dushanit, kur paqë italianët hapën zjarr dhe i vranë shokun, me shpejtësi, ashtu siç qe më këmbë, i ktheu pushkën gjeneralit, shenjoi mbi tē dhe qëlloi mirë. Plumbi e mori në zemër. Ai ra e vdiq në vend.

Selami, i inatosur nga ky veprim i pabesë, u thirri shokëve tē tij: «Biruni e mos lini asnje tē gjallë nga kjo farë e keqe!» U ndez lufta. Edhe disa nga oficerët e tjerë që qenë me Gotin u vranë. Sipas tregimit tē njërit nga luftëtarët e çetës së Nivicës, i cili në këtë çast u ndodh afër Selamit, një nga oficerët italianë po largohej me vrap. Selami i ktheu maliherin dhe e qëlloi. Plumbi e goditi ijë më ijë. Ai ra, pastaj u ngre. Njëri nga luftëtarët u mat ta qëllonte prapë, po Selami nuk e la. Pas pak ai vdiq. Selami, i mbështetur në pushkën e tij, po e shikonte i vrenjtur.

Luftëtarë i çetës së Nivicës që vrau gjeneral Gotin, i mori atij dylbitë, tē cilat i kish hedhur krahë-qafë, dhe një medalje argjendi tē mbërthyer në xha-

ketë. Dylbitë e gjeneral Enriko Gotit sot ndodhen të ekspozuara në Muzeun historik të Tepelenës, si material i kapur në luftë kundër pushtuesve të huaj.

Ushtria imperialiste italiane u shpartallua. Çetat e luftëtarëve kryengritës shqiptarë e çliruan Kotën. Luftimet u kurorëzuan me fitoren e lavdishme. Pö pulli shqiptar dhe historia e atdheut të tij u mburrën e do të mburren me trimëritë dhe heroizmat e treguara atje nga luftëtarët e çetave. E madhe qe jehona e luftës së Kotës, të shumta qenë këngët, që u kënduan, po këndohen e do të këndohen sa të jetë jeta, për fitoren e patriotëve shqiptarë. Ja disa vargje të njërsës prej tyre:

*Nuk harrohet Kota kurrë,
Kur mbi tela shkonim ne,
Edhe kur Selam Musai
Shkrepte natën si rrufe...*

Në Kotë armikut iu kapën tre topa në gjendje të mirë, shtatëmbëdhjetë mitralozë, qindra pushkë e shumë municione të armëve të ndryshme. U kapën rob tridhjetë oficerë e gjashtëqind ushtarë si dhe dyqind mushka.

Të gjithë robërit e kapur në Kotë e në luftimet e tjera u dërguan në fshatin Vajzë, ku qe ngritur kampi i përqëndrimit të robërvë të luftës, komandant i të cilit qe emëruar patrioti Rexhep Sulejmani.

Për ruajtjen dhe administrimin e materialeve, veçanërisht armatimin dhe municionin, që iu kap armikut në Kotë e në garnizonet e tjera, menjëherë u

krijua një komision, i cili kishte të drejtë të dënon-te deri edhe në pushkatim dhe t'u digjte shtëpitë atyre që merrnin e fshihnin pushkët e fishekët ose që dëmtonin armatimin tjetër. Kjo masë ekstreme qe e domosdoshme, sepse me armatimin e kapur armikut, gjatë luftimeve të fazës së parë, do të armatoseshin luftëtarët që s'kishin pushkë, për të zhvilluar etapën e dytë të luftës për çlirimin e Vlorës.

Edhe në garnizonet, presidet, e postet e tjera luftimet u kurorëzuan me sukses për kryengritësit shqiptarë. Në Gjorm, pas pak orë luftimesh, kapiten Bergamaski, pasi la tridhjetë të vrarë, u dorëzua bashkë me njëqind e tetëdhjetë ushtarë e oficerë. Në Llogora lufta që më e gjatë, dhe me përpjekje të ashpra e të përgjakshme. Kapiten Bonarisea, komandan i garnizonit, shfrytëzoi me zotësi terrenin e vështirë dhe fortifikatat që qenë atje, por pas tri-dhjetë orësh edhe atje forcat e armikut ngritën duart. Në Drashovicë, pas dy orë luftimesh, çetat shqiptare, nën komandë të Sali Vranishtit, e shpartalluan garnizonin italian duke zënë dyqind rob e shumë armatime dhe municione. Garnizoni i Matohasanajt u dorëzua pa qëndresë të rëndësishme, duke lënë në duar të luftëtarëve tre topa dhe armatim tjetër të shumtë me municionin përkatës.

Më vështirë u paraqit puna në Tepelenë. Atje, garnizoni italian, nënë komandën e major Kalçinit, nuk pranoi të dorëzohej. U bënë luftime të ashpra e të përgjakshme, por ushtarët armiq qenë të mbrojtur mirë pas mureve të kështjellës. Atëhere, krahas sulmeve të vazhdueshme, u kalua edhe në masa të tjera e konkretisht u prish ujësjellësi që furnizonte garnizonin dhe u prunë që nga kampi i përqëndrimit të Vajzës oficerë rob për t'i vërtetuar garnizo-

nit të Tepelenës që ushtria italiane e dislokuar jashtë qytetit të Vlorës qe shpartalluar e gjitha. Më njëzet e një qershori edhe Tepelena u çirua.

Gëzimi i popullit tonë pér fitoren mbi pushtuesit italianë qe shumë i madh. Ai e shikonte që kur qe fjala pér mbrojtjen e atdheut të gjithë bashkoheshin dhe e godisnin armikun si një grusht i vetëm. Gazeta «Fjal' e lirë» datë tre shtator 1923, duke përkujtuar fitoren e popullit tonë në Luftën e Vlorës më 1920, midis të tjerave, shkruan: «Më 6 qershori Besa e Lushnjës ish realizuar me një kurajo burrerie. Pushka po kërciste në llogoret e Kotës, në fortesat e Gjorimit, dhe pushtimi i padrejtë i ushtrisë italiane, më në fund, i bindej gjallërisë kombëtare, gjallëri, e cila çoi dyfekun e Selam Musait deri mbi spitalin e qytetit».

Një nga luftëtarët e çetave, midis shumë episodave që kanë të bëjnë me veprimet e Selam Musait, tregon edhe këtë të mëposhtmin:

Pasi pushuan edhe krismat e fundit të pushkëve e të mitralozëve, në Kotë, në një shesh të gjerë; u rrjeshtuan robërit italianë. Selami kalonte midis tyre dhe po i shikonte me kureshtje ata njerëz të rënë moralisht e me uniforma të ndotura me baltë e të grisura.

Midis ushtarëve italianë ai dëgjoi njërin prej tyre që fliste shqip, po ama një shqipe jo dhe aq të kulluar e të kuptueshme.

— Nga do jetë ky murtajë? — i tha ai Memë Sherifit që qe me të.

— As që e marr vesh — iu përgjigj Mema.

Selami u afrua dhe qëndroi përballë ushtarit. E shikoi atë me inat një copë herë. Ushtari, pa i

hequr sytë nga ai burrë i moshuar, me atë fytyrë të rreptë, po qëndronte gatitu.

— Po ti, more maskara, me armikun e vatanit qenke bërë? — i foli ai ushtarit, dhe, pa pritur përgjigjen e tij, u kthyte nga Mema: — Merre e vraje zagarin! Paska veshur edhe rrobat e armikut!

Mema, pa e zgjatur, e kapi ushtarin për jake të xhaketës dhe e tërhoqi mënjanë. Po aty për aty u sqarua që ai që kalabrez, prandaj dinte edhe shqip. Selamit i thanë që ushtari qe nga raca jonë, nga shqiptarët që, pas vdekjes së Skënderbeut, shkuan në Itali për të mos rënë në duart e turqve.

— Dhe tani, shejtanët, paskan ardhur të na zap-tojnë vatanin! — u përgjigj Selami.

Këtë ushtar ai e hoqi mënjanë e nuk e la të shkonte në vendin e përqëndrimit, dhe që atë ditë i siguroi një palë rroba te një fshatar vendës.

— Ti melun do të rrish me mua — i tha Selami kalabrezit, pasi e veshi si fshatar lab. Ai i caktoi detyrë që të kujdesej e t'i mbante kalin.

6. Vlora

Faza e parë e luftës për ndjekjen e Italisë imperialiste nga Vlora dhe krahinat u plotësua me sukces. Tani mbetej faza e dytë dhe më e rëndësishmja: çlirimi i Vlorës.

Luftëtarët e çetave kryengritëse qenë entuziazëtë, morali i tyre, pavarsisht nga humbjet që kishin pasur, qe shumë i lartë. Ata, pas kapjes së armatimit të reparteve italiane që u zunë rob, qenë armatosur më mirë. Në mendjet e tyre ato ditë qe vetëm çlirimi i Vlorës.

Lufta që bënë shqiptarët për çlirimin e Vlorës

bëri jehonë edhe jashtë kufinjve të atdheut. Shtypi i asaj kohe në vende të ndryshme e trajtoi në menyrë të dukshme luftën e popullit shqiptar kundër pushtuesve italianë. Muza populllore i ka kushtuar disa këngë jéhonës që bëri ngritja e popullit shqiptar kundër shtetit të madh e të fuqishëm Italisë. Ja njëra nga ato këngë, e cila është më e përhapura dhe këndohet në vallet e burrave:

Evropa shkruajnë e thonë:

— Ç'është kështu si dëgjojnë?
— Bënët dyfek në Vlorë,
Shqiptarët po luftojnë,
Me një mbret dyzet milionë.
— Po me se luftojnë vallë?
— Me sopata e me hanxharë,
Dyfeqet lidhur me gjalmë,
Fishekët në xhep i mbajnë,
Në tri ditë bukë hanë...

Komanda e trupave italiane në Vlorë dhe vetë gjeneral Piaçentini, përballë heroizmave dhe këmbënguljes së shqiptarëve për ta çliruar vendin e tyre, u gjendën para të papriturave. Ata nuk besonin që, fshatarët e armatosur keq, pa specialista ushtarake përt'i drejtuar, të pastërvitur për të luftuar me një ushtri të rregullt, pa një taktkë të përpunuar, dhe me një raport forcash afërsisht pesë me një, në favor të italianëve, të bënин ato çudira që bënë duke i as-gjësuar garnizonet e fuqishme, të armatosura deri në dhëmbë, brenda një kohë të shkurtër.

Gjeneral Piaçentini, me qëllim që të mos përsë-

riteshin më humbjet fatale për forcat e tij, mori masa nga më ekstremet. Në qytetin e Vlorës, u shpall gjendja e jashtëzakonshme. Filluan arrestimet në masë, për dy ditë u kapën njëmijë e katërqind veta, shumicën e të cilëve i çuan në Sazan ose në Itali, kurse disa, më të rrezikshmit, i mbanin brenda në anijet luftarakë dhe i torturonin në mënyrë Mizore. Filluan në qytet djegiet dhe plaçkitjet. Më nëntë qershor, nga Vlora mundën të delnin njerëz, të cilët erdhën në Drashovicë dhe prunë lajme mbi krimet çnjerëzore që bënин italianët kundër grave, fëmijëve e pleqve. Piaçentini, me një urdhër të posaçëm, ngarkoi komandantin e Divizionit 36, gjeneralin Puljeze, për të organizuar mbrojtjen rrethore të qytetit të Vlorës dhe kalasë së Kaninës.

Ushtarët e punëtorët italianë u vunë me shpejtesi për të hapur llogore, për të ndërtuar pengesa të tjera me tela e me mina, si dhe fortifikata e qendra zjarri për vendosjen në to të artilerisë dhe të armëve të lehta automatike. Nëpër degët e ullinjve u ndërtuan vende apostafat për të vendosur në to mitralozë dhe pushkatarë të zgjedhur, të cilët, në mënyrë të befasishme, do të godisnin luftëtarët shqiptarë pas shpine, në qoftë se ata do të mundnin të shpërthenin mbrojtjen e italianëve.

Anijet e flotës luftarakë detare morën urdhër të godisnin me zjarrin e artilerisë fshatrat e çliruara rrëth Vlorës si dhe kodrat e brinjat ku qenë përqëndruar çetat e luftëtarëve.

Dëmet nga goditjet e topave të fuqishëm qenë të mëdha, shtëpitë e fshatrave që qenë brenda rrezes së qitjes po digjeshin. Forcat kryengritëse, duke mos pasur artilerinë e nevojshme për goditjen e anijeve armike në det, po i shikonin me indinjatë veprimet

banditeske të italianëve. Sipas një këngë të bukur të asaj kohe, kryetari i Komitetit «Mbrojtja Kombëtare», Osman Haxhiu, i hipi kalit, doli karshi trupave italiane dhe i thirri komandantit të tyre që të delte edhe ai nga anijet dhe forcat e tyre e të mateshin në shesh të burrave. Ja kënga:

*Ç'i hipi Osmani kalit,
Bëri poshtë, buzës malit,
I bërtiti gjeneralit:
— Breshkamadh i breshkamadhit,
Dil steresë e jo limanit,
Të shoç të zotë e vatanit...*

Topat e vendosur mbi Vlorë, në kodrat që rrethojnë qytetin, si dhe ata të kalasë së Kaninës që-llonin papushim, ditë e natë, në të gjitha drejtimet, e veçanërisht mbi Drashovicë, ku qe qendra e Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» dhe e komisionit ushtarak. Disa predha artilerie goditën depot e vajgurit dhe, si rezultat, tymi e flaka mbuluan për një kohë Drashovicën.

Në një këngë labe, kú përjetësohet ky moment i përpjekjes së komandës italiane për shtypjen e kryengritjes shqiptare me zjarr e hekur, janë edhe këto vargje:

*Atje, te hani në grykë,
Te ura në Drashovicë,
Qëllon topi Italisë,
Komisionë e Shqipërisë,*

*O moj Shqipëri e bardhë,
Bota ta kanë sevdanë,
Të keqen ta kanë marrë,
Se ke trima kordhëtarë,
Barutin me grusht e hanë!*

Aeroplanët dhe hidroplanët italianë fluturonin vazhdimisht mbi krahinat e qiruara. Ata kryein zbulim ose mitralonin fshatrat dhe çetat e luftëtarëve kryengritës.

Krahas masave të tjera, gjeneral Piaçentini iu drejtua edhe Ministrisë italiane të Luftës për t'i kërkuar përforcime në njerëz e në materiale. Këto ndihma atij ia premtuan dhe e urdhëruan që Vlorën ta mbronte me çdo kusht, ajo s'duhej, në asnje mënyrë, të binte në duart e shqiptarëve.

Më datën tetë qershor komanda italiane e Vlorës, duke marrë parasysh se garnizoni i Tepelenës nuk qe dorëzuar ende dhe luftonte kundër forcave shqiptare, vendosi ta ndihmojë atë, dhe atë pasdite nisi për atje dy batalione. Qëndresa e Tepelenës, nga pikëpamja ushtarake, komandës italiane i interesonte shumë, sepse atje qenë gozhduar një sasi e mirë e forcave kryengritëse shqiptare, kryesisht çeta të Kurveleshit e sidomos të Tepelenës, Përmetit e Skraparit.

Batalionet e ushtrisë italiane, sa dualën nga Vlora, e pikërisht në Qishbardhë, u ndeshën ballë për ballë me çetat e kryengritësve. U ndez një luftë e shkurtër, por e rreptë. Luftëtarët e Selam Musait u bënë mur 'i pakalueshëm për ushtarët armiq. Pas rreth dy orë luftimesh, italianët nuk mundën t'u qëndronin sulmeve të shqiptarëve, të cilët me britma

luftarake u hodhën nga të gjitha anët mbi ta dhe mundoheshin t'i rrëthonin e t'i shfarosnin të gjithë, prandaj ata, pasi lanë shumë të vrarë, u thyen dhe u futën prapë në Vlorë.

Nga Italia filluan të vinin ndihmat e para. Në skelë zbarkuan ushtarë të tjera, topa, mitraloza e pushkë, munizione dhe autoblinda. Gjithashtu u përforcua aviacioni me aeroplani të tjera. Në garnizonin e Vlorës erdhën edhe forcat e Sarandës e të Himarës.

Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» dhe komisioni ushtarak, menjëherë pas kurorëzimit me sukses të fazës së parë të luftës, u mblodhën në Drashovicë dhe analizuan gjendjen. Të gjithë e kuptionin që de-tyra më e ngutshme tanë qe sulmi vendimtar mbi Vlorën. Por për këtë u bënë shumë diskutime. Komiteti ngarkoi një grup oficerësh, të cilët duhej t'i bënin një analizë të thellë situatës së krijuar dhe në bazë të kësaj analize të nxirrin konkluzione nëse mund të kish sukses sulmi mbi Vlorë ose jo.

Grupi i oficerëve e filloj punën dhe, duke u nisur nga kërkesat e artit ushtarak, të cilat ata i kishin mësuar nëpër shkollat e akademitë e huaja, si rapporti i forcave të të dy anëve ndërluftuese, pajisja materiale e teknike, fortifikimi e të tjera, arritën në konkluzion se ushtria italiane në të gjithë treguesit kish epërsi të plotë, prandaj, sipas tyre, sulmi mbi Vlorë qe i kotë, nuk do të jepte përfundimet e dëshiruara dhe do t'u shkaktonte forcave shqiptare shumë humbje.

Këto mendime të grupit të oficerëve i mbështetën edhe disa nga anëtarët e komitetit. Ata thoshnin se pa patur artileri të rëndë për të goditur fortifikat e fuqishme të armikut, që qenë ndërtuar në

kodrat rrëth Vlorës, dhe të çanin rrugën për të ecur përpëra, si dhe për të goditur objektet e rëndësishme të armikut në thellësi të tij, sulmi përmby Vlorë nuk mund të bëhej.

Në lëkundjen e këtyre anëtarëve të komitetit luajti rol, jo më pak të rëndësishëm, edhe terrori që shpërthyen në popullin vlonjat pushtuesit italianë, me atrimin e çetave shqiptare rrëth Vlorës. Gjeneral Piacentini e kërcënoi hapët Komitetin «Mbrojtja Kombëtare» se në rast sulmi të çetave kundër Vlorës, ai do të jepte urdhër që të masakroheshin e të zhdukeshin të gjithë të arrestuarit.

Por shumica e anëtarëve të Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» dhe e komisionit ushtarak qe për sulmin mbi Vlorë. Ndërsa komandantët e çetave të fshatrave dhe të krahinave, si dhe luftëtarët e tjerë, as që pranonin të dëgjonin vendim tjetër vec atij përtu nisur për në Vlorë.

Kur po bëheshin këto diskutime në komisionin ushtarak, Selam Musai, i cili qe ftuar të merrte pjesë në mbledhje, u revoltua dhe u grind me kryetarin e komisionit.

— Në kini frikë ju, — i tha ai — rrini mënjanë. Ne kemi ardhur këtu jo për Kotën por për Vlorën.

— Po Vlorën do ta sulmojmë po të urdhërojmë ne — iu përgjigj ai.

— Ato fjalë mua dhe djemve të mi nuk na hyjnë në punë. Ne do t'ju dëgjojmë, po qetë për luftë dhe po na udhëhoqët përpëra. Po s'qetë për luftë, ne s'ju dëgjojmë hiç dhe do të nisemi vetë, se rrugën e Vlorës e dimë edhe pa na e treguar ju, — deklaroi Selami dhe desh të largohej nga mbledhja, po anëtarët e komisionit, duke iu lutur e mbajtën aty.

Sipas një luftëtarit, dëshmitar i atyre ngjarjeve,

kur komisioni vendosi që sulmi mbi Vlorë duhej tē bëhej dhe bile sa më shpejt që tē qe e mundur, me qëllim që tē mos u jepej kohë italianëve ta mblidhnin veten pas goditjes që muarën dhe tē for-coheshin, Selami, i kënaqur, u ngre e kërkoj që sektori më i vështirë i frontit t'i caktohej atij.

Qëndrimin e Selam Musait mbajtën tē gjithë luftëtarët dhe komandantët pjesëmarrës në Luftën e Vlorës. Në këto ditë ata kishin në gojë parullën luftarake: «O Vlorë, o vdekje!»

Ato pakë ditë që mbetën deri në fillimin e sulmit mbi Vlorë, luftëtarët i përdorën pér t'u pajisur më mirë me armë e municion, pér t'u larë në lumin e Shushicës, pér t'u ndërruar dhe pér t'u çlodhur. Kurse komandantët e getave të fshatrave e të krahinave tërë ditën delnin kodrave përballë llogoreve të ushtrisë italiane, e shikonin vendin ku do tē hidheshin në sulm, studjonin pengesat, mundësítë dhe mënyrat e kalimit të tyre, mitralozët dhe drejtimet e frëngjive të pozicioneve e të tjera gjëra.

Sipas tregimeve të shumë luftëtarëve pjesëmarrës në Luftën e Vlorës, Selam Musai kthehej mbrëmjeve te shokët e tij, ulej midis tyre dhe fillonte të tregonte episode të ndryshme nga luftërat që kish zhvilluar vetë ose shokët e tij. Ai kish aftësi t'i shtjellonte ngjarjet para atyre që e dëgjonin, në mënyrë interesante, dhe t'i bënte ata që ta ndiqnin me kujdes kur fliste.

Tregimet e tij më prekëse qenë ato që bënin fjalë pér trimëritë e treguara në luftë nga dy vëlle-zërit Aqif dhe Ali Rakip Llaka. Kur Selami fliste pér Aliun, ata që ndodheshin afér tij shikonin se si atij i merrnin zjarr sytë, i ngrysej fytyra dhe i rëndohe-shin vetullat. Tregonte ai edhe pér kushërinjtë e parë

të tij, të cilët u vranë dy në luftimet për mbrojtjen e Janinës dhe dy në Labovë.

Selam Musai kish lindur në luftë dhe qe rritur e moshuar po në luftë, duke qenë gjithmonë me armë në dorë. Lufta për mbrojtjen e atdheut atij i qe bërë e domosdoshme në jetë. Një burrë plak nga Nivica, i cili e ka dëgjuar vetë, tregon se një herë Selami me disa të tjerë qenë mbledhur në teqe të Turanit. Në bisedë e sipër babai i teqesë i pyeti të gjithë me radhë mbi dëshirat e tyre. Dhe ata iu përgjigjën: dikush kerkoi bagëti, dikush ara, dikush fëmijë... Kur i erdhi radha Selamit, ai u përgjigj: «Dëshira ime është që të kemi Shqipërinë të lirë. Po nuk patëm Shqipëri të lirë, atëhere jeta ime të ketë gjithmonë luftë».

Edhe tanë në ullishtat e Vlorës, kur ai qe përballë imperialistëve italianë, çdo tregim të tij e mbyllte me fjalët: «Në luftë kundër armikut më daltë shpirti».

Këtë frazë e thonë shumë luftëtarë që e kanë dëgjuar nga goja e tij, gjithashtu përmendet edhe në një libër të botuar mbi Luftën e Vlorës.

Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» vendosi që sulmi mbi Vlorë të bëhej më njëmbëdhjetë qershori në mbrëmje.

Më datën nëntë qershori Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» i dërgoi gjeneral Piaçentinit një thirrje, me anën e së cilës i kërkohej që ushtria italiane të hiqte dorë nga qëndresa e mëtejshme në Vlorë dhe ta dorëzonte qytetin pa luftë. Në thirrje, veç këtyre, tregoheshin edhe sukseset e çetave shqiptare në fazën e parë të luftës, pastaj protestohej për veprimet barbare të komandës italiane kundër popullit të Vlorës. Më në fund, Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» e

paralajméronte gjeneralin italian që në qoftë se Vlora nuk dorëzohej pa luftë, ajo do të sulmohej nga forcat kryengritëse shqiptare dhe pushtuesit do ta paguanin shtrenjtë.

Gjeneral Piaçentini nuk iu përgjigj thirrjes dhe menjëherë vuri forca më të shumta për intensifikimin e përpunimeve mbrojtëse rreth qytetit të Vlorës dhe Kalasë së Kaninës. Sipas kujtimeve të disa veteranëve, veç këtyre masave ai, ditën e nesërme të marrjes së thirrjes, urdhëroi që të bëhej një sulm i shpejtë e i fuqishëm kundër forcave kryengritëse shqiptare, me qëllim që t'i ndiqte ato nga kodrat rreth qytetit dhe t'i detyronte të hiqnin dorë nga sulmi mbi Vlorë. Kështu, më datën dhjetë qershori, pas goditjes së luftëtarëve me zjarrin e fuqishëm të artilerisë së anijeve, disa batalione të ushtrisë italiane u hodhën në sulm. Por ata që në hapat e para u ndeshën në zjarrin e luftëtarëve të çetave dhe, pasi lanë në vend të vrarë e të plagosur, u kthyen prapë në qytet.

Tani s'mbetej gjë tjetër veç sulmit mbi Vlorë.

Sipas planit të komisionit ushtarëk, të aprovar edhe nga Komiteti «Mbrojtja Kombëtare», sulmi mbi Vlorë do të bëhej në orën 22 të datës 11 qershori, duke vepruar në një kohë të gjitha çetat. Gjithashtu, sipas planit, në këtë orë do të hidheshin në kryengritje të armatosur edhe qytetarët vlonjatë. Në këtë mënyrë sulmi mbi Vlorë qe kombinuar për ta vënë ushtrinë italiane midis dy zjarreve.

Vlora nuk mund të rrrethohej plotësisht, për shkak të pozicionit të saj. Ana e detit mbetej gjithmonë e hapët e në dorë të ushtrisë italiane. Kështu që çetat e luftëtarëve e mbanin atë të shtrënguar në gjysmunazë. Forcat shqiptare qenë shpërndarë në

formacione luftimi nga Veriu në Jugë: Panajaja, Qafa e Bestrovës, Kodrat e Babicës, Qafa e Koçut, Mesovun, para kalasë së Kaninës e Uji i Ftohtë.

Çetave të Tepelenës, që komandoheshin nga Selam Musai, komisioni ushtarak, me kërkesën e vetë Selamit, u caktoi drejtimin që konsiderohej më i rrezikshëm: Kodrat e Babicës, majtas Qafës së Koçut, qendër e qytetit Vlorë.

Në të djathtë të forcave të Selamit qenë rrresh-tuar forcat e Kurveleshit e më djathtas, në kodrat e Risilisë, qenë ato të Mallakastrës, kurse majtas forcave të Selamit do të sulmonin çetat e fshatrave të Vlorës.

Në pasditen e datës 11 qershori forcat e Selam Musait u nisën nga Drashovica në drejtim të Vlorës. Para se t'ia hipte kalit e të delte në krye të luttatarëve, Selami u takua me anëtarët e Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» dhe të komisionit ushtarak. Atë çast ai ishte i gjëzuar, bënte shaka, qeshte me zë të lartë, dhe më në fund thirri fort:

«Tëmirë u pjekshim në Vlorë» pastaj i hipi kalit, i ra me kamxhik dhe «Binoku» fluturoi tutje.

Për nisjen e Selam Musait nga Drashovica në drejtim të Vlorës dhe pér heroizmin e tij gjatë kap-jes së topit italian, populli këndon një këngë, e cila është nga më të njohurat dhe është kënduar e këndohet në çdo rast festë a gjëzimi. Ja disa vargje të saj:

*C'u shkule nga Drashovica,
Lule, more Selam, lule,¹⁾
Me treqind e ca komita*

1) Përsëritet pas çdo vargu.

Bëre poshtë nga Babica,
E zure topin nga gryka,
Me një djalë nga Nivica.
Piaçetinin e mori frika,
U the shokëve: «mos u trembni,
Se s'ka ç'na bën breshkaqeni!»

Aty nga mugëtira e mbrëmjes, para nisjes për të zënë vendet nga do të fillonin sulmin, u mblohdhën në Qishbardhë dhe çetat morën ushqimin e darkës. Për çdo dhjetë veta u kishin prurë një mish të pjetur, dy napa me djathë të njomë dhe bukë misri.

Në këtë kohë Selami me udhëheqësit e tjerë të çetave u tërhoqën mënjanë dhe biseduan për mënyrat e veprimeve, rrugët e lëvizjes përpara, drejtimin e çdo çete. Prapë edhe këtu rëndësi e veçantë iu dha takistikës që duhej përdorur për të mashtruar armikun dhe mënyrave të kalimit të pengesave të shumta që kishin përpara; veçanërisht atyre prej teli.

Qazim Dervish Hitaj dhe veteranë të tjerë të Luftës së Vlorës tregojnë se Selam Musai, me qëllim që luftëtarët shqiptarë të mos zbuloheshin nga ndriçimi i prozhektorëve italianë dhe që ushtarët armiq të mos mundnin të hapnin zjarr preçiz, urdhëroi që çdo luftëtar, para atrimit për te armiku, të priste dega me gjethë, sipas vendit, dhe t'i mbante me vete. Në çastin që drita e prozhektorëve do të hidhej në drejtim të tyre, ata duhej të qëndronin në vend, të uleshin ndenjas dhe të vinin para tyre degët. Në interval, kur drita e prozhektorëve kalonte në drejtime të tjera, luftëtarët duhej të hidheshin me shpejtësinë më të madhe përpara. Luftëtarët tregojnë se ata, për ta zbatuar këtë, prenë dega drizash, të

cilat qenë me shumicë, ose dega ullinjsh dhe i përdorën gjatë luftimit.

Veprime të tilla për të mashtruar armikun në Luftën e Vlorës u përdorën shumë e nga më të ndryshmet. Patrioti Xhafer Meta, komandanti i çetës së Gusmarit, u propozoi luftëtarëve që thasë të mbushur me kashtë dhe sherqe e guna të vendoseshin në një drejtim të rremë, andej nga italianët e prisin sulmin, kurse në të vërtetë luftëtarët të sulmonin në drejtimin tjetër dhe t'i kapnin në befasi armiqtë.

Në orën 22 të 11 qershorit, çetat e rreshtuara në kodrat e Babicës, para Qafës së Kogut dhe në Kodrat e Vlorës, filluan të parat sulmin. Luftëtarët, në kulmin e entuziazmit, me britma të fuqishme luftarake: «O burrani, në Vlorë!», «Kapini me dorë breshkamëdhenjtë!», «Mbytini qentë, që na kanë zaptuar vatanin!» u hodhën në sulm.

Mbi të gjitha këto zëra burrash trima kumboi thirrja e Selamit: «Përpara, o djem, në Vlorë!». Dhe ai, duke qenë në krye të shokëve, qëllonte kundër pozicioneve të armikut. Në krah të djathjtë të tij qe komandanti i çetës së krahinës së Lopësit, Dule Dallani, kurse majtas tij trimi i rrallë Memë Sherifi. Që të dy këta shokë besnikë nuk i ndaheshin atij asnjë hap.

Italianët, të cilët ato ditë rrinin të gatshëm në pozicionë dhe flinin me sy hapët, shumë shpejt vunë në përdorim gjithë teknikën e tyre luftarake. Breshëri prej plumbave të pushkëve, mitralozëve të lehta, të vendosur nëpër ullinjë, dhe mitralozëve të rëndë po derdhej mbi formacionet e luftëtarëve të çetave. Artilleria e tyre, si ajo e anijeve, ashtu edhe ajo e vendosur në pozicionët e vijës së parë, qëllonte

papushim. Predhat, me zhurmë shurdhonjëse, pëlcis-hin kudo. Vendi mbi të cilin ecnin përpara shqiptarët u bë tym e u ndez zjarr e flakë.

Riza Runa, në kujtimet e tij për luftën e një-mbëdhjetë qershorit, midis të tjerash, shkruan: «Nuk e di si ta përshkruaj këtë luftë, por ja ku them se kaq topa ranë saqë u bë tym dynjaja dhe nuk mund të shihnim as shoqi-shoqin fare. Unë shumë herë rashë përdhe nga gjylet e topave».

Në një këngë popullore, e cila është shumë e njojur dhe i kushtohet ashpërsisë së asaj lufte, midis të tjerave thuhet:

*Qaf' e Koçlut, moj grykë,
Ç'hata bëre atë ditë,
Me topa, me elektrikë
E bëre natën ditë,
Mjegull e flak' e jeshiltë
Nga gjylet që pëlcisnë...*

Në këtë situatë të vështirë Selam Musai u jep kurajo shokëve duke u folur që të mos ua venë veshin predhave e plumbave, sepse italianët qëllonin në të verbër, po të ecnin përpara. Njëkohësisht ai kujdeset edhe për krahët e tij, mundohet që të mos shkëputet nga forcat që veprojnë në të djathët e në të majtë. Kur doli mbi burgun e vjetër, i cili në atë kohë ka qenë pa vajtur në Qafë të Koçut, Selami, duke iu drejtuar forcave të Kurveleshit që qenë më të djathët të tij, u bën thirrje atyre të hidhen përpara dhe të tregojnë trimërinë e tyre. Këtë çast ngajeta e Selam Musait e ka përjetësuar rapsodi popullore në një këngë, në të cilën midis të tjerave thuhet:

*Doli Selami si ylli,
Doli në breg edhe thirri:
— O kurveleshas, ku jini?
Se këtu duket trimi!...*

Luftëtarët tepelenas mbritën te pengesat e tela-
ve me gjemba, të cilat qenë ndërtuar të përsosura
dhe, sipas specialistëve italianë, ishin të pakapërcy-
eshme. Këto qenë më të gjera se ato të Kotës. Lar-
tësia e tyre i kalonte të dy metrat, kurse gjerësia tre
e katër metra. Për çdo gjysmë metri kalonte një ra-
dhë teli me katër-gjashtë fije. Prapa pengesave me
tela qenë ndërtuar llogoret ku qëndronin ushtarët ita-
lianë me pushkë e mitralozë në duar. Në vende të
përshtatshme, drejt në vijë të parë, qenë prurë e
vendosur topa të ndryshëm.

Patriotët, pér të kapërcyer pengesat, kishin ma-
rrë disa masa: qenë bërë lesa të thurura me thupra,
shkallë nga më të ndryshmet, disa kishin siguruar
dërrasa e trarë, kishin mundur të gjenin ndonjë palë
gërshërë pér prerjen e telave, e të tjera. Por megjith-
atë, pér téré masën e luftëtarëve, këto qenë të pa-
mjaftueshme. Kështu që ata, kur u gjendën ballë pér
ballë me barrikadën e telave me gjemba, nga dëshira
pér të kaluar sa më shpejt u hodhën mbi tela.
Por rezultati qe i paktë, sepse ata mbërttheheshin e
ngatërroheshin midis radhëve.

— Hidhni gunat përsipër! — bërtiti Selami.

Ai i pari hoqi gunën e tij, u kap me dorë në
radhën e kreut të telave, hodhi atje gunën, pastaj
hipi lart. Deri sa ta kalonte krejt pengesën, atij iu
desh ta ndërronte edhe një herë vendin e 'gunës. Më

në fund u hodh me shpejtësi në anën tjetër dhe u nis tutje.

Rapsodi populor e ka përjetësuar këtë veprim të Selam Musait në këngën e mëposhtme:

*I shkreti Selam dragoi,
Gunën mbi tela e shtroi,
E me krahë si fajkoi
Mbi armiq u sul e shkoi,
I shpërndau dhe kaloi...*

Luftëtarët tepelenas, duke ndjekur shembullin e Selamit dhe me mënyra të tjera i kaluan telat dhe u ndodhën përballë llogoreve të italianëve. Disa prej tyre, si dhe një pjesë e kurveleshasve, kaluan gjatë rrugës automobilistike, e cila qe lënë e hapët.

Selam Musai me shokë u hodhën në llogoret e armikut dhe u përleshën trup me trup me pushtuesit. Flaka e pushkëve, mitralozëve, bombave dhe predhave të artilerisë e ndriçonin vendin dhe çdo gjë dukej qartë. Luftëtarët e çetave, midis plasjeve shurdhunjëse, dëgjonin zërin e njohur të Selamit, që u drejtohej atyre: «Përpara, o djem».

Pasi kaloi llogoren e parë, pak më tutje, Selam Musai vuri re një top, i cili qëllonte papushim kundër luftëtarëve që qenë ende te pengesat e telave. Pa humbur kohë, ai, bashkë me Memë Sherifin dhe Shefqet Shehun nga Nivica, u drejtuat për atje. Kur ai ndodhej pak metra para topit, u bë shkrepja dhe predha i kaloi pak majtas e plasi me shpërthim të fuqishëm më tej. Ai, i tronditur nga gjëmimi

i tmerrshëm dhe nga flaka, shau rëndë dhe u hodh në pozicion të topit, vrau me revolver e pushkë disa nga numërorët, kurse të tjerët lanë armën në vend dhe ikën të tmerruar nga ai plak flokëbardhë, që u hodh i tèrbuar mbi ta.

Topi mbeti në duar të Selamit. Në këtë kohë italianët hidhen në kundërsulm për të rimarë pozicionet e humbura. Kompanitë, të hapura në formacion luftimi, po ngjiteshin lart kodrave duke thirrur e duke qëlluar me të gjitha armët që kishin me vete. Armiqtë u afruan edhe në pozicionin e topit ku qe Selami. Në krye të tyre qe një kolonel italian. Ai, duke u thirrur ushtarëve për t'u dhënë zemër, e duke sharë ata që kishin lënë topin në vend e qenë larguar, mbriti te Selami.

— A, qen bir qeni! Ta tregoj unë ty — thirri Selami dhe qëlloi me një krehër fishekë kundër armiqve.

Ai, me ata pak shokë që kish, u përllesh me armiqtë e shumtë. Kur e pa që pushka punonte ngadalë dhe në ato momente s'dilte koha për ta mbushur, përdori revolverin. Koloneli italian i doli fare afér. Selami e kapi maliherin me të dy duart për tyte dhe, me sa fuqi që kish, e goditi atë me qytë, e rrëzoi poshtë dhe e vau. Rapsodi popullor përlleshjen e tij me kolonelin italian e ka përfjetësuar në një këngë të bukur popullore, në të cilën janë edhe këto vargje:

...*Sheshoi telat me gjemba,
U hodhi gunën e tija,
Zu kolonelin për gryke,
Sa bërtiti: «Mama mia!»*

Paş disa orë luftimesh, duke vadir me gjak çdo pëllëmbë tokë që merrnin, luftëtarët e çetave, më në krye Selam Musanë, mbritën deri mbi spitale të Vlorës. Por pas tyre, të fshehur nëpër ullinj, qenë bersalierët italianë, të cilët i qëllonin luftëtarët e çetave me pushkë e mitralozë, prapa shpine. Në këto kushte situata u bë mjaft e vështirë. Përballë luftëtarëve qëndronin forca të shumta të armikut, të cilat herë pas here hidheshin në kundërsulme, kurse prapa tyre qenë bersalierët, të cilët ishin shumë dinakë.

Selami me Dule Dalanin dhe shokë të tjera u gjendën midis dy zjarrëve. Plumbat u vinin nga të gjitha anët, dritat e prozhektorëve i ekspozonin ata para armikut si ditën më diell. Megjithëkëtë ai nuk e humbi gjakftohtësinë, por i organizoi shokët për luftë kundër armikut që kish pas shpine dhe ata, duke manovruar pas çdo ledhi e çdo trungu peme, mundën t'i pastronin ullinjtë nga bersalierët dhe t'i vënë ata në ikje për në qytet, kurse një pjesë të tyre i vranë në vend.

Ushtria italiane u thye nga një pjesë e kodrave të Vlorës dhe Qafa e Koçikut, la pozicionet dhe vërvshoi si lumë nëpër rrugët e Vlorës. Komanda e forcave italiane, e shqetësuar nga kjo disfatë e re, mori masa nga më ekstremet. Në radhë të parë detyronte, duke i kërcënuar me pushkatim, ushtarët që kishin ikur, që të ktheheshin në pozicionet e tyre të mëparshme. Nisi autoblinda kundër luftëtarëve shqiptarë, hoqi nga anijet e luftës shumë marinarë dhe i nisi si këmbësorë në vijë të parë për të mos lejuar hyrjen e patriotëve shqiptarë në qytet. Atë natë vlonjatët panë me sytë e tyre se si oficerët italianni me revole në dorë shtjinë mbi ushtarët e tyre,

të cilëve u kish hyrë frika në palcë dhe nuk bindeshin për t'u kthyer prapë në luftë.

Njëkohësisht komanda e forcave italiane në Vlorë e njoftoi zyrtarisht Komitetin «Mbrojtja Kombëtare» se po të mos ndalohej sulmi mbi qytet, ajo menjëherë do të masakronte të njëmijë e shtatëqind patriotët shqiptarë që kishte të arrestuar.

Por tani forcat kryengritëse nuk pyesnin për as gjë veç qirimit të qytetit të Flamurit. Përballë Selam Musait dualën forca të reja italiane, të cilat përbëhen nga marinaret e bersalierë.

Selami u fut midis formacionit të ushtarëve armiq e po përleshej me ta. Një nënëoficer italian i ktheu pushkën e po bëhej gati t'ia zbrazte në gjoks, po Selami vetëtimthi iu hodh dhe i nguli thikën në grykë e pastaj në bark. Ja si e paraqet kënga populllore këtë skenë:

*O Selam, o trim i rrallë,
Te ullinjtë mbi spitalë,
Zure një marshall të gjallë,
I preve kokën 'me pallë...*

Përmes flakës së plasjeve dhe dritës së prozhektorëve shokët e tij e panë Selamin të mbushë armët dhe të qëllonte kundër italianëve, të cilët u thyen prapë e po tërhiqeshin. Bashkë me të qenë Dule Dallani, Memë Sherifi, Ibrush Muçaj e shumë të tjera.

Çeta e Salarisë, duke vepruar me trimëri e duke manovruar më guxim, u fut brenda formacioneve të reparteve të ushtrisë italiane dhe mbriti mbi qytet. Pjesëmarrësi i Luftës së Vlorës Abdul Agalliu në kuj-

timet e tij shkruan: «Çeta e Selam Musait depërtoi më thellë në qytet. Ai érdhi deri në vendin që quhet Bregu i Orizit, afro njëqind metra mbi qytet, dhe mesokëllima i shkuli armiqtë nga llogoret, duke i vënë përpara si lopët...».

Shokët e Selamit, të cilët kanë qenë me të në luftime të ndryshme, tregojnë që ai, zakonisht, luttonte duke qëndruar më këmbë ose më gjunjë. Edhe këtu, në të hyrë të qytetit të Vlorës, pjesëmarrësit në atë luftë e panë atë duke luftuar më këmbë e duke u thirrur shokëve për t'u dhënë guxim.

Në një rast rreziku kur, si rezultat i ecjes shumë përpara, çetat e Tepelenës u shkëputën nga të tjerat dhe mund të rrëthoheshin, Dule Dalani i thirri Selamit të qëndronte në vend e të prisnin çetat, që duhej të ishin majtas e djathtas tyre.

— Është vonë tani — dëgjuan luftëtarët Selamin t'i përgjigjet shokut të tij.

Kur mbriti te Bregu i Orizit, prej nga qyteti i Vlorës dukej si në pëllëmbë të dorës, Selami briti disa herë duke u bërë thirrje luftarake shokëve të tij për të hyrë në Vlorë. Krismat e pushkëve të patriotëve dhe veçanërisht britmat e Selamit, të cilat, sipas bashkëluftëtarëve të tij, të bërin që të mos merrje parasysh asgjë po të hidheshe në zjarr, ngritën peshë zemrat e vlonjatëve dhe shumë prej tyre, megjithë rrezikun që i kërcënonte nga ushtria italiane, u holdhën në mbështetje të veprimeve luftarake të çetave. Abdul Agalliu, në kujtimet e tij, vazhdon: «Sosokëllima e Selam Musait ndezi gjakrat e qytetarëve në prapavijë. Kështu dëshmori Qazim Lalo nga Lagjja e Re u hapi zjarr nga dritarja ushtarëve që iknin në panik, pastaj u vra edhe vetë».

Dule Dalani, trimi i rrallë e gjakftohtë, duke e

parë që Selam Musai po shkëputej nga shokët dhë po ndeshej në luftim të afërt me disa armiq, i shqetësuar për jetën e tij, i thirri prapë që të mbrohej më mirë e të mos futej vetëm në mes të italianëve. Rapsodi popullor këtyre minutave të jetës së Selam Musait u ka kushtuar këngë të veçantë, në të cilën midis të tjerave thuhet:

*O Dule, mos e prish gjaknë,
Se trimat kështu e kanë!...*

Afër mëngjesit luftëtarët e çetave, për herë të fundit, e panë Selam Musanë me disa shokë të tjerë, midis të cilëve qe edhe Dule Dalani, majtas spitalit, në një kodër të vogël. Ai, duke qëndruar në majë të kodrës, po qëllonte kundër ushtrisë italiane, e cila po e sulmonte me egërsi grupin e vogël të luftëtarëve shqiptarë. Sipas tregimit të një luftëtarit të çetës së Nivicës, që ndodhej jo shumë larg, në krye të reparateve italiane, drejt në vijën e parë të sulmit, qe një gjeneral, i cili me pistoletë në dorë i nxiste ushtarët të hidheshin përpara. Selami iu drejtua atij dhe e qëlloi. Por edhe gjenerali italian si dhe shumë ushtarë e oficerë të tij, nga drejtime të ndryshme e qëlluan Selamin.

Ai u rrëzua në tokë, por shpejt u ngrit prapë. Bomba të shumta plasën rreth tij, dhe dhjetëra pushkë e mitralozë qëllonin mbi të. Kodra u ndez flakë dhe Selami në këtë çast u humbi nga sytë luftëtarëve të çetave. Kështu, tregojnë ata, disa prej të cilëve jetojnë edhe sot, kështu thotë edhe një nga këngët popullore kushtuar atij:

*I shkreti Selam Musa,
U fut në flakë e s'u pa...*

Çastit të fundit të jetës së tij muza popullore është këndoi:

*Kush e njih Selam Musanë,
Burrë i shkurtër, leshrabardhë,
Te spitali më të dale
Ball'për ball' me gjeneralë
Flakën sho-shoqit ja dhanë
Një në zemër një në ballë!*

Dule Dalani, i cili nuk iu nda në asnjë çast Selam Musait, në përleshje me armiqtë u godit nga disa plumba. Megjithatë ai vazhdoi të qëndrojë në krah të Selamit, si shok i pandarë i tij. Luftëtarët e panë atë për të fundit herë kur ishte duke qëlluar mbi armiqtë dhe kur plumba të tjerë e goditën dhe e rrëzuan në tokë për të mos u ngritur më.

Ibrush Muçaj ra duke luftuar, në një kohë më Dule Dalanin. Memë Sherifi u mbështet në një trung ulliri dhe po qëllonte me mamxerin e tij italianët që luftonin kundër Selamit.

Ai, në luftën për çlirimin e Vlorës, ashtu si edhe në luftrat e mëparshme, tregoi trimërinë e tij, guxmin dhe bëri sakrificën supreme për çështjen e atdheut dhe mbrojtjen e shokëve të tij. Mema ra me mamxer në dorë, i përshkuar nga plumbat e armikut. Dhe populli me këngën e tij e bëri atë të pavdekshëm:

*Te spitali mbi hapsanë
Mbeti Selami i vrarë,
Briti: «O Memë, o djalë
Mos ma le hakun pa marrë!»
Memë Sherifi, lule djalë,
Zuri një ulli të çarë
Vret tenent e vret marshallë
Hakënë s'e la pa marrë.*

Në kodrën majtas spitalit, bashkë me Selamin ishte dhe Shefqet Shéhu, një nga luftëtarët më trimëtës së Nivicës, i cili që me fillimin e luftimeve në Qafë të Kociut u ndodh afër Selamit dhe pastaj nuk iu nda atij asnjë çast. Shefqeti qe në krah të Selamit edhe kur ai sulmoi dhe kapi topin e armikut, siç thotë kënga popullore:

*... Ç'e zure topin nga Gryka
Me një djalë nga Nivica*

Edhe Shefqet Shehu e dha jetën e tij fare të re në përleshje trup me trup me pushtuesit e vendit tonë dhe, me trimërinë e rrallë që tregoi në çastet e fundit të jetës së tij, u bë shembull frymëzimi e heroizmi për luftëtarët e tjerë.

Si rezultat i kundërsulmit të forcave të shumta italiane, çetat në mëngjes u tërhoqën lart kodrave. Grupi i luftëtarëve që qenë me Selamin dhe që kishin mundur të depërtonin më thellë në pozitat e armikut, u shkëputën nga shokët dhe faktikisht mbeten të rrrethuar.

Në këtë situatë ata vendosën të mos e kthenin kokën prapa po të qëndronin në vend e të vdisnin si u ka hije burrave shqiptarë. Dhe ata, që të gjithë, qëndruan e derdhën gjakun e tyre në luftë të ashpër e të pabarabartë kundër imperialistëve italianë, që kishin pushtuar vendin. Midis atyre luftëtarëve, nga çeta e Salarisë qenë edhe Mane Tahiri, Teme Gogaj e Hyso Demiri.

KREU I KATËRT

JEHONA E SELAM MUSAIT

Sulmi i parë drejtpërdrejt mbi qytetin e Vlorës dhe kalanë e Kaninës nuk u kurorëzua me sukses. Çetat u tërroqën në pozitat e nisjes dhe prapë zunë vende përballë telave me gjemba e llogoreve të ushtrisë italiane duke e mbajtur atë të rrethuar.

Humbjet qenë të rënda. Nga radhët e çetave mungonin dhjetëra luftëtarë, të cilët dhanë jetën, duke treguar trimëri të rrallë, në luftë kundër pushuesit të huaj. Dhjetëra të tjerë, që qenë të plagosur ose që s'patën mundësi të tërhiqeshin bashkë me shokët, dualën nga zona e pushtuar pas dy e tri ditësh dhe u bashkuan me çetat e tyre.

Vdekja heroike e Selam Musait i hidhëroi pamasë të gjithë luftëtarët e komandantët. Pas pushimit të zjarrit, Komiteti «Mbrojtja Kombëtare» i kërkoi komandës italiane që ta dorëzonte trupin e tij. Për këtë, një grup luftëtarësh, midis të cilëve qenë edhe Dule Musaj, i vëllai i Selamit, e Islam Malua, shok e bashkëluftëtar i tij, kaluan gjithë vendet ku u zhvilluan luftimet. Ata shikuani çdo pëllëmbë tokë, çdo shkurre, ferrë e gjineshtër, çdo rrënje ulliri a bokërrimë. Kërkimi vazhdoi tri ditë rresht, por pa asnjë rezultat. Trupi i Selam Musait nuk u gjet.

Gjatë kohës që Dulja me shokë po kërkonte e po pyeste njerëzit, kur po kalonte afër një shtëpie dëgjoi një grua vlonjate që po qante me ligje. Ai u kthyte dhe u fut brenda. Pasi ajo pushoi, Dulja i tregoi se kush ish dhe qëllimi pse kish ardhur aty. Gruaja i tha atij që të mos kërkonte kot, sepse trupat e Selam Musait, të burrit të saj dhe të disa luftëtarëve të tjerë, që ajo nuk i njihte, ushtarët italianë i kishin marrë dhe i kishin kaluar poshtë, po se përkru ajo nuk e dinte.

Disa nga luftëtarët e Luftës së Vlorës tregojnë se ushtria italiane, të vrarët e kundërshtarit i digjte me benzinë ose flakëheshëse. Një gjë e tillë mund të kish ndodhur edhe me trupin e Selam Musait. Kështu u fol në atë kohë dhe kjo përmendet edhe në një këngë popullore kushtuar Selamit.

... *Koloneli me Zabinë*
Me dorë dot nuk të zjinë,
Të hodhën flakë e benzinë,
Trupinë se ç'ta zhurinë.

Përfundimisht trupi i Selam Musait si dhe ata të Dule Dalanit, Shefqet Shehut, Memë Sherifit, Ibrush Muços, Mane Tahirit, Teme Gogajt dhe Hysen Demirit nuk u gjetën, kështu që ata nuk u varrosën bashkë me luftëtarët e tjerë të rënë në Luftët e Vlorës.

Përvrasjen e Selam Musait dhe përvrasjen e tij ka edhe disa tregime, të cilat nuk bazohen në fakte, po më tepër vijnë nga ngatërrimi i personave të ndryshëm me njëri-tjetrin, prandaj nuk mund të

besohen. Për shembull, në një pamje kartoline të botuar në Elbasan më 1924 duken autoritete civile, ushtarake e fetare si dhe popull i shumtë para një varri, mbi të cilin janë vendosur kurora me lule. Prapa kartolinës është shënuar: «Vairimi i heroit të Vlorës». Ceremonia që paraqet kartolina në fjalë është interpretuar si varrimi i Selam Musait dhe kartolina është ekspozuar në muzeumin e Selam Musait në Salari si dhe në vende të tjera. Mirëpo një gjë e tillë s'mund të ketë ndodhur, sepse as gruaja e Selam Musait, e cila vdiq më 1944, as vëllai i tij Dulja, i cili u vra disa vjet pas Selamit, dhe asnjë nga shokët e miqtë e tij, nuk kishin dijeni për varrosjen e Selamit. Gjithashtu shtypi i asaj kohe përmend vetëm vdekjen heroike të tij duke humbur në flakë e duke mos lënë asnjë gjurmë, dhe s'ka asnjë të dhënë për gjetjen e trupit dhe varrosjen e tij.

Kishin kaluar katër ditë nga vrasja e Selamit, kur një nga luftëtarët e çetës së Salarisë njoju dhe kapi kalin e tij «Binokun», i cili vraponte i egërsuar në kodrat në lindje të Qafës së Koçiut. Ai kish një plagë plumbi në bark, nga e cila i rridhte gjak. Islam Malua e çoi atë në shtëpi të Selamit. Këzja, e bija e tij më e vogël, i lau plagën, dhe, sipas zakonit të vendit, në shenjë zie i preu bishtin. Pastaj atij i hoqën shalën përgjithmonë dhe e lëshuan në kopenë e pe-lave. «Binoku» ngordhi në tetor po të atij viti.

Në pesëmbëdhjetëditeshin e dytë të muajit gusht, kur ushtria italiane po imbarikohej në anijet dhe po largohej nga Vlora, një oficer shqiptar, i cili ndodhej me shërbim në skelë, i gjeti një ushtaraku italian një gunë. Ai ia mori dhe ua tregoi shumë luf-tëtarëve për ta njobur. Të gjithë qenë të një mendimi, që ajo qe guna e Selam Musait. Atëherë thirrën Dulen,

vëllanë si dhe Safën, kunatën e Selamit. Ata e njojënë gunën, e muarën dhe e shpunë në shtëpi të Selamit në Salari. Ajo, sipas tregimit të atyre që e kanë parë vetë, ishte shpuar e bërë shoshë nga plumbat e copërat e predhave dhe qe djegur nga flaka e barutit në disa vende. Këtë gunë, pas vdekjes së Dules, ia dhuruan Hasan Muçajt, dhëndrrit të Selam Musait, i cili, sipas salarjotëve, e ka pasur e ruajtur deri në vitin 1940.

* * *

Selam Musai njihet edhe përpëra Luftës së Vlorës si burri me autoritet i Tepelenës, patriot që kish marrë pjesë në lëvizjen e rilindjes Kombëtare, luftëtar në çetat e para kundër pushtuesve turq, komandant çetash në luftën kundër shovnistëve grekë në Bezhan, në malet e Salarisë, në Tepele-në, Lekël, Kodër dhe në Labovë; njihet, gjithashtu edhe si njjeri që i urrente imperialistët italianë dhe që qe një nga udhëheqësit e Tepe-



Patrioti Dule Dalani, shok dhe bashkluftëtar i Selam Musait

lenës që organizuan luftën e popullit kundër push-tuesve të vendit.

Vrasja e Selam Musait u bë e njohur në shkallë kombëtare që atëhere. Në një raport të prefektit të Beratit, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme më datën 17 qershor, mbi heroizmin e patriotëve shqiptarë për çlirimin e Vlorës lexojmë edhe këto radhë: «Trimëria që kanë dëftyer shqiptarët në këtë luftë, duke kapërcyer telat me gjemba me gjerësi dy deri tre metra dhe duke u hedhur mbi topat e mitralozët brenda në fortessat, çudit gjithë botën... Humbja më e shumë 'është nga populli i Kurveleshit, Kudhësit, Smokthinës... I quajturi Selam Musa, që me një trimëri të madhe hyri brenda në Vlorë dhe zuri Kus-Babanë, me dymbëdhjetë shokë më s'mundën të dalin dot dhe pandehet se kanë rënë dëshmorë».

Në gazeten e Korçës «Koha», e cila drejtohej nga patrioti i shquar Mihal Grameno më datën 10 korrik, në artikullin me titull: «Lufta shqiptaro-italiane në Vlorë, midis të tjerave lexojmë: «Shqiptarët, të cilët janë lindur luftëtarë dhe gjeneralë të mëdhenj, nxjerrin gunat dhe brucat e tyre, i hedhin përmbi telat dhe zënë të kaptojnë llogoret pa ndonjë siklet... Në këtë luftë humbëm edhe patriotin e dëgjuar Selam Musa Salaria me disa salariotë, të cilët nuk dhanë as ndonjë vështrim në topat dhe mitralozët e itali-anëve».

Shtypi përparimtar i viteve 1920-1924 në raste përvjetorësh të ngjarjeve të rëndësishme kombëtare ose në artikuj të tjerë, kur bëhej fjalë për traditat tonë luftarake, shpeshherë e përmend Selam Musanë si patriot të shquar dhe shembull të trimërisë e të heroizmit shqiptar në luftë kundër të huajve.

Në prak të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të

Qershorit 1924 gazeta «Politika», në një artikull mbi ceremoninë funerale të Avni Rustemit, emrin e Selam Musait e përmend bashkë me figurat më të shquara të popullit tonë. Po kjo gazetë më 3 shtator të atij viti, duke shkruar për trimëritë e shqiptarëve gjatë gjithë historisë dhe për respektin që ka populli ynë për ta, përfundon: «Këta therorë të lirisë ne shqiptarëve na kanë lënë një helm e pikëllim baraz me hidhërimin që ndjejmë për dëshmorët e kodrave të Vlorës. Selam Musanë me shokët e tij».

Në një biografi prej dy faqesh të shkruar para lufte për Selam Musain dhe që ndodhet në Arkivin e Shtetit, midis të t'erave, lexojmë: «Ka marrë pjesë në lëvizjen kombëtare para konstitucionit turk. Më 1912 qe vullnetar në Luftën kundër Greqisë. Kur ushtria greke pushtoi Tepelenën e Salarinë, Selami, bashkë me çetën e krahinës së Lopësit, ndaluan grekërit te përrroi i Salarisë dhe nuk i lanë të përparonin më tej. Më 1914 ka luftuar kundër ushtrive greke duke cliruar Tepelenën. Luzatin dhe Labovën... Ka është nië nga anëtarët aktivë të Komitetit «Mbrojtja Kombëtare» që ish formuar prej nacionalistëve për clirimin e Shqipërisë nga okupacioni pas Luftës së Parë Botërore... Më 1920 në Luftën e Vlorës... ka treguar heroizëm të madhe të trimërisë shqiptare, duke sulmuar fuitë e tmerrshme italiane dhe ka hvrë brenda deri te spitali i Vlorës dhe atje ka rënë dëshmor i atdheut...».

Regjimi reaksionar i mbretit Zog, që u vendos në Shqipëri, ashtu si patriotët e tjerë edhe Selam Musain nuk e vlerësoi, nuk e përmendi dhe u mundua ta mbulojë me pluhurin e harresës figurën dhe aktin e tij.

Pushtuesit fashistë u munduan të shfrytëzojnë

ndjenjat e pastra të popullit shqiptar për figurat e shquara të historisë së tij. Në këtë kuadër, ata, veç të tjerave, në muajin nëntor 1942, kur populli shqiptar kish kapur armët kundër të huajit, muarën vendim t'u caktonin «pension patriotik» disa familjeve të patriotëve më të dëgjuar, midis të cilëve edhe Selam Musait.

Ky vendim u botua në gazetën e fashizmit «Tommori» më datën 6 nëntor. Për të demaskuar këtë akt të ulët të pushtuesve, i cili fyente popullin tonë dhe ata patriotë që dhanë jetën kundër të huajve, shoku Enver Hoxha, në një artikull të botuar në gazeten «Zeri i popullit» numër 5-6 të nëntorit 1942, midis të tjerave, shkruan:

«Që ta kuptioni këtë manevër kqyrni në numrin e «Tomorit» në fjalë dhe atje do të këndoni se gruas së heroit tonë legjendar Selam Musa Salarisë, fashizmi okupator i paska lidhur një pension. Fashizmi italian dhe tradhtarët përpilen me përvetësue atë hero, që për të cliruar Shqipërinë nga thundra e ndyrë e italianëve ra si fatos te Çezma e Re në sulm e sipër». Dhe më poshtë: «Tradhtarët i kujtuan sot patriotët, jo sepse i preu malli, po pse u vjen festja vërdallë, i kujtuan se duan që nën maskën e nacionahizmit të përcajnjë popullin tonë, por gabohen, gabohen tmerrisisht, se mëma plakë e Spiro Bellkamenit, dhe gratë heroike të Çerçiz Topullit e të Selam Musa Salarisë, dhe atdhetarët e tjerë, që fashizmi dhe tradhtarët kërkojnë t'i gënjejnë, ushqejnë në zemrat e tyre urejtjen më të madhe për okupatorin dhe në shpirtin e tyre vlon dëshira e Luftës Nacionalçlirimtare, vlon ideali i lirisë, për të cilin ranë dëshmori burrat dhe djemtë e tyre».

Dhe familja e Selam Musait e përbuzi më urrejtje «pensionin» e qeverisë fashiste dhe e refuzoi.

Selam Musai dhe vepra e tij si patriot, luftëtar e komandant kundër pushtuesve të huaj, u vlerësuan lart dhe u vunë në vendin e merituar vetëm nga Partia jonë dhe pushteti popullor. Që me fillimin e Luftës Nacionallirimtare, figura e Selamit, e radhitur krahas patriotëve të tjerë të shquar të popullit tonë, u përmend si flamur për të treguar patriotizmin, trimërinë dhe heroizmin e shqiptarëve kundër armiqve të huaj.

Patriotët tepelenas, të cilët me pushtimin e vendit tonë nga fashistët italianë u ngritën në luftë, më 1942 formuan çetën e parë partizane dhe, për të nderuar kujtimin e patriotit të dëgjuar, e pagëzuan Çeta «Selam Musai».

Populli ynë patriot e liridashës e nderoi aktin e Selam Musait dhe me gurrën e tij të pashterueshme e ngriti lart figurën dhe heroizmin e tij.

Për aspektet e ndryshme të jetës së Selam Musait dhe trimëritë e tij të treguara në luftë, në krahinat e Labërisë janë kënduar 24 këngë origjinale, por me siguri ka edhe të tjera.

Në ato kohë kaq shumë këngë nuk i janë kushtuar asnjë luftëtar ose komandanti tjetër, kaq i madh ka qenë popullariteti i tij.

Disa nga këngët u kënduan që kur ai qe gjallë, për shembull ato që bëjnë fjalë për luftërat para 1920. Por shumica e tyre u ngrenë e u kënduan nga bashkëluftëtarët e tij pas vrasjes.

Disa nga këngët që njihen sot, për Selam Musain, në fillim qenë vaje me ligje, që bënë të bijat e tij ose gra të tjera kur u vra ai. Po më vonë ato ligje u kthyen në këngë e këndohen edhe sot.

Më 23 nëntor 1962, në të hyrë të Tepelenës, kur shkon nga Vlora, afër një rrapi shekullor e përbri kalasë së vjetër të Ali Pashës, u vendos busti i Selam Musait.

Me dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, në bazë të vendimit të mbledhjes së përbashkët të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave, datë 26 nëntor 1962 Selam Musait iu dha titulli më i lartë, «Hero i Popullit» me këtë motivacion:

«Për heroizmin që ka treguar në luftën e popullit për liri. Është shquar për guxim, trimëri dhe vetëmohim, si një nga komandantët e forcave vullnetare në luftë kundër pushtuesve imperialistë italianë më 1920 për çlirimin e Vlorës.

Me luftën e tij ai u bë shembull heroizmi dhe abnëgacioni për brezat e ardhshëm».

B I B L I O G R A F I

Enver Hoxha: Fjalime dhe artikuj.

Historia e Shqipërisë, botim i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, Tiranë 1965.

- Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë 1963.
- Dokumenta e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941, botim i Drejtorisë së Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë 1959.
- Kujtime dhe këngë popullore për luftën çlirimtare të viteve 1918-1920, botimi i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë dhe i Institutit të Folklorit, Tiranë 1970.

K. Frashëri: Lufta e Vlorës 1920, dorëshkrim në Institutin e Historisë e të Gjuhësisë.

M. Çami: Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar në vitet 1918-1920, botimi i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, Tiranë 1969.

M. Grameno: Kryengritja shqiptare, Tiranë 1959.

S. Hallkokondi: Historia e Shqipërisë së re, Vlorë 1923. Gazeta dhe revista të periudhës përkatëse të vendit dhe ato të kolonive shqiptare jashtë vendit.

Kujtime të veteranëve të luftërave çlirimtare kündër të huajve.

Kujtime të të afërmve, të bashkëluftëtarëve dhe të atyre që e kanë njohur personalisht Selam Musain.

P E R M B A J T J A :

Faqe

K R E U I P A R E

SELAM MUSA SALARIA

1. Familja	3
2. Copa jetë	7
3. Në gjirin e lëvizjes patriotike	19

K R E U I D Y T E

SELAM MUSAI KUNDËR SHOVINISTËVE GREKË

1. Në luftën e Janinës	26
2. Griba	32
3. Labova	48

K R E U I T R E T E

SELAM MUSAI KUNDËR IMPERIALISTËVE ITALIANË

1. Atdheu në rrezik	65
2. Prapë me armë në dorë	71
3. Ushtria italiane në krahinën e Vlorës dhe atë të Tepelenës.	82
4. Beuni	84
5. Kota	91
6. Vlora	106

K R E U I K A T E R T

JEHONA E SELAM MUSAIT	130
------------------------------------	------------